RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

PËR AUDITIMIN E SISTEMEVE TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË DOGANAVEDHE NJËSISË SË AKSHI-T PËR TEKNOLOGJINË E INFORMACIONIT

Tiranë, më 17.09.2021

PËRMBAJTJA

Nr.		EMËRTIMI	Faqe
I.		**PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**	**3**
	1	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	**3**
	2	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	**3-7**
	3	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit	**7**
II.		**HYRJE**	**7**
	1	Objekti i auditimit	**8**
	2	Qëllimi i auditimit	**8**
	3	Identifikimi i çështjes	**8**
	4	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	**8-9**
	5	Përgjegjësitë e audituesve	**9**
	6	Kriteret e vlerësimit	**9-10**
	7	Standardet e auditimit	**10**
	8	Metodat e auditimit	**10**
	9	Dokumentimi i auditimit	**10**
III.		**PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**	**11**
	1	**Informacion i Përgjithshëm mbi subjektin**	**11**
	2	**Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit**	**11**
	2.1 Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK		**11-26**
	a.	*Verifikim i strategjisë, politikave dhe procedurave dhe vlerësimi i burimeve njerëzore në TIK.*	
	2.2Auditimi i Menaxhimit të ndryshimit.		**26-29**
	2.3Auditimi i zhvillimit dhe blerjes në teknologjinë e informacionit.		**29-38**
	a.	*Identifikimi, hartimi i nevojave dhe kritereve të vendosura për mallra dhe shërbime.*	
	b.	*Procedurat e investimeve në fushën e TIK dhe Marrëveshjet e Nivelit të Shërbimit (ServiceLevelAgreement).*	
	2.4Auditimi i sigurisë së informacionit		**38-51**
	a.	*Siguria e të dhënave dhe vazhdimësia në ofrimin e shërbimit.*	
	b.	*Të drejtat e përdoruesve dhe menaxhimi i tyre.*	
	2.5Auditimi i sistemeve		**51-62**
	a.	*Verifikim i kontrolleve të aplikacioneve për të dhënat Input/Output*	
	2.6Verifikimi me zgjedhje i degëve doganore.		**63-64**
IV.		**GJETJET DHE REKOMANDIMET**	**65-81**
V		**ANEKSE – Lista e Shkurtimeve**	**82-82**

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) mbështetur në nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 ñ*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*ò, datë 27.11.2014, zhvilloi një Auditim të Teknologjisë së Informacionit në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, nga data 07.06.2021deri më datë16.07.2021.

Grupi i auditimit mblodhi informacione, zhvilloi pyetësorë e intervista për caktimin e zonave me risk të lartë dhe mbështetur në to hartoi matricat e auditimit.

Kërkesat për informacion për fushat përkatëse u hartuan në përputhje me manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

I.1.Përshkrimi i shkurtër i Projektit të Auditimit:

Projekti i auditimit, për auditimin e Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, është pjesë e Planit Vjetor 2021 të auditimit të KLSH-së, miratuar nga Kryetari i KLSH. Projektimi i këtij auditimi, është bërë bazuar në një analizë risku, si gjatë hartimit të planit vjetor, po ashtu edhe gjatë hartimit të Programit të Projektit të Auditimit, ku KLSH, ka vlerësuar si të rëndësishëm auditimin e sistemeve të teknologjisë që DPD disponon, për të garantuar disponibilitet dhe integritet të të dhënave me të cilat bazon vendimmarrjen.

Siguria e Informacionit është bërë gjithnjë e më shumë e rëndësishme për institucionet, kjo si pasojë e rritjes së kompleksitetit të kontrollit të aksesit dhe ruajtjes së konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë së të dhënave nga marrëdhëniet e rrjeteve publike me ato private dhe nga bashkë përdorimi i burimeve të informacionit. Siguria e Informacionit mund të përcaktohet si mundësia e një sistemi për të mbrojtur informacionin dhe burimet e sistemeve në përputhje me termat e konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë. Sistemet e informacionit janë bashkime komplekse të teknologjisë, proceseve dhe njerëzve që funksionojnë së bashku për të rregulluar përpunimin, ruajtjen, dhe transferimin e informacionit për të mbështetur misionin e institucionit dhe funksionet e tij. Lidhur nga sa më sipër, çdo institucion shtetëror që ofron shërbime ndaj qytetarëve e ka si detyrim ndërtimin e programit të sigurisë së informacionit me elementët kyç të cilët janë: ñ*Mjedisi i sigurisë së informacionit, Vlerësimi i riskut, Politikat e sigurisë, Organizimi i sigurisë së TIK, Menaxhimi i komunikimeve dhe operacioneve, Menaxhimi i aseteve, Siguria e burimeve njerëzore, Siguria fizike dhe mjedisore, Kontrolli i aksesit, Menaxhimi i incidenteve të sigurisë së TIK, Menaxhimi i vazhdueshmërisë së biznesit, Përputhshmëria*ò.

I.2.Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve:

Gjetje nr.	Përmbledhje e Gjetjes	Referenca me Raportin Përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
1.	Plani i veprimit dhe implementimit Strategjik Institucional nuk është realizuar sipas plan	Faqe 16-17	e lartë	DPD në bashkëpunim me Drejtorinë e TI pranë DPD, të marrë masa për hartimin dhe

	veprimeve përkatëse, prioriteteve, periudhave të implementimit nga personat përgjegjës me indikatorëve matës.			konkretizimin e Planit të veprimit dhe implementimit Strategjik Institucional për objektivat e planit strategjik institucional ñ*Strategjia e Biznesit e Administratës Doganore shqiptare 2018-2021*ò, implementimi i NCTS, ITMS dhe sistemeve të tjera të IT-së së BE-së në përputhje me nevojat e anëtarësimit në BE, EU MASP dhe programin e punës së EU UCC.
2.	Objektivat e Strategjisë Ndërsektoriale të AxhendësDixhitale të Shqipërisë për periudhën 2015-2020 miratuar nga KM nuk janë të përfshirë në strategjinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave. Planveprimi i strategjisë i AKSHI-t ku janë përcaktuar prioritetet strategjike ndërsektoriale të Axhendësdixhitale të Shqipërisë për periudhën 2015-2020 nuk është përfshirë në planveprimin e strategjisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.	faqe 18-19	e lartë	Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganavedhe AKSHI të merren masat për përfshirjen në strategjinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, të Objektivave e Strategjisë Ndërsektoriale e AxhendësDixhitale të Shqipërisë për periudhën 2015-2020. - Nga DPDdheAKSHI të merren masat për rritjen e sigurisë në infrastrukturën kritike të teknologjisë së informacionit dhe zbatimin e kërkesave të larta teknike për bazat e të dhënave shtetërore etj. - DPD në bashkëpunim me Drejtorinë e TIK të Doganave, të marrë masa për hartimin dhe konkretizimin e Planit të veprimit dhe implementimit Strategjik Institucional

				për objektivat e planit të strategjisë ndërsektoriale të AxhendësDixhitale të Shqipërisë për periudhën 2015-2020.
3.	Nga auditimi mbi të dhënat e gjurmës elektronike të auditimit, rezultoi se për vitin 2019 këto gjurmë janë fshirë me argumentin se madhësia e kësaj tabele bllokoi punën me sistemin AsycudaWorldpër disa orë. Për këtë ndërhyrje, nuk rezulton të jetë dokumentuar asnjë shpjegim dhe asnjë miratim nga niveli drejtues i DPD. Vendimi dhe ekzekutimi është marrë nga struktura e AKSHI-t pranë DPD, në kundërshtim me pikën 5.2.2 ñ*Detyrat e Stafit Përgjegjës për Menaxhimin e Log-eve*ò, të rregullores për menaxhimin e log-eve dixhitale në administratën publike miratuar me urdhrin nr.109, datë 10.06.2016 nga ALCIRT, sepse struktura e AKSHI-t nuk janë stafi përgjegjës për menaxhimin e log-eve. Drejtoria TIK e AKSHI-t nuk ka ngritur mekanizma kontrolli me qëllim parandalimin e çështjeve që lidhen me funksionalitete të sistemit, çfarë do të thotë se e njëjta situatë rrezikon të përsëritet në të ardhmen.	faqe 42	e lartë	Niveli drejtues i DPD të ndërtojë mekanizma kontrolli për mbrojtjen dhe sigurimin e të dhënave shtetërore, gjeneruar prej saj nëpërmjet sistemit Asycuda, me qëllim parandalimin e situatave të ngjashme si fshirja e të dhënave mbi gjurmën elektronike të auditimit në të ardhmen.
4.	Nga auditimi u konstatua se DPD, si institucion që disponon disa sisteme informacioni që ruajnë, përpunojnë dhe gjenerojnë të dhëna me rëndësi për realizimin e mbikëqyrjes dhe tregtisë ndërkombëtare, nuk disponon një infrastrukturë	faqe 44-45	e lartë	DPD në bashkëpunim me AKSHI-n, të hartojnë planin e vazhdimësisë dhe planin e rikuperimit si dhe të ndërmarrin hapat e nevojshëm për sigurimin e pajisjeve të nevojshme në ndërtimin

	BCC, në kundërshtim me VKM nr.710, datë 21.08.2013 ñ*Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit*ò, i ndryshuar. DPD nuk ka një plan vazhdimësie dhe plan rikuperimi për garantimin e vazhdimësisë së ofrimit të shërbimit.			e qendre *BusinessContinuity* si dhe të përcaktojnë burimet njerëzore përgjegjëse nga të dy institucionet.
5.	Nga auditimi mbi aktet rregullative për dokumentimin dhe mirë administrimin e bazës së të dhënave doganore, rezulton se: **-** DPD nuk disponon asnjë akt rregullativ të brendshëm me qëllim organizimin dhe funksionimin e brendshëm të bazës së të dhënave, në përputhje nenin 5të Ligjit nr.10325, datë 23.9.2010, për ñ*Bazat e të dhënave shtetërore*ò. - Nuk janë dokumentuar në asnjë formë të dhënat dytësore të cilat ruhen në këtë bazë të dhënash për të mirë funksionuar si dhe të dhënat apo sistemet me të cilat ndërveprohet sipas përcaktimeve në nenin 7 dhe 8 të Ligjit nr.10325, datë 23.9.2010, për ñ*Bazat e të dhënave shtetërore*ò.	faqe 54-55	e lartë	DPD si institucion përgjegjës dhe administrues i të dhënave shtetërore që gjenerohen nëpërmjet sistemit Asycuda, të dokumentojnë me një akt rregullativ të brendshëm organizimin dhe funksionimin e të dhënave shtetërore me rëndësi kritike. Gjithashtu, të evidentohen dhe dokumentohen pa përjashtim të dhënat parësore dhe dytësore me të cilat janë ndërtuar ndërveprime për ofrimin e shërbimit ndaj shtetasve.
6.	Nga auditimi mbi administrimin e të dhënave shtetërore të DPD rezulton se **t**ë dhënat gjeneruar prej sistemit Asycuda nuk administrohen nga DPD, megjithëse janë detyrim i institucionit që i gjeneron ato, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr.10325, ñ*Për bazat e të*	faqe 55-56	e lartë	Niveli drejtues në DPD si institucion përgjegjës dhe administrues i të dhënave shtetërore që gjenerohen nëpërmjet sistemit Asycuda, të marrë masa për përmbushjen e këtij detyrimi me strukturë të posaçme për administrimin dhe

	dhënave shtetërore", neni 5: dhe VKM nr.673, pika 5/y. Aktualisht detyrat e administrimit të të dhënave janë deleguar në mungesë të plotë dokumentacioni (verbalisht) tek specialistët e AKSHIT, për arsye se vetë DPD nuk ka asnjë pozicion dhe punonjës në strukturën e saj, për ruajtjen dhe administrimin e të dhënave.			mbrojtjen e të dhënave, si shërbime të cilat nuk ofrohen nga AKSHI.

I.3.Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit:

Grupi i auditimit mbështetur në Standardet ndërkombëtare të Auditimit përkatësisht në ISSAI 100, ISSAI 5300, ISSAI 5310 si dhe nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 ñPër Organizimin dhe Funksionimin e KLSHò datë 27.11.2014 konstaton se, mungesa e procedurave dhe akteve rregullatorë në drejtim të sistemeve të teknologjisë së informacionit kanë ndikuar në një zhvillim të pa monitoruar të aktivitetit institucional dhe pa deleguar përgjegjësitë individuale për veprimet e kryera në sistem. Me lëvizjen e strukturës TIK nën varësinë e AKSHI-t janë deleguar verbalisht dhe administrimi i të dhënave, për të cilat është përgjegjëse DPD, duke e pozicionuar institucionin në kushte me risk të lartë sigurie në humbjen apo tjetërsimin e të dhënave shtetërore e kritike. Kuptimi i kësaj përgjegjësie, dhe angazhimi i institucioneve përgjegjëse si DPD dhe AKSHI-T si suport teknik, në mbrojtjen e të dhënave kritike, duhet të jetë konform rregullave të miratuara nga organet vendimmarrëse, në mënyrë që të mos kompromotohen të dhënat nga tejkalimi i kompetencave të pa ligjëruara.
Strukturat Drejtuese të DPD në bashkëpunim me AKSHI-n, nuk kanë marrë masat e duhura për krijimin e DisasterRecovery Plan (DRC) dhe BusinessContinuity Plan (BCP), veprim i cili mund të kishte lënë jashtë funksionit sistemin doganor me ngjarjen e 26 nëntor 2019.

II. HYRJE

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 ñ*Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH*ò, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 570/1, datë 08.06.2021 të miratuar nga Kryetari i KLSH, me afat auditimi 07.06.2021 deri në 16.07.2021, në DPD, ku periudha e audituar është 01.01.2019 deri në 31.12.2020, u krye auditimi me objekt ñ*Ri-Auditimi i Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit*ò, nga audituesit:

1. EC, përgjegjëse grupi
2. BZ, Anëtar
3. EK, Anëtare

4. KS, Anëtare

II.1.Objekti i auditimit

Objekti i Auditimit TIK është përcaktimi nëse objektivat e subjektit arrihen në mënyrën e duhur duke përdorur burimet IT, duke përfshirë pajtueshmërinë me kërkesat ligjore dhe rregullative, konfidencialitetin, integritetin si dhe disponueshmërinë e sistemeve të informacionit dhe të dhënave që gjenden në të.

II.2.Qëllimi i auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) mbështetur në nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 ñ*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*ò, datë 27.11.2014, zhvilloi ri-auditimin e teknologjisë së informacionit në DPD, nga data 07.06.2021 deri më datë 16.07.2021. Kërkesat për informacion sipas drejtimeve të programit të ri-auditimit, u hartuan në përputhje me Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.
Qëllimi i Auditimit TIK ushtruar në DPD, është dhënia e opinionit apo vlerësimi nëse ekzistojnë kontrollet dhe mekanizmat e duhur me qëllim krijimin/ mirëmbajtjen/ zhvillimin e burimeve TI dhe funksioneve për të cilat këto burime shërbejnë.

II.3.Identifikimi i çështjes

Drejtimet e këtij auditimi janë bazuar në programin e mëparshëm protokolluar në KLSH me nr.456/1, datë 18.06.2020:

1. Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK

a. Verifikim i strategjisë, politikave dhe procedurave dhe vlerësimi i burimeve njerëzore në TIK

2. Auditimi i Menaxhimit të ndryshimit

3. Auditimi i zhvillimit dhe blerjes në teknologjinë e informacionit

a. Identifikimi, hartimi i nevojave dhe kritereve të vendosura për mallra dhe shërbime

b. Procedurat e investimeve në fushën e TIK dhe Marrëveshjet e Nivelit të Shërbimit (ServiceLevelAgreement).

4. Auditimi i sigurisë së informacionit

a. Siguria e të dhënave dhe vazhdimësia në ofrimin e shërbimit

b. Të drejtat e përdoruesve dhe menaxhimi i tyre.

5. Auditimi i sistemeve

a. Verifikim i kontrolleve të aplikacioneve për të dhënat Input/Output

6. Verifikimi me zgjedhje i degëve doganore.

II.4.Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Autoritetet doganore kanë si përgjegjësi kryesore mbikëqyrjen e tregtisë ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë, duke kontribuar për tregtinë e hapur e të drejtë në zbatim të politikave tregtare dhe atyre të sektorëve të tjerë të ekonomisë shqiptare, që ndikojnë në tregti dhe në sigurinë e të gjithë zinxhirit tregtar dhe për këtë qëllim. Autoritetet doganore synojnë mbrojtjen e interesave financiarë dhe mjedisorë të Republikës së Shqipërisë nga tregtia e padrejtë dhe e paligjshme, duke mbështetur ndërkohë aktivitetin e ligjshëm të biznesit; garantimin e sigurisë e të mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë dhe të banorëve të saj, si dhe mbrojtjes së mjedisit e, kur është e nevojshme, në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet e tjera; mbajtjen e balancës së duhur ndërmjet kontrolleve doganore dhe lehtësimit të tregtisë së ligjshme.

Doganat shqiptare, për përmbushjen e misionit të saj, përcaktojnë parimet strategjikë si më poshtë:

- Parimi i mbrojtjes së shoqërisë dhe interesave financiarë të Republikës së Shqipërisë;
- Parimi i mbështetjes së konkurrueshmërisë së kompanive shqiptare;
- Parimi i lehtësimit të mëtejshëm të tregtisë së ligjshme;
- Parimi i kontrollit dhe menaxhimit të zinxhirit të furnizimit të përdorur, për lëvizjen ndërkombëtare të mallrave;
- Parimi i bashkëpunimit, duke mbajtur, zhvilluar dhe shtuar marrëdhëniet e ndërsjella ndërmjet autoriteteve doganore dhe agjencive të tjera qeveritare dhe ndërmjet autoriteteve doganore dhe komunitetit të biznesit;

DPD ka si vizion të saj, të jetë:

- Në harmoni të plotë me standardet dhe praktikat më të mira të BE ï së;
- Një institucion publik modern, profesional, i paanshëm, i ndershëm, i besueshëm dhe i pa korruptuar;
- Një partner mbështetës i komunitetit tregtar dhe ruajtës efikas i shoqërisë dhe zinxhirit të furnizimit;

II.5.Përgjegjësitë e audituesve

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, mbi periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2019 deri në 31.12.2020, duke i kushtuar vëmendje çështjeve që lidhen me zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë si dhe standardeve ndërkombëtare të teknologjisë dhe auditimit TIK.
Nga grupi i auditimit, me përgjegjësi të plotë, janë analizuar të gjitha çështjet që përmban Programi i Auditimit nr. 570/1, datë 08.06.2021,miratuar nga Kryetari i KLSH. Në realizimin e këtij Projekt Auditimi, grupi i auditimit është mbështetur në bazën ligjore mbi të cilën funksionon KLSH, standardet e auditimit, legjislacionin e fushës në të cilën operon DPD. Gjithashtu, gjatë veprimtarisë audituese, është siguruar një evidencë e përshtatshme, e mjaftueshme dhe e besueshme auditimi, në të cilën jemi mbështetur në dhënien e konkluzioneve dhe rekomandimeve.

II.6. Kriteret e vlerësimit

Kriteret e vlerësimit janë bazuar në ligjet, rregulloret në fuqi, standardet ndërkombëtare COBIT dhe ISSAI 5300 për auditimin e Teknologjisë së Informacionit si dhe Manualin e Teknologjisë së Informacionit. Opinioni i auditimit mbështetet në praktikat më të mira, Standardet Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Auditimit. Në këtë projekt raportkrahas gjetjeve që janë konstatuar, grupi i auditimit ka rekomanduar disa masa organizative, për përmirësimin e situatës.
Aktet ligjore dhe rregullative mbi të cilat është mbështetur vlerësimi janë si më poshtë:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (nenet 162-165);
- Ligji nr. 154/2014 ñ*Për Organizimin dhe Funksionimit e Kontrollit të Lartë të Shtetit*ò;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 ñ*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*ò, i ndryshuar dhe aktet ligjore në zbatim të tij;
- Ligji nr. 9643, date 20.11.2006 ñ*Për Prokurimin Publik*ò, i ndryshuar;
- Ligji nr. 114/2015 ñ*Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik*ò;
- Ligji Nr. 9918, datë 19.05.2008, ñ*Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë*ò;
- Ligji Nr. 10325, datë 23.09.2010, ñ*Për Bazat e të Dhënave Shtetërore*ò;

- Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin nr. 48/2012 ñ*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*ò.
- Ligji nr.102, datë 31.07.2014 ñKodi Doganor i Republikës së Shqipërisëò i ndryshuar.
- Ligji Nr. 2/2017, ñPër Sigurinë Kibernetikeò;
- VKM 673, datë 22.11.2017 ñ*Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit*ò, i ndryshuar;
- VKM nr. 710, datë 21.08.2013 ñ*Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit*ò, i ndryshuar;
- VKM nr. 945, datë 02.11.2012 ñ*Për miratimin e rregullores administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore*ò;
- Standardet TIK;
- Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 ñ*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*ò, i ndryshuar;
- Udhëzimi nr. 1159, datë 17.03.2014 ñ*Për hartimin e Marrëveshjes të Nivelit të Shërbimit*ò, i ndryshuar;
- Rregulloret përkatëse të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit;

II.7.Standardet e auditimit

Auditimi është kryer, në përputhje me Kodin Etik të KLSH, Standardet e auditimit, dhe teknikat e auditimit të teknologjisë së informacionit, duke përfshirë pyetësorë, intervista, testime dhe procedura, të cilat u gjykuan se ishin të nevojshme, për të dhënë një vlerësim sa më objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë, duke u fokusuar veçanërisht në standardet e fushës së auditimit të TIK, si: COBIT 4.1, Manuali i Auditimit IT, ISSAI 5310, etj

II.8. Metodat e auditimit

Metodat mbi auditimin e sistemeve të Teknologjisë së Informacionit që grupi i auditimit ka ndjekur në DPD, janë si më poshtë:

- Intervista zhvilluar në subjekt me personat përgjegjës;
- Verifikime të sistemit si përdorues;
- Shqyrtimi i dokumentacionit rregullativ të institucionit;
- Analizimi i të dhënave të eksportuara nga sistemi;

II.9.Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i auditimit është bazuar në rregulloren e brendshme të KLSH si dhe në manualin aktiv të auditimit të Teknologjisë së Informacionit në të cilin janë përfshirë:

- Planifikimi, qëllimi dhe objektivat e auditimit;
- Programi i auditimit;
- Evidencat e grumbulluara në lidhje me të dhënat e sistemit, raporte të ndryshme me të dhëna nxjerrë nga sistemi;
- Letrat e punës mbajtur nga audituesit sipas detyrave të përcaktuara gjatë fazës së auditimit në terren;

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT:

III.1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (në vijim DPD) është organi kryesor që prodhon të dhëna në lidhje me import-eksportin e mallrave, në dhe nga territori i Republikës së Shqipërisë.

Partnerët më kryesorë, përdorues të informacionit janë:

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
- INSTAT;
- Ministria e Bujqësisë; etj.

Dixhitalizimi i shërbimeve është me rëndësi për sistemin doganor me qëllim që të krijohen lehtësi për biznesin, shkurtim të kohës procedurale, rritje të transparencës dhe uljen e nivelit të korrupsionit. Nëpërmjet platformës E-Albania ofrohen aktualisht 34 shërbime, 27 prej të cilave si autorizime, vërtetime etj, duhet të jenë në funksion të plotë prej 1 korrik 2021.

III.2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit:

III.2.1. Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK.

a. Verifikim i strategjisë, politikave dhe procedurave dhe vlerësimi i burimeve njerëzore në TIK

Mbështetur në bazën ligjore, VKM nr. 673, datë 22.11.2017 ñ*Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, i ndryshuar me vendim nr. 36, datë 24.1.2018, me vendim nr. 448, datë 26.7.2018, me vendim nr.872, datë 24.12.2019*ò

Pika 6. AKSHI, në ushtrim të veprimtarisë së saj, kryen edhe këto detyra e përgjegjësi të veçanta, si më poshtë vijon:

a) Merr pjesë në hartimin e strategjive të agjendës dixhitale.

b) Bashkërendon planin e veprimit të strategjisë së agjendës dixhitale për ofrimin e shërbimeve elektronike në organet dhe institucionet e administratës publike, për qytetarët, si dhe subjektet private.

c) Përcakton standardet shqiptare të TIK-ut, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe evropiane, të adoptuara, të cilat do të ndiqen nga administrata shtetërore. Këto standarde botohen në Buletinin e Njoftimeve Publike.

ll) Merr pjesë në hartimin e strategjisë ndërsektoriale të agjendës dixhitale dhe bashkërendon punën për zbatimin e saj.

m) Merr pjesë në hartimin e dokumentit të politikës së zhvillimit në fushën e komunikimeve elektronike e-GOV, si një nga komponentët e rëndësishëm të infrastrukturës TIK.

III. Funksionimi dhe organizimi i AKSHI-t

9. AKSHI është administrator i çdo sistemi TIK që ka si përdorues institucionet apo organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave.

10. Në përbërje të AKSHI-t, pranë çdo institucioni dhe organi të administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, krijohen dhe funksionojnë njësitë e teknologjisë së informacionit e të komunikimit (NJTIK), si strukturë organizativo-teknike për projektimin, zbatimin dhe administrimin e qeverisjes elektronike, në institucion, nëpërmjet teknologjisë së informacionit e të komunikimit (TIK).

11. Njësia e teknologjisë së informacionit e të komunikimit është përgjegjëse për:

a) administrimin e infrastrukturës, sistemeve dhe shërbimeve TIK në ministritë e linjës dhe në institucionet e varësisë, në rast se nuk detajohet ndryshe. Për pajisjet, sistemet në të cilat përpunohet informacioni i klasifikuar "sekret shtetëror", NATO, BE, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare, administrimi i kësaj infrastrukture kryhet sipas legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar;
b) ofrimin e shërbimit të asistencës të nivelit 1, për infrastrukturën fizike, pajisjet TIK dhe funksionimin e sistemit për institucionin ku funksionon njësia.

Vizioni i Administratës Doganore Shqiptare është, të jetë: në harmoni të plotë me standardet dhe praktikat më të mira të BE ï së një institucion publik modern, profesional, i paanshëm, i ndershëm, i besueshëm dhe i pa korruptuar një partner mbështetës i komunitetit tregtar dhe ruajtës efikas i shoqërisë dhe zinxhirit të furnizimit.

Strategjia dhe Planifikimi IT.
Strategjia e IT përfaqëson lidhjen e përbashkët midis objektivave të Strategjisë së IT dhe atyre të strategjisë së institucionit. Objektivat e strategjisë së IT duhet të marrin parasysh nevojat e tashme dhe të ardhshme të biznesit, kapacitetin aktual të IT për të ofruar shërbime dhe kërkesat e burimeve. Strategjia duhet të marrë në konsideratë ekzistencën e infrastrukturës dhe arkitekturës së IT, investimeve, modelit të ofrimit, burimet duke përfshirë stafin, si dhe paraqitjen e strategjisë që integron këto elementë në një qasje të përbashkët për të mbështetur objektivat e institucionit.

DPD ka miratuar planin strategjik dhe Planin e veprimit dhe implementimit të tij si më poshtë:
a. Me shkresën nr. 1976/1, datë 30.01.2018, nga MFE është dërguar *"**Strategjia e Biznesit e Administratës Doganore shqiptare 2018-2021"***.

Për hartimin e kësaj strategjie janë marrë në konsideratë:
- VKM nr. 908, datë 17.12.2014 *"Strategjia për Menaxhimin e Financave Publike 2014 - 2020.*
- Shkresa e Ministrisë së Financave nr. 10615, datë 17.07.2012 *"Strategjia e Biznesit e Administratës Doganore shqiptare".*
- VKM nr. 663, datë 17.07.2013 *"Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për luftën kundër krimit të organizuar, trafiqeve të terrorizmit 2013-2020".*
- VKM nr. 119, datë 05.03.2014 *"Për miratimin e strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të integruar të Kufirit".*
- VKM nr. 248, datë 29.03.2017 *"Për miratimin e planit të veprimit kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit 2017-2020".*
- VKM nr. 247, datë 29.03.2015 *"Për miratimin e Strategjisë intersektoriale kundër korrupsionit për periudhën 2015-2020".*
- VKM nr. 175, datë 19.01.2011 *"Për miratimin e strategjisë kombëtare për integrimin e mbetjeve".*
- VKM nr. 42, datë 25.01.2017 *"Për miratimin e planit kombëtar për integrimin evropian 2017 -2020".*
- VKM nr. 527, datë 20.07.2016 *"Për miratimin e strategjisë për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale 2019-2020".*

Në këtë strategji ndër të tjera janë përcaktuar objektivat strategjike (6) ñ*Për përmirësimin e sistemeve dhe platformave të TI*ò.

ñ*Për të mbështetur kërkesat e biznesit në shkallën më të gjerë të mundshme për të gjitha fushat e biznesit, për implementimin e një mjedisi pa letër, garantimi i mundësisë së ndërfaqes me sistemet dhe standardet e TI-së së BE-së*ò.

Për këtë masat kryesore të parashikuara do të jenë:
- Zhvillimi, implementimit dhe rishikimi i rregullt i strategjisë afatgjatë të TI-së që mbështet prioritetet e biznesit.
- Përmirësimi i organizimit dhe menaxhimit të TI-së.
- Përmirësimi i TI-së në të gjitha strukturat e ndryshme hierarkike.
- Implementimi i NCTS, ITMS dhe sistemeve të tjera IT-së së BE-së.
- Prezantimi i një mjedisi të plotë pa letër.

Në implementimin e kësaj strategjie duhen respektuar faktorët kritikë të riskut si ñ*Monitorimi dhe vlerësimit i vazhdueshëm duke rishikuar në mënyrë të rregullt planin e veprimit*ò.

a/1. Plani i veprimit dhe implementimit Strategjik Institucional, i miratuar me Urdhrin nr. 81, me nr. 29699 prot, datë 17.12.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të DPD, në objektivin nr. 6 ñ*Përmirësimi i Sistemeve dhe platformave të TI*ò, përmban katër objektiva me plan veprimet përkatës, prioritetet, periudhat e implementimit, personat përgjegjës dhe indikatorët matës.

- Për objektivin: ñ*Zhvillimi, implementimi dhe rishikimi i rregullt i strategjisë afatgjatë të TI-së që mbështet prioritetet e biznesit*ò, ku në plan veprimin parashikohet hartimi i një strategjie afatgjatë, në përputhje me nevojat e anëtarësimit në EU MASP dhe programin e punës së EU UCC.

Konstatohet se **nuk është hartuar një strategji IT afatgjatë** në përputhje me nevojat e anëtarësimit në EU MASP dhe programin e punës së EU UCC, megjithëse parashikohej të mbaronte në dhjetor të vitit 2019.

- Për objektivin: ñ*Përmirësimi i TI-së në të gjitha strukturat e ndryshme hierarkike*ò, ku në plan veprimin parashikohet të përcaktohen qartë rolet dhe përgjegjësitë ndërmjet AKSH-it dhe Administratës Doganore.

Konstatohet se **nuk ka një marrëveshje të përbashkët ose rregullore** ku të përcaktohenrolet dhe përgjegjësitë ndërmjet AKSH-it dhe Administratës Doganore, megjithëse parashikohej të mbaronte në dhjetor të vitit 2018.

- Për objektivin: ñImplementimi i NCTS, (S*istemin e Transitin Elektronik të Përbashkët*) ITMS *(Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Tarifave)* dhe sistemeve të tjera të IT-së së BE-sëò ku në plan veprimin parashikohet hartimi i planeve të implementimit, përfitimi i burimeve dhe fondeve përkatës.

a. *NCTS, (sistemin e transitin elektronik të përbashkët):*
Projekti i Binjakëzimit, IPA 2012 "*Modernizimi i Administratës Doganore Shqiptare*",me kohëzgjatje 24 muaj i cili ndahet në 2 komponentë:
1. Legjislacioni doganor dhe procedurat në lidhje me ndërveprueshmërinë e sistemeve të TI me sistemin e implementuar të BE - NCTS;
2. Zbatimi dhe Inteligjenca e Transportit Doganor.
Përmes këtij projekti të binjakëzimit, shtetet anëtare do të sigurojnë asistencë teknike për të: *identifikuar boshllëqet dhe nevojat e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, duke përfshirë rekomandime për aktivitete të mëtejshme në fushën e Transportit të Përbashkët/Komunitar; hartimi i të gjitha ligjeve, akteve nënligjore ose dispozitave zbatuese; takime ndërgjegjësimi me tregtarët; krijimin e skemës së menaxhimit dhe mirëmbajtjen e sistemit NCTS - Sistemi i ri i kompjuterizuar i tranzitit, një skemë e tillë më vonë do të miratohet nga qeveria shqiptare,*

etj. Në ditën e pranimit në BE, kërkesa për tranzit kombëtar duhet të jetë plotësisht në përputhje me NCTS.

***b**. ITMS (Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Tarifave)*

Programi IPA 2013: Projekti i binjakëzimit "*Renditja e Legjislacionit Doganor dhe Procedurat në lidhje me Tarifat me Acquis të BE*" (Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Tarifave (ITMS) me kohëzgjatje 2 vjet.

Administrata Doganore Shqiptare synon të vlerësojë përmbushjen e kushteve për ndërveprimin dhe ndërlidhjen me sistemet e IT të BE-së. *Sistemi i Tarifave Kombëtare duhet të jetë i pajtueshëm me EU TARIC dhe duhet të jetë funksional përpara hyrjes së Shqipërisë në BE. Projekti i Binjakëzimit do të prezantojë një sistem plotësisht IT të pajtueshëm me sistemin e BE-së në lidhje me ITMS*. Përmes këtij Projekti, do të hartohen legjislacioni, manualet dhe udhëzimet e reja në përputhje me standardet e BE-së për tarifat si dhe trajnimet përkatëse. DPD në bashkëpunim me Delegacionin e BE-së dhe DG TAXUD, ka përgatitur skedën e projektit dhe tashmë ka përfunduar procesin e vlerësimit të propozimit dhe së shpejti Delegacioni i BE-së do të nënshkruajë kontratën me palën fituese, Administrata Doganore Italiane. Zbatimi i Projektit filloi në Mars 2017.

Konstatohet se **nuk janë hartuar planet e implementimit me aktivitetet e parashikuar** për Implementimin e NCTS, (S*istemin e Transitit Elektronik të Përbashkët*), **nuk janë identifikuar boshllëqet dhe nevojat** e DPD-së, duke përfshirë rekomandime për aktivitete të mëtejshme në fushën e Transportit të Përbashkët/Komunitar; hartimi i të gjitha ligjeve, akteve nënligjore ose dispozitave zbatuese; takime ndërgjegjësimi me tregtarët; krijimin e skemës së menaxhimit dhe mirëmbajtjen e sistemit NCTS - Sistemi i ri i kompjuterizuar i tranzitit, një skemë e tillë e cila duhej të miratohej nga qeveria shqiptare, etj. nga DPD dhe AKSH-i megjithëse parashikohej të mbaronte në dhjetor të vitit 2020.

Gjithashtu konstatohet **se nuk janë hartuar planet e implementimit me aktivitetet e parashikuar për Implementimin e ITMS** *(Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Tarifave)* ku përmes këtij Projekti, duhet të hartohej legjislacioni, manualet dhe udhëzimet e reja në përputhje me standardet e BE-së për tarifat si dhe trajnimet përkatëse si dhe sistemeve të tjera të IT-së së BE-së nga DPD dhe AKSH-i megjithëse parashikohej të mbaronte në dhjetor të vitit 2020.

- Për objektivin ñ*Prezantim i një mjedisi të plotë pa letër*ò në plan veprimin parashikohet përmirësimi i sistemit ekzistues ASYCUDA në versionin më të fundit të disponueshëm, zhvillimi i një ndërfaqe ndërmjet sistemit tranzit dhe deklarimit, dhe përcaktohen qartë rolet dhe përgjegjësitë ndërmjet AKSH-it dhe Administratës Doganore.

Konstatohet se nuk janë respektuar afatet e mbarimit nga DPD dhe AKSH-i sipas planveprimit por rezulton se një pjesë e objektivave janë në proces realizimi.

.

Situatat e mësipërme dhe rekomandimet përkatëse si më poshtë:

Titulli i gjetjes:Plani i veprimit dhe implementimit Strategjik Institucional nuk është realizuar sipas plan veprimeve përkatëse, prioriteteve, periudhave të implementimit nga personat përgjegjës me indikatorëve matës.

Situata 1: Për objektivin: ñ*Zhvillimi, implementimi dhe rishikimi i rregullt i strategjisë afatgjatë të TI-së që mbështet prioritetet e biznesit*ò, ku në plan veprimin parashikohet hartimi i një strategjie afatgjatë në përputhje me nevojat e anëtarësimit në EU MASP dhe programin e punës së EU UCC, konstatohet se nuk është hartuar një strategji IT afatgjatë në përputhje me nevojat e anëtarësimit në EU MASP dhe programin e punës së EU UCC, megjithëse parashikohej të mbaronte në dhjetor të vitit 2019.

Situata 2: Për objektivinò ñ*Përmirësimi i TI-së në të gjitha strukturat e ndryshme hierarkike*ò, ku në plan veprimin parashikohet të përcaktohen qartë rolet dhe përgjegjësitë ndërmjet AKSH-it dhe Administratës Doganore, konstatohet se nuk ka një marrëveshje të përbashkët ose rregullore ku të përcaktohen rolet dhe përgjegjësitë ndërmjet AKSH-it dhe Administratës Doganore, megjithëse parashikohej të mbaronte në dhjetor të vitit 2018.
Situata 3: Për objektivin: ñ*Implementimi i NCTS, (Sistemin e Transitin Elektronik të Përbashkët) ITMS (Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Tarifave) dhe sistemeve të tjera të IT-së së BE-së*ò, ku në plan veprimin parashikohet hartimi i planeve të implementimit, përfitimi i burimeve dhe fondeve përkatës.
- Konstatohet se nuk janë hartuar planet e implementimit me aktivitetet e parashikuara për Implementimin e NCTS, (*Sistemin e Transitit Elektronik të Përbashkët*), nuk janë identifikuar boshllëqet dhe nevojat e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, duke përfshirë rekomandime për aktivitete të mëtejshme në fushën e Transportit të Përbashkët/Komunitar; hartimi i të gjitha ligjeve, akteve nënligjore ose dispozitave zbatuese; takime ndërgjegjësimi me tregtarët; krijimin e skemës së menaxhimit dhe mirëmbajtjen e sistemit NCTS.
- Sistemi i ri i kompjuterizuar i tranzitit, një skemë e tillë e cila duhej të miratohej nga qeveria shqiptare, etj., nga Administrata Doganore dhe AKSH-i, megjithëse parashikohej të mbaronte në dhjetor të vitit 2020.
- Gjithashtu konstatohet se nuk janë hartuar planet e implementimit me aktivitetet e parashikuar për Implementimin e ITMS (*Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Tarifave*), ku përmes këtij Projekti, duhet të hartohej legjislacioni, manualet dhe udhëzimet e reja në përputhje me standardet e BE-së për Tarifat si dhe trajnimet përkatëse si dhe sistemeve të tjera të IT-së së BE-së nga Administrata Doganore dhe AKSH-i, megjithëse parashikohej të mbaronte në dhjetor të vitit 2020.
Situata 4: Për objektivin: ñ*Prezantim i një mjedisi të plotë pa letër*ò, në plan veprimin parashikohet përmirësimi i sistemit ekzistues ASYCUDA në versionin më të fundit të disponueshëm, zhvillimi i një ndërfaqe ndërmjet sistemit tranzit dhe deklarimit dhe përcaktohen qartë rolet dhe përgjegjësitë ndërmjet AKSH-it dhe Administratës Doganore, konstatohet se nuk janë respektuar afatet e mbarimit nga Administrata Doganore dhe AKSH-i sipas planveprimit, por rezulton se janë në proces realizimi.
Kriteri: ñ*Strategjia e Biznesit e Administratës Doganore shqiptare 2018-2021*ò, praktikat më të mira, Plani i veprimit dhe implementimit Strategjik Institucional.
Ndikimi/Efekti: Teknologjia e Informacionit zhvillohet pa një Plan Strategjik. Nuk janë hartuar planet e implementimit me aktivitetet e parashikuara në strategji.
Shkaku: Nuk janë marrë masat e nevojshme për konkretizimin e planit strategjik 2018-2021.
Rëndësia: E lartë
Rekomandime:
DPD në bashkëpunim me Drejtorinë e TI, të marrë masa për hartimin dhe konkretizimin e Planit të veprimit dhe implementimit Strategjik Institucional për objektivat e planit strategjik institucional ñ*Strategjia e Biznesit e Administratës Doganore shqiptare 2018-2021*ò, implementimi i NCTS, ITMS dhe sistemeve të tjera të IT-së së BE-së në përputhje me nevojat e anëtarësimit në BE, EU MASP dhe programin e punës së EU UCC.

b. VKM nr. 284, datë 1.4.2015 ñ**Strategjia ndërsektoriale e AxhendësDixhitale 2015-2020”.**
-**Një nga objektivat (2)** është: ñ*Përmirësimi i infrastrukturës TIK në administratën publike për zhvillime të harmonizuara dhe integruara sipas standardeve ndërkombëtare për e-qeverisjen në të gjithë sektorët (shëndetësi, arsim, mjedis, bujqësi, turizëm, kulturë, energji, transport etj.) me qëllim ndërlidhjen 100% të të gjitha sistemeve deri në fund të 2020*ò.
Konsolidimi i infrastrukturës dixhitale në Administratën Publike;

- Rritjen e sigurisë përmes krijimit të Qendrës së Vazhdueshmërisë së Punës "BusinessContinuity Center dhe Backup" për Sistemet Qeveritare dhe "Qendrës së Rikuperimit nga Fatkeqësia" (DisasterRecoveryCentre –DRC)" për Sistemet Qeveritare;
Ky aktivitet synon përmirësimin dhe forcimin e kapaciteteve të infrastrukturës aktuale TIK, (shërbime dhe informacion).
DPD nuk disponon një infrastrukturë për vazhdueshmërinë e punës BCC (BusinessContinuity Center) për sigurinë e ruajtjes së të dhënave në rastet e dështimit të qendrës së të dhënave primare
Nuk ka një plan vazhdimësie (BCP) si dhe plan rimëkëmbje nga katastrofat (DRC) për garantimin e vazhdimësisë së ofrimit të shërbimit. Duke mos caktuar kështupersonat përgjegjës për të siguruar vazhdimësinë e ofrimit të shërbimit, si dhe nuk janë identifikuar dhe ndarë sipas rëndësisë të dhënat kritike, sistemet, operacionet dhe burimet.

- **Objektivi (6)** është ñ*Rrjete e Sisteme informacioni të sigurt*ò.
Zhvillimi i Qeverisjes Elektronike, Administratës Dixhitale dhe Ekonomisë Dixhitale, nuk mund të bëhet pa pasur një garanci efektive mbi sigurinë e rrjeteve të informacionit.
Për realizuar këtë objektiv dhe për të garantuar një shoqëri informacioni të sigurt dhe shërbime e -Qeverisjes të besueshme dhe të sigurta, do të ndiqen disa drejtime.

- *Përshtatja e kuadrit të duhur ligjor e rregullator për sigurinë informacionit dhe rrjeteve.*
- *Hartimin/implementimin e kërkesave bazë për administratën publike për nivelin e sigurisë së nevojshme në sektorin publik;*
- *Hartimi/implementimi i procedurës për menaxhimin e incidenteve. Monitorim periodik i zbatimit të kërkesave bazë dhe procedurave;*
- *Fushata ndërgjegjësimi ndaj rrezikut të krimit kibernetik:*
- *Krijimin e një portali ndërgjegjësimi me fokus sigurinë kompjuterike.*

Për realizimin e këtij objektivi nga institucionet përgjegjëse DPD dheAKSHI, nuk janë marrëmasa për rritjen e sigurisë në infrastrukturën kritike të teknologjisë së informacionit dhe zbatimin e kërkesave të larta teknike për bazat e të dhënave shtetërore etj.
Objektivat e kësaj strategjie gjithashtu nuk janë përfshirë në strategjinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave nëshkresën nr. 1976/1, datë 30.01.2018, hartuar dhe dërguarnga Ministria e Financës dhe Ekonomisë - MFE*"Strategjia e Biznesit e Administratës Doganore shqiptare 2018-2020".*

b/1. Në funksion të strategjisë së mësipërme, nga AKSHI është hartuar ñPlanveprimi i strategjisë AxhendaDixhitale e Shqipërisë 2015-2020ò, ku si **Prioriteti Strategjik 2** është përcaktuar: ñ*Politika për zhvillimin e infrastrukturës TIK dhe komunikimeve elektronike në të gjithë sektorët*ò
1. Ndërtimi i Qendrës së Vazhdueshmërisë së Punës "BusinessContinuity Center dhe Backup" për Sistemet Qeveritare. Me afat implementimi 2015-2017.
2. Ndërtimi i "Qendrës së Rikuperimit nga Fatkeqësia" (DisasterRecoveryCentre – DRC)" për Sistemet Qeveritare. Me afat implementimi 2015-2017.

Ky plan veprimi i AKSHI-t, ku janë përcaktuar prioritetet strategjike të AxhendësDixhitale të Shqipërisë, për periudhën 2015-2020, nuk është përfshirënë planveprimin e strategjisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, miratuar nga MFE me shkresën nr. 81, datë 17.12.2018 *"Strategjia e Biznesit e Administratës Doganore shqiptare 2018-2020".*

Titulli i gjetjes: Objektivat e Strategjisë Ndërsektoriale të AxhendësDixhitale të Shqipërisë për periudhën 2015-2020, miratuar nga Këshilli i Ministrave - KM nuk janë përfshirë në strategjinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Planveprimi i strategjisë i AKSHI-t ku janë përcaktuar prioritetet strategjike ndërsektoriale të Axhendësdixhitale të Shqipërisë, për periudhën 2015-2020, nuk është përfshirënë planveprimin e strategjisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Situata 1: Konsolidimi i infrastrukturës dixhitale në Administratën Publike për:

- Rritjen e sigurisë përmes krijimit të Qendrës së Vazhdueshmërisë së Punës ñ*BusinessContinuity Center dhe Backup*ò për Sistemet Qeveritare dhe ñ*Qendrës së Rikuperimit nga Fatkeqësia*ò (DisasterRecoveryCentre ï DRC)ò për Sistemet Qeveritare;

Ky aktivitet synon përmirësimin dhe forcimin e kapaciteteve të infrastrukturës aktuale TIK, (*shërbime dhe informacion*).

Objektivi i kësaj strategjie nuk është përfshirë në strategjinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

DPD nuk disponon një infrastrukturë për vazhdueshmërinë e punës BCC (BusinessContinuity Center) për sigurinë e ruajtjes së të dhënave në rastet e dështimit të qendrës së të dhënave primare.

Nuk ka një plan vazhdimësie (BCP) si dhe plan rimëkëmbje nga katastrofat (DRC), për garantimin e vazhdimësisë së ofrimit të shërbimit, duke mos caktuar kështupersonat përgjegjës për të siguruar vazhdimësinë e ofrimit të shërbimit, si dhe nuk janë identifikuar dhe ndarë sipas rëndësisë të dhënat kritike, sistemet, operacionet dhe burimet.

Situata 2: Një objektiv tjetër (6) është ñ*Për Rrjete e Sisteme informacioni të sigurt*ò.

Zhvillimi i Qeverisjes Elektronike, Administratës Dixhitale dhe Ekonomisë Dixhitale nuk mund të bëhet pa pasur një garanci efektive mbi sigurinë e rrjeteve të informacionit.

Objektivi i kësaj strategjie nuk është përfshirë në strategjinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Situata 3: Në funksion të strategjisë nga AKSHI, është hartuar ñPlanveprimi i strategjisë AxhendaDixhitale e Shqipërisë 2015-2020ò, ku si Prioriteti Strategjik 2, është përcaktuar: ñ*Politika për zhvillimin e infrastrukturës TIK dhe komunikimeve elektronike në të gjithë sektorët*ò:

1. Ndërtimi i Qendrës së Vazhdueshmërisë së Punës ñ*BusinessContinuity Center dhe Backup*ò për Sistemet Qeveritare. Me afat implementimi 2015-2017.
2. Ndërtimi i ñ*Qendrës së Rikuperimit nga Fatkeqësia*ò (DisasterRecoveryCentre ï DRC)ò për Sistemet Qeveritare. Me afat implementimi 2015-2017.

Ky plan veprimi i AKSHI-t ku janë përcaktuar prioritetet strategjike të Axhendësdixhitale të Shqipërisë për periudhën 2015-2020 nuk është përfshirënë planveprimin e strategjisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Kriteri: Strategjia Ndërsektoriale e AxhendësDixhitale të Shqipërisë, për periudhën 2015-2020,

Plan veprimi i AKSHI-t për prioritetet strategjike të Axhendësdixhitale të Shqipërisë për periudhën 2015-2020.

Ndikimi/Efekti: Teknologjia e Informacionit zhvillohet pa një Plan Strategjik.Nuk janë hartuar planet e implementimit me aktivitetet e parashikuara në strategji.

Shkaku: Nuk janë marrë masat e nevojshme për konkretizimin e planit të strategjisë ndërsektoriale të AxhendësDixhitale të Shqipërisë për periudhën 2015-2020.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandime:

Nga DPD, AKSHI të merren masat për përfshirjen në strategjinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, të Objektivave e Strategjisë Ndërsektoriale e AxhendësDixhitale të Shqipërisë për periudhën 2015-2020.

- Nga DPD, AKSHI të merren masat për rritjen e sigurisë në infrastrukturën kritike të teknologjisë së informacionit dhe zbatimin e kërkesave të larta teknike për bazat e të dhënave shtetërore etj.

- DPD në bashkëpunim me Drejtorinë e TIK të Doganave, të marrë masa për hartimin dhe konkretizimin e Planit të veprimit dhe implementimit Strategjik Institucional për objektivat e planit të strategjisë ndërsektoriale të AxhendësDixhitale të Shqipërisë për periudhën 2015-2020.
- Të merren masat për rritjen e sigurisë përmes krijimit të Qendrës së Vazhdueshmërisë së Punës ñ*BusinessContinuity Center dhe Backup*ò për Sistemet Qeveritare dhe ñ*Qendrës së Rikuperimit nga Fatkeqësia*ò (DisasterRecovery Center ï DRC)ò për Sistemet Qeveritare:
1. Ndërtimi i Qendrës së Vazhdueshmërisë së Punës "BusinessContinuity Center dhe Backup" për Sistemet Qeveritare.
2. Ndërtimi i "Qendrës së Rikuperimit nga Fatkeqësia" (DisasterRecovery Center – DRC)" për Sistemet Qeveritare.

c. Strategjia për Menaxhimin e Financave Publike, Shqipëri 2019-2022.
Një nga objektivat specifike (3) të kësaj strategjie është ñMbledhja e të ardhuraveò: ku është përcaktuar: ñ*Përmirësim i efikasitetit për mbledhjen e të ardhurave i cili do të sjellëmë shumë qëndrueshmëri për financimin e buxhetit në nivelet e qeverisë qendrore dhe vendore*ò.

Një nga komponentët e rëndësishëm (3.3) të këtij objekti specifik është: Menaxhimi doganor ku si objektiv kaò ñ*Mbrojtja e interesave financiar dhe ekonomik të Shqipërisë; kontributi për sigurinë e shoqërisë; lehtësimi i tregtisë; dhe bashkëpunimi me të gjithë aktorët e nevojshëm në nivel kombëtar ose ndërkombëtar*ò.
Në këtë kontekst rëndësi merr sidomos përafrimi ikuadrit rregullator të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (DPD) me acquis të BE-së, përmirësimi i ofrimit të shërbimit ndaj klientit me procesin e ri-inxhinierimitsi: procedurat e thjeshtuara, kontrollet e reja të sigurisë sipas profilit të operatorëve dhe futjes së menaxhimit doganor elektronik për të lehtësuar procesin e përputhshmërisë.

Në këtë fushë, në strategji konstatohet se mbeten ende mangësi (sistemi TIK) si:
• *Pak ecuri është bërë në drejtim të përdorimit proaktiv të njoftimeve elektronike për ngarkesat që mund të kenë rrezik të lartë shkeljeje;*
• *Prezantimin e një garancie të vetme për të gjithë llojet e transaksioneve dhe regjimeve që është në varësi të ngritjes së sistemit TI, i cili është vonuar;*
• *Gjithashtu, vonesa ka pasur kontraktimi i ITMS-së nga DPD-ja për t'u pajtuar me BE-ITMS.*

Gjithashtu konstatohet se nga Administrata Doganore dhe AKSH-i nuk janë hartuar planet e implementimit me aktivitetet e parashikuar për Implementimin e ITMS (Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Tarifave) ku përmes këtij Projekti, duhet të hartohej legjislacioni, manualet dhe udhëzimet e reja, në përputhje me standardet e BE-së për Tarifat dhe trajnimet përkatëse si dhe sistemeve të tjera të IT-së së BE-së, megjithëse parashikohej të mbaronte në dhjetor të vitit 2020.
Sipas Kapitullit 3 ñ*Qeverisja dhe koordinimi*ò, kjo strategji angazhon të gjithë sektorin publik dhe përgjegjësia e përgjithshme për një zbatim të suksesshëm të strategjisë është një përgjegjësi që ndahet mes të gjithë këtyre aktorëve në sektorin publik. (DPD)
Reformat e TI-së (3.8), që janë planifikuar brenda Objektivit Specifik përkatës, përfshijnë aktivitete të rëndësishme që kanë si qëllim përmirësimin dhe integrimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit (TI-së).
Disa nga komponentët dhe masat brenda strategjisë (reforma e TI-së) janë:
ÅZhvillimi dhe mirëmbajtja e një sistemi gjithëpërfshirës për menaxhimin e riskut (DPD)

ÅZgjerimi/rritja e përdorimit të SIFQ (Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë) dhe Integrimi i SIMBNJ (Sistemi Informatik i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore) dhe krijimi iinterfaces (ndërlidhje) me doganat.

Objektivat e kësaj strategjie gjithashtu nuk janë përfshirë në strategjinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, me shkresën nr. 1976/1, datë 30.01.2018, hartuar dhe dërguarnga MFE *"Strategjia e Biznesit e Administratës Doganore shqiptare 2018-2020".*

c/1. Në plan veprimin për realizimin e objektiva specifike sipas komponentëve (3.3) për menaxhimin e doganave, janë përcaktuar edhe masat për përmirësimin e mëtejshëm të sistemeve dhe platformave të TI-së dhe treguesit e performancës:
a) Zhvillimi, zbatimi dhe rishikimi i rregullt i strategjisë afatgjatë të TI që mbështet përparësitë e biznesit.
b) Përmirësimi i organizimit dhe menaxhimit të TI.
c) Implementimin e NCTS, ITEMS dhe sistemeve të tjera të TI të BE-së
(Institucioni udhëheqës është DPD)

Ky plan veprimi i MFE,në të cilinjanë përcaktuar masat për realizimin e objektivave specifike sipas komponentëve dhe treguesit e performancës ku institucioni udhëheqës është DPD, nuk është përfshirë në planveprimin e strategjisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, miratuar me nr. 81, datë 17.12.2018 *"Strategjia e Biznesit e Administratës Doganore shqiptare 2018-2020".*

Titulli i gjetjes: Objektivat (3) e Strategjisë për Menaxhimin e Financave Publike Shqipëri 2019-2022, ñ*Përmirësim i efikasitetit për mbledhjen e të ardhurave i cili do të sjellë më shumë qëndrueshmëri për financimin e buxhetit në nivelet e qeverisë qendrore dhe vendore*ò nuk janë të përfshira në strategjinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.
Plan veprimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE), Strategjia për Menaxhimin e Financave Publike Shqipëri 2019-2022 ku janë përcaktuar masat për realizimin e objektivave specifike sipas komponentëve dhe treguesit e performancës ku institucioni udhëheqës është DPD nuk është përfshirë në plan veprimin e strategjisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave
Situata 1: Një nga komponentët e rëndësishëm të objekti specifik (3.3) janë Menaxhimi doganor ku si objektiv ka: ñ*Mbrojtja e interesave financiar dhe ekonomik të Shqipërisë; kontributi për sigurinë e shoqërisë; lehtësimi i tregtisë; dhe bashkëpunimi me të gjithë aktorët e nevojshëm në nivel kombëtar ose ndërkombëtar*ò.
Në këtë kontekst rëndësi merr sidomos përafrimi ikuadrit rregullator të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (DPD) me acquis të BE-së, përmirësimi i ofrimit të shërbimit ndaj klientit me procesin e ri-inxhinierimit si: procedurat e thjeshtuara, kontrollet e reja të sigurisë sipas profilit të operatorëve dhe futjes së menaxhimit doganor elektronik për të lehtësuar procesin e përputhshmërisë.
Në këtë fushë në strategji konstatohet se mbeten ende mangësi (sistemi TIK) si:
• *Pak ecuri është bërë në drejtim të përdorimit proaktiv të njoftimeve elektronike për ngarkesat që mund të kenë rrezik të lartë shkelje;*
• *Prezantimin e një garancie të vetme për të gjithë llojet e transaksioneve dhe regjimeve që është në varësi të ngritjes së sistemit TI, i cili është vonuar;*
• *Gjithashtu, vonesa ka pasur kontraktimi i ITMS-së nga DPD-ja për t'u pajtuar me BE-ITMS.*

Situata 2: Sipas Kapitullit 3 ñ*Qeverisja dhe koordinimi*ò kjo strategji angazhon të gjithë sektorin publik dhe përgjegjësia e përgjithshme për një zbatim të suksesshëm të strategjisë, është një përgjegjësi që ndahet mes të gjithë aktorëve në sektorin publik. (DPD).
Reformat e TI-së (3.8) që janë planifikuar brenda Objektivit Specifik përkatës, përfshijnë aktivitete të rëndësishme që kanë si qëllim përmirësimin dhe integrimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit (TI-së).
Disa nga komponentët dhe masat brenda strategjisë (reforma e TI-së) janë:
• *Zhvillimi dhe mirëmbajtja e një sistemi gjithëpërfshirës për menaxhimin e riskut (DPD)*
• *Zgjerimi/rritja e përdorimit të SIFQ (Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë) dhe Integrimi i SIMBNJ (Sistemi Informatik i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore) dhe krijimi iinterfaces (ndërlidhje) me doganat.*
Objektivat e mësipërm të Strategjisë për Menaxhimin e Financave Publike Shqipëri 2019-2022, nuk janë përfshirë në strategjinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.
Situata 3: Konstatohet se nga Administrata Doganore dhe AKSH-i nuk janë hartuar planet e implementimit me aktivitetet e parashikuar për Implementimin e ITMS (*Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Tarifave*) ku përmes këtij Projekti, duhet të hartohej legjislacioni, manualet dhe udhëzimet e reja në përputhje me standardet e BE-së për Tarifat si dhe trajnimet përkatëse si dhe sistemeve të tjera të IT-së së BE-së megjithëse parashikohej të mbaronte në dhjetor të vitit 2020.
Kriteri: Strategjia për Menaxhimin e Financave Publike, Shqipëri 2019-2022, Plan veprimi i MFE për prioritetet strategjike në Menaxhimin e Financave Publike Shqipëri 2019-2022,
Ndikimi/Efekti: Teknologjia e Informacionit zhvillohet pa një Plan Strategjik. Nuk janë hartuar plan veprimi për implementimin e objektiva specifike sipas komponentëve për menaxhimin e doganave me aktivitetet e parashikuara në strategji.
Shkaku: Nuk janë marrë masat e nevojshme për konkretizimin e planit të Strategjisë për Menaxhimin e Financave Publike Shqipëri 2019-2022.
Rëndësia: E lartë
Rekomandime:
- Nga DPD dheAKSHI, të merren masat për përfshirjen në strategjinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të Objektivave të Strategjisë për Menaxhimin e Financave Publike Shqipëri 2019-2022
- Nga DPD dheAKSHI, të merren masat për hartimin e plan veprimit për realizimin e objektivave specifike sipas komponentëve për menaxhimin e doganave dhe masat për përmirësimin e mëtejshëm të sistemeve dhe platformave të TI-së dhe treguesit e performancës:
-Zhvillimi, zbatimi dhe rishikimi i rregullt i strategjisë afatgjatë të TI që mbështet përparësitë e biznesit.
- Përmirësimi i organizimit dhe menaxhimit të TI.
- Implementimin e NCTS, ITEMS dhe sistemeve të tjera të TI të BE-së.

d. VKM nr. 973, datë 02.12.2015 "Për miratimin e dokumentit të politikave për sigurinë kibernetike 2015 – 2017".
Qëllimi i këtij Dokumenti Politikash është të rishikojë dhe të koordinojë detyrimet që lindin nga angazhimet e marra për një hapësirë kibernetike të sigurt me qëllim që të sigurohet përmbushja e përgjegjësive nga të gjithë aktorët në mënyrë të koordinuar. Në këtë mënyrë mund të garantohet zhvillimi i mëtejshëm i shoqërisë së informacionit si një ambient i sigurt, i besueshëm dhe i hapur si dhe promovimin e vlerave dhe mundësive të ofruara nga përdorimi i hapësirës kibernetike.

AKSHI, është përgjegjëse për administrimin e infrastrukturës qeveritare të Çelësit Publik (PKI) dhe siguron pajtueshmërinë me nenin 19 të ligjit nr.9880, datë 25.2.2008 "*Për nënshkrimin elektronik*ò.
Në shërbimet që ofrohen në Qendrën e të Dhënave Qeveritare, për administratën publike, garanton autentifikim dhe identifikim të sigurt, internet të sigurt dhe DNS të sigurt.

Objektivat strategjike nuk janë përfshirë në planveprimin e strategjisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe AKSHI-t:

Objektivat strategjike që do të ndiqen për përmbushjen e **vizionit** ñ*Për një hapësirë kibernetike më të sigurtë, më të besueshme dhe më të qëndrueshme për qytetarët, biznesin dhe qeverinë në mbështetje të zhvillimit ekonomik dhe social të Shqipërisë*ò dhe respektimin e **parimeve** bazë:
Mbrojtja e të drejtave themelore të njeriut, lirinë e shprehjes, të dhënat personale dhe privatësinë; Akses për të gjithë; Përgjegjësi e përbashkët; Forcimi i bashkëpunimit dhe koordinimit: Bashkëpunimi ndërkombëtar:Administrimi i rrezikut: Respektimi i vlerave, janë:

- *Plotësimi i kuadrit ligjor në fushën e sigurisë kibernetike.*
a- Do të futet përdorimi sa më i gjerë i certifikatave për faqe interneti dhe web servera për të garantuar identitetin e sigurt të faqeve të institucioneve publike dhe kompanive të tjera private,
të cilat ofrojnë shërbime elektronike në bashkëveprim të institucioneve publike ndaj qytetarëve,
apo ndaj biznesit.
b- Urdhërimi/detyrimi i kryerjes së auditimit periodik dhe vlerësimit të përshtatshmërisë dhe efektivitetit të sigurisë së sistemeve të informacionit në përputhje me bazën ligjore dhe rregullatore në fuqi. Kjo, për të plotësuar legjislacionin aktualisht në fuqi që parashikon auditimin e databazave shtetërore duke lënë jashtë spektrit të veprimit sistemet në tërësi.
- *Forcimi i kuadrit institucional*
a- Vlerësimi i krijimit të strukturave të nevojshme respektive pranë institucioneve të tjera të administratës publike. Forcimi dhe mbështetja për rritjen e kapaciteteve në fushën e sigurisë kibernetike do jetë një proces i vazhdueshëm në mënyrë që shteti të shërbejë si model në sigurinë kibernetike.
- *Rritja e ndërgjegjësimit për sigurinë kibernetike.*
a- Shpërndarja dhe publikimi i informacionit mbi rreziqet e hapësirës kibernetike, nxjerrja e udhëzimeve dhe këshillave për një siguri minimale do jetë një proces i vazhdueshëm nëpërmjet
të cilit do synohet të rritet ndërgjegjësimi dhe siguria e përdoruesve të thjeshtë. Përveç publikimit të tyre në faqet zyrtare të internetit të institucioneve të specializuara do bashkëpunohet në mënyrë të ngushtë me median për të siguruar një informim sa më të gjerë dhe të shpejtë të publikut.
- *Identifikimi dhe mbrojtja e Infrastrukturave Kritike të Informacionit në Shqipëri.*
a) Krijimi i procedurave dhe proceseve të nevojshme për identifikimin, inventarizimin dhe garantimin e sigurisë të tyre. Krijimi dhe implementimi i procedurave dhe kërkesave minimale të sigurisë për këto sisteme do të jetë detyruese.
Lidhur me këtë objektiv një aspekt mjaft i rëndësishëm përveç mbrojtjes së këtyre sistemeve kritike është ñaftësia ripërtëritëseò (*resilience*), e cila mundëson garantimin e vazhdueshmërisë së biznesit në rastet e ndodhjes së forcave madhore apo të sulmeve të ndryshme kibernetike. Mbrojtja dhe aftësia ripërtëritëse e infrastrukturave kritike si dhe inkurajimi i operatorëve që i zotërojnë ato për implementimin e një arkitekture sigurie të

plotë (përfshirë menaxhimin e riskut dhe të emergjencave), do të garantojë efektivitetin, besueshmërinë dhe vazhdueshmërinë e shërbimeve të ofruara prej tyre.
c) Përcaktimi i bazës ligjore/rregullative mbi të cilën operatorët e infrastrukturave kritike do të duhet të raportojnë mbi incidentet e rënda kibernetike. Për çdo rast (të evidentuar ose jo) si krim kibernetik duhet të bëhet analiza e tij, shkaqet e ndodhjes dhe nxjerrja e detyrave që duhet të reflektohen në akte ligjore apo rregullore e procedura për eliminimin e përsëritjes së rastit.
- Krijimi dhe implementimi i kërkesave minimale të sigurisë kibernetike.
a) Standarde, udhëzime dhe procedura të bazuara në praktikat më të mira ndërkombëtare duhet të përshtaten dhe miratohen për t'u zbatuar në administratën shtetërore.
b) Krijimi dhe miratimi i procedurave të analizës të rrezikut të sigurisë për sistemet e përdorura
dhe shërbimet elektronike të ofruara nga institucionet është prioritet. Analiza e rrezikut do të jetë një proces i vazhdueshëm dhe do kryhet në mënyrë periodike. Zbatimi i tyre do jetë një nga elementët kyç për rritjen e nivelit të sigurisë kibernetike.
c) Zhvillimi i mëtejshëm i procedurave për koordinimin e investimeve me synim analizimin e sigurisë dhe harmonizimin e projekteve që në fazat e projektimit.
d) Do të identifikohen sistemet e rëndësishme në administratën shtetërore dhe institucionet do të investojnë në hardware dhe software të automatizuara si masa proaktive dhe reaktive për të siguruar këto sisteme që administrojnë.
e) Do të ngrihen BCC (BusinessContinuity Center) dhe DRC (DisasterRecovery Center) për rrjetet/sistemet shtetërore.
f) Do të ngrihet një sistem monitorimi, i cili do t'i njoftonte në kohë institucionet për rreziqet kibernetike që u kanosen duke monitoruar 24\7 nyjet më të rëndësishme, trafikun dhe eventet që ndodhin në sistem për të mundësuar edhe nxjerrjen e konkluzioneve nga log-et që ruhen, pa ndërhyrë apo monitoruar përmbajtjen.
- Forcimi i partneritetit me struktura të tjera përgjegjëse të fushës brenda dhe jashtë vendit
a) Rritja e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet institucioneve shtetërore do të forcohet për
të garantuar ndërveprimin dhe koordinimin në forcimin e sigurisë dhe minimizimin e dëmeve nga sulmet kibernetike.
- Rritja e nivelit të njohurive, aftësive dhe kapaciteteve për ekspertizë në fushën e sigurisë kibernetike
Në afatshkurtër dhe afatmesëm, do të realizohen aktivitete me qëllim ngritjen e kapaciteteve të
burimeve njerëzore të nevojshme në fushën e sigurisë kibernetike.
a) Në kuadër të forcimit të institucioneve, do të rriten kapacitetet teknike të burimeve njerëzore. Kjo do të bëhet përmes programeve të zgjedhura të trajnimeve të cilat do të synojnë aftësimin e pjesëmarrësve në parandalimin e sulmeve, minimizimin e dëmeve, dhënien e përgjigjes efektive ndaj incidenteve të sigurisë së informacionit.
b) Pjesëmarrja aktive në konferenca ndërkombëtare, takime, seminare dhe ushtrime që kanë të bëjnë me sigurinë kibernetike. Shkëmbimi i informacioneve, analizave, eksperiencave, krijimi i projekteve të përbashkëta, vlerësimi i teknologjive dhe sistemeve të sigurisë shihen jo vetëm si një mundësi për rritjen e sigurisë kibernetike në institucionet publike, por dhe si një investim për zhvillimin dhe rritjen e kapaciteteve të brezave pasardhës.

Qëllimi i këtij Dokumenti Politikash, Objektivat strategjike që do të ndiqen për përmbushjen e vizionit për politikat e sigurisë kibernetike 2015-2017, nuk janë përfshirë në strategjinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave hartuar dhe dërguar nga MFE për ñStrategjia e Biznesit e Administratës Doganore shqiptare 2018-2020ò gjithashtu nuk është përfshirënë

planveprimin e strategjisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, miratuar nga MFE me nr. 81, datë 17.12.2018 ñStrategjia e Biznesit e Administratës Doganore shqiptare 2018-2020ò.

Titulli i gjetjes: Mungesa e objektivave të strategjisë dhe përfshirja në plan veprimin nga DPD dhe AKSHI.
Situata:Dokumenti i politikave për sigurinë kibernetike 2015 ï 2017 nuk është përfshirë në Strategjinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave qëllimi i të cilit është të rishikojë dhe të koordinojë detyrimet që lindin nga angazhimet e marra për një hapësirë kibernetike të sigurt me qëllim që të sigurohet përmbushja e përgjegjësive nga të gjithë aktorët në mënyrë të koordinuar.

Gjithashtu nuk është përfshirë në plan veprimin e strategjisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave ku të përcaktohen masat për realizimin e objektivave specifike sipas komponentëve dhe treguesit e performancës.
A. Në dokumentin e politikave janë përcaktuar **objektivat strategjike** që duhet të ndiqen për përmbushjen e vizionit dhe respektimin e parimeve bazë të cilat **nuk janë përfshirë në planveprimin e strategjisë** së Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe AKSHI-t si:
- Plotësimi i kuadrit ligjor në fushën e sigurisë kibernetike.
a- Futja përdorimi sa më i gjerë i certifikatave për faqe interneti dhe web servera për të garantuar identitetin e sigurt të faqeve të institucioneve publike .
b-Detyrimi i kryerjes së auditimit periodik dhe vlerësimit të përshtatshmërisë dhe efektivitetit të sigurisë së sistemeve të informacionit në përputhje me bazën ligjore dhe rregullatorë në fuqi. Kjo, për të plotësuar legjislacionin aktualisht në fuqi që parashikon auditimin e databazave shtetërore duke lënë jashtë spektrit të veprimit sistemet në tërësi.
- Forcimi i kuadrit institucional.
a- Vlerësimi i krijimit të strukturave të nevojshme respektive pranë institucioneve të tjera të administratës publike, ku Forcimi dhe mbështetja për rritjen e kapaciteteve në fushën e sigurisë kibernetike do jetë një proces i vazhdueshëm në mënyrë që shteti të shërbejë si model në sigurinë kibernetike.
- Rritja e ndërgjegjësimit për sigurinë kibernetike.
- *Shpërndarja dhe publikimi i informacionit mbi rreziqet e hapësirës kibernetike*, nxjerrja e udhëzimeve dhe këshillave për një siguri minimale do jetë një proces i vazhdueshëm nëpërmjet të cilit do synohet të rritet ndërgjegjësimi dhe siguria e përdoruesve të thjeshtë. Përveç publikimit të tyre në faqet zyrtare të internetit të institucioneve të specializuara do bashkëpunohet në mënyrë të ngushtë me median për të siguruar një informim sa më të gjerë dhe të shpejtë të publikut.

B. Në dokumentin e politikave janë përcaktuar objektivat strategjike që duhet të ndiqen për përmbushjen e vizionit dhe respektimin e parimeve bazë të cilat **nuk janë përfshirë në plan veprimin e strategjisë** së Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe AKSHI-t si:
- Identifikimi dhe mbrojtja e Infrastrukturave Kritike të Informacionit në Shqipëri.
a. Krijimi i procedurave dhe proceseve të nevojshme për identifikimin, inventarizimin dhe garantimin e sigurisë të tyre.
b. Përcaktimi i bazës rregullative mbi të cilën operatorët e infrastrukturave kritike do të duhet të raportojnë mbi incidentet e rënda kibernetike.
- Krijimi dhe implementimi i kërkesave minimale të sigurisë kibernetike.
a. Standarde, udhëzime dhe procedura të bazuara në praktikat më të mira ndërkombëtare duhet të përshtaten dhe miratohen për tâu zbatuar në administratën shtetërore.

b. Krijimi dhe miratimi i procedurave të analizës të rrezikut të sigurisë për sistemet e përdorura dhe shërbimet elektronike të ofruara nga institucionet është prioritet. Analiza e rrezikut të jetë një proces i vazhdueshëm dhe të kryhet në mënyrë periodike.
c. Do të ngrihen BCC (*BusinessContinuity Center*) dhe DRC (*DisasterRecovery Center*) për rrjetet/sistemet shtetërore.
d. Të ngrihet një sistem monitorimi, i cili do tëi njoftonte në kohë institucionet për rreziqet kibernetike që u kanosen duke monitoruar 24\7 nyjet më të rëndësishme, trafikun dhe eventet që ndodhin në sistem për të mundësuar edhe nxjerrjen e konkluzioneve nga log-et që ruhen, pa ndërhyrë apo monitoruar përmbajtjen.
- Forcimi i partneritetit me struktura të tjera përgjegjëse të fushës brenda dhe jashtë vendit.
a. Rritja e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet institucioneve shtetërore do të forcohet për të garantuar ndërveprimin dhe koordinimin në forcimin e sigurisë dhe minimizimin e dëmeve nga sulmet kibernetike.
- Rritja e nivelit të njohurive, aftësive dhe kapaciteteve për ekspertizë në fushën e sigurisë kibernetike.
Të realizohen aktivitete me qëllim ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore të nevojshme në fushën e sigurisë kibernetike.
a. Në kuadër të forcimit të institucioneve, të rriten kapacitetet teknike të burimeve njerëzore. Kjo do të bëhet përmes programeve të zgjedhura të trajnimeve të cilat do të synojnë aftësimin e pjesëmarrësve në parandalimin e sulmeve, minimizimin e dëmeve, dhënien e përgjigjes efektive ndaj incidenteve të sigurisë së informacionit.
b. Pjesëmarrja aktive në konferenca ndërkombëtare, takime, seminare dhe ushtrime që kanë të bëjnë me sigurinë kibernetike. Shkëmbimi i informacioneve, analizave, eksperiencave, krijimi i projekteve të përbashkëta, vlerësimi i teknologjive dhe sistemeve të sigurisë shihen jo vetëm si një mundësi për rritjen e sigurisë kibernetike në institucionet publike, por dhe si një investim për zhvillimin dhe rritjen e kapaciteteve të brezave pasardhës.

Konstatohet se nga DPD nuk janë marrë masat e nevojshme për hartimin dhe konkretizimin e planit të objektivave strategjike sipas komponentëve për dokumentin e politikave për sigurinë kibernetike 2015 ï 2017.
Kriteri: Dokumenti i politikave për sigurinë kibernetike 2015 ï 2017ò, për një hapësirë kibernetike më të sigurt, më të besueshme dhe më të qëndrueshme për qytetarët, biznesin dhe qeverinë në mbështetje të zhvillimit ekonomik dhe social të Shqipërisë.
Ndikimi/Efekti: Teknologjia e Informacionit zhvillohet pa një Plan Strategjik.
Nuk janë hartuar plan veprimi për implementimin e objektivave strategjike sipas komponentëve për dokumentin e politikave për sigurinë kibernetike 2015 ï 2017.
Shkaku: Nuk janë marrë masat e nevojshme për hartimin dhe konkretizimin e planit të objektivave strategjike sipas komponentëve për dokumentin e politikave për sigurinë kibernetike 2015 ï 2017.
Rëndësia: E lartë
Rekomandime:
- Nga DPD, AKSHI të merren masat për përfshirjen në strategjinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të objektivave strategjike sipas komponentëve për dokumentin e politikave për sigurinë kibernetike 2015 ï 2017.
- Gjithashtu nga DPD, AKSHI të merren masat për hartimin e plan veprimit për implementimin e objektivave strategjike sipas komponentëve për dokumentin e politikave për sigurinë kibernetike 2015 ï 2017 si:
- *Plotësimi i kuadrit ligjor në fushën e sigurisë kibernetike.*
- *Forcimi i kuadrit institucional.*
- *Rritja e ndërgjegjësimit për sigurinë kibernetike.*

- Identifikimi dhe mbrojtja e Infrastrukturave Kritike të Informacionit në Shqipëri.
- Krijimi dhe implementimi i kërkesave minimale të sigurisë kibernetike.
- Forcimi i partneritetit me struktura të tjera përgjegjëse të fushës brenda dhe jashtë vendit
- Rritja e nivelit të njohurive, aftësive dhe kapaciteteve për ekspertizë në fushën e sigurisë kibernetike.

Në listën e infrastrukturës kritike të informacionit në sektorin qeveritar është përfshirë operatori administrues DPD, AKSHI, me sistemin kritik ñ*Sistemi i Automatizuar i të Dhënave Doganor*eò i cili ***nuk ka përcaktuar, pikën e kontaktit, person përgjegjës,*** për infrastrukturat kritike dhe të rëndësishme të informacionit, dhe t'ia komunikojnë Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike.
Sa konstatuar më lart është në kundërshtim me VKM nr. 553, datë 15.07.2020 ñ*Për miratimin e listës së infrastrukturës kritike të informacionit dhe listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit*ò,e cila përcaktoninfrastrukturën e informacionit të DPD si kritike dhe të rëndësishme***, ku thuhet se operatorët e infrastrukturave kritike***, brenda 15 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, pikën e kontaktit, person përgjegjës për infrastrukturat kritike dhe te rëndësishme të informacionit, dhe t'ia komunikojnë Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike.

Operatori iinfrastrukturës kritike të informacionit; DPD, AKSHI, nuk kanë marrë masa sigurie për rritjen e sigurisë së informacionit në sistemin kritik ñ*Sistemi i Automatizuar i të Dhënave Doganor*eò, nuk i kanë zbatuar dhe nuk kanë dokumentuar zbatimin e tyre.
Sa më lart është në kundërshtim me ligjin nr.2, datë 26.01.2017 ñ*Për sigurinë kibernetike*ò Neni 8,ñMasat e sigurisëò, ku është përcaktuar se:
1. Në masat e sigurisë përfshihet tërësia e veprimeve për rritjen e sigurisë së informacionit në sistemet e informacionit dhe disponueshmërinë e besueshmërinë e shërbimeve e të rrjeteve të komunikimit në hapësirën kibernetike.
2. Operatorët e infrastrukturës kritike të informacionit dhe operatorët e infrastrukturës së rëndësishme të informacionit janë të detyruar të zbatojnë masat e sigurisë, si dhe të dokumentojnë zbatimin e tyre.
3. Operatorët e infrastrukturës kritike të informacionit dhe operatorët e infrastrukturës së rëndësishme të informacionit janë të detyruar të zbatojnë kërkesat e masave të sigurisë gjatë ngritjes së infrastrukturës.

Titulli i gjetjes:Operatori i infrastrukturës kritike të informacionit; DPD, AKSHI, nuk kanë marrë masa sigurie për rritjen e sigurisë së informacionit në sistemin kritik ñ*Sistemi i Automatizuar i të Dhënave Doganore*ò, nuk ka përcaktuar, pikën e kontaktit, person përgjegjës AKCESK.
Situata: **-** Në listën e infrastrukturës kritike të informacionit në sektorin qeveritar është përfshirë operatori administrues DPD, AKSHI, me sistemin kritik ñ*Sistemi i Automatizuar i të Dhënave Doganor*eò i cili ***nuk ka përcaktuar, pikën e kontaktit, person përgjegjës*** për infrastrukturat kritike dhe të rëndësishme të informacionit, dhe t'ia komunikojnë Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike.
Sa konstatuar më lart është në kundërshtim me VKM nr. 553, datë 15.07.2020 ñ*Për miratimin e listës së infrastrukturës kritike të informacionit dhe listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit*ò.
- Operatori i infrastrukturës kritike të informacionit; DPD, AKSHI, nuk kanë marrë masa sigurie për rritjen e sigurisë së informacionit në sistemin kritik ñ*Sistemi i Automatizuar i të Dhënave Doganor*eò nuk i kanë zbatuar dhe nuk kanë dokumentuar zbatimin e tyre.

Mos marrja e masave të sigurisë cenon sigurinë e informacionit në sistemet e informacionit dhe disponueshmërinë e besueshmërinë e shërbimeve në sistemin kritik ñ*Sistemi i Automatizuar i të Dhënave Doganor*eò.
.Sa më lart është në kundërshtim me ligjin nr.2, datë 26.01.2017 ñ*Për sigurinë kibernetike*ò Neni 8, ñMasat e sigurisëò, VKM nr. 553, datë 15.07.2020 ñ*Për miratimin e listës së infrastrukturës kritike të informacionit dhe listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit*ò, pika 3 dhe 4.
Kriteri: Ligji nr.2, datë 26.01.2017 ñ*Për sigurinë kibernetike*ò neni, VKM nr. 553, datë 15.07.2020 ñ*Për miratimin e listës së infrastrukturës kritike të informacionit dhe listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit*òneni/pika ....
Ndikimi/Efekti: Mos marrja e masave të sigurisë cenon sigurinë e informacionit në sistemet e informacionit dhe disponueshmërinë e besueshmërinë e shërbimeve në sistemin kritik ñ*Sistemi i Automatizuar i të Dhënave Doganor*eò .
Shkaku:DPD, AKSHI, nuk ka përcaktuar, pikën e kontaktit, person përgjegjës për infrastrukturat kritike dhe të rëndësishme të informacionit dhe nuk kanë marrë masa sigurie për rritjen e sigurisë së informacionit në sistemin kritik ñ*Sistemi i Automatizuar i të Dhënave Doganore*ò.
Rëndësia: E lartë
Rekomandime:
- Nga DPD në bashkëpunim me AKSHI-n të merren masat e nevojshme për përcaktimin e pikës së kontaktit, personin përgjegjës për infrastrukturat kritike dhe të rëndësishme të informacionitñ*Sistemi i Automatizuar i të Dhënave Doganor*eòdhe t'ia komunikojnë Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike.
- Nga operatori i infrastrukturës kritike të informacionit, DPD, AKSHI, të merren marren masa sigurie për rritjen e sigurisë së informacionit në sistemin kritik ñ*Sistemi i Automatizuar i të Dhënave Doganor*eò duke i zbatuar dhe dokumentuar zbatimin e tyre.

Për sa është konstatuar më lart, mbajnë përgjegjësi:
z. IM,me detyrë Drejtori iBurimeve Mbështetëse sipas detyrave funksionale të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Administratës Doganore, nenet 9 dhe 63, miratuar nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë menr. 146, datë 07.05.2018.
z. ED me detyrë Drejtori iDrejtorisë TIK të Doganave, sipas detyrave funksionale të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme ñMbi Detyrat dhe Funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionitò, neni 22, miratuar nga AKSHI menr. 1900, datë 16.04.2020.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar nuk është paraqitur observacion mbi Projekt raportin e Auditimit.

2.2.Auditimi i Menaxhimit të ndryshimit.

Objekti i kësaj pike auditimi është: Vlerësimi nëse institucioni ka implementuar procedura të standardizuara për kontrollin e të gjitha ndryshimeve në sistemet dhe aplikacionet kryesore të IT.
Menaxhimi i Incidenteve dhe Problemeve
Menaxhimi i incidenteve, janë sistemet dhe praktikat e përdorura për të përcaktuar nëse incidentet ose gabimet janë regjistruar, analizuar dhe zgjidhur brenda një afati. Menaxhimi i problemeve ka si qëllim të zgjidhë çështjet nëpërmjet investigimit dhe me analiza të thella, të incidenteve të mëdha ose të përsëritura, për të gjetur shkakun e ndodhjes.

Në Rregulloren e Brendshme ñMbi Organizimin dhe Funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganaveò dhe të Rregullores së brendshme ñMbi Organizimin dhe Funksionimin e Degëve Doganoreò, miratuar me Urdhër të Ministrit të MFE nr. 146, datë 07.05.2018, neni 4, pika 1, shprehet qartë mbështetja në parimet strategjike që duhen ndjekur. Rrjedhimisht nga Strategjia 2015-2017, duhen ndjekur dhe përmbushur nga DPD ,objektivat strategjik lidhur me identifikimin dhe mbrojtjen e infrastrukturës kritike të informacionit si dhe krijimin dhe implementimin e kërkesave minimale të sigurisë kibernetike.
Një nga shërbimet e ofruara edhe sipas VKM nr. 673, datë 22.11.2017 ñ*Për riorganizimin e agjencisë kombëtare të shoqërisë së informacionit*ò, është administrimi i incidenteve, problemeve dhe disponueshmërisë. Me anë të procedurës së administrimit të incidenteve, ofruesi i shërbimit (AKSHI) duhet të ketë një bazë të të dhënave të gabimeve të njohura dhe historikun e incidenteve të mëparshme.
Nga auditimi u konstatua se:
- DPD, nuk disponon procedura mbi menaxhimin e incidenteve dhe problemeve, si dhe nuk ka të dokumentuar një plan masash për trajtimin e problemeve dhe incidenteve që mund të ndodhin. Në mungesë të këtyre procedurave të shkruara, problemet dhe incidentet për periudhën nën auditim, menaxhohen mbi bazë ngjarjesh, të cilat raportohen nëpërmjet e-mail-eve.
- DPD, nuk identifikon dhe disponon raporte të administrimit të incidenteve dhe problemeve, me qëllim parandalimin e tyre në të ardhmen.
Duke mos realizuar identifikimin e problemeve dhe incidenteve, DPD rrezikon që këto probleme, incidente të përsëriten dhe mënyra dhe koha e zgjidhjes së tyre të jetë e papërcaktuar, duke rrezikuar mbarëvajtjen e punës së sistemeve, ndërprerjen e shërbimeve, etj. Identifikimi i problemeve dhe incidenteve çon në gjetjen e zgjidhjeve për tôi trajtuar ato dhe për të parandaluar ndodhjen e incidenteve të ngjashme në të ardhmen dhe në mënyrë që shërbimet e institucionit të mos komprometohen.

Menaxhimi i Ndryshimit
Nga auditimi u konstatua se, DPD nuk disponon procedura për inicimin, rishikimin dhe aprovimin e ndryshimeve, klasifikimin e tyre sipas rëndësisë, ndarjen e detyrave dhe përgjegjësive për kryerjen e ndryshimeve.
DPD nuk ka akte rregullatore të miratuara sipas kërkesave ligjore, parashikuar në Rregulloren Evropiane 910/2014 ñMbi identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara për transaksionet elektronike në tregun e brendshmò dhe VKM nr. 553, datë 15.07.2020, përkatësisht:

- Rregullore mbi mbarëvajtjen dhe mënyrën e dokumentimit të masave të sigurisë;
- Rregullore për kategoritë e incidenteve kibernetike si dhe formatin dhe elementët e raportimit;
- Rregullore për administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike;
- Rregullore për menaxhimin e Firewall;
- Rregullore për menaxhimin e log-eve dixhitalenë administratën publike.

Menaxhimi i ndryshimeve emergjente dhe dokumentim i tyre.
Ndryshimet emergjente nuk mund të presin të kalojnë përgjatë procedurave të kontrollit të ndryshimit dhe duhet të implementohen me minimumin e vonesave.
- Në DPD u konstatua se, procedura dhe raporte të menaxhimit të ndryshimeve emergjente nuk ka.
Për zgjidhjen e këtyre problemeve komunikimi bëhet nëpërmjet e-mail-it.
DPD duhet të ndërgjegjësohet periodikisht duke u trajnuar, rreth politikave dhe procedurave në lidhje me përdorimin e duhur të rrjetit, sistemeve, etj. Në rastet e këtyre ngjarjeve duhet të përfshihet personeli i duhur në investigimin e tyre duke mos cenuar kështu integritetin e të

dhënave. Stafi duhet të jetë i trajnuar dhe i ndërgjegjshëm për përgjegjësitë e tyre referuar parandalimit, zvogëlimit, dhe reagimit ndaj situatave emergjente.
Detyrë funksionale e Sektorit të trajnimeve dhe Etikës në DPD është bashkëpunimi me drejtoritë dhe degët doganore, bazuar në kërkesat për trajnim, kryen analizat e nevojshme për trajnim dhe bazuar në këtë analizë harton planin vjetor të trajnimeve, që më pas miratohet nga Drejtori i Përgjithshëm. Nga auditimi rezulton që DPD nuk ka analizuar, identifikuar dhe planifikuar nevojat për trajnim të punonjësve për Sigurinë e Informacionit, në përmbushje të nevojave të përgjithshme dhe specifike që ndihmojnë në mbarëvajtjen dhe funksionimin e veprimeve dhe procedurave të këtij institucioni. Sa më sipër është në kundërshtim me nenin 62, pika 4.2 e Rregullores së DPD.
-Nga auditimi u konstatua se DPD nuk ka zhvilluar trajnime që ndihmojnë në mbarëvajtjen dhe funksionimin e veprimeve dhe procedurave të këtij institucioni, çfarë sjell një risk në mos përmbushjes së veprimtarisë institucionale dhe përgjigjes ndaj emergjencave.

Nga auditimi u konstatua se DPD:
- Nuk disponon procedura mbi menaxhimin e incidenteve dhe problemeve, si dhe nuk ka të dokumentuar një plan masash për trajtimin e problemeve dhe incidenteve që mund të ndodhin. Në mungesë të këtyre procedurave të shkruara, problemet dhe incidentet për periudhën nën auditim menaxhohen mbi bazë ngjarjesh të cilat raportohen nëpërmjet e-mail-eve.
- Nuk identifikon dhe disponon raporte të administrimit të incidenteve dhe problemeve, me qëllim parandalimin e tyre në të ardhmen. Duke mos identifikuar problemet apo incidentet, DPD rrezikon përsëritjen e tyre, kohën e papërcaktuar për zgjidhjen apo ndërprerje të shërbimeve.
- Nuk disponon procedura për inicimin, rishikimin dhe aprovimin e ndryshimeve, klasifikimin e tyre sipas rëndësisë, ndarjen e detyrave dhe përgjegjësive për kryerjen e ndryshimeve.
- Nuk ka akte rregullatore të miratuara sipas kërkesave ligjore të lartpërmendura.
- Nuk ka procedura dhe raporte të menaxhimit të ndryshimeve emergjente.
- Nuk janë zhvilluar trajnime që ndihmojnë në mbarëvajtjen dhe funksionimin e veprimeve dhe procedurave të këtij institucioni.

1. Titulli i gjetjes:DPD nuk ka procedura mbi ndryshimet që kryen në Teknologjinë e Informacionit.
Situata: Nga auditimi u konstatua se DPD nuk disponon procedura për inicimin, rishikimin dhe aprovimin e ndryshimeve, klasifikimin e tyre sipas rëndësisë, ndarjen e detyrave dhe përgjegjësive për kryerjen e ndryshimeve.
Kriteri: Rregulloren Evropiane 910/2014 ñ*Mbi identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara për transaksionet elektronike në tregun e brendshëm*ò dhe VKM nr. 553, datë 15.07.2020 ñ*Për miratimin e listës së infrastrukturës kritike të informacionit dhe listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit*ò, pika 3 dhe 4.
Objektivat e Kontrollit të Teknologjisë së Informacionit ï COBIT, paragrafi DI6 Menaxhimi i ndryshimeve.
Ndikimi/efekti: Një ndryshim i paaprovuar ose aksidental mund të sjellë pasoja financiare për institucionin.
Shkaku: Mos iniciativë e DPD për hartimin e procedurave mbi ndryshimet.
Rëndësia: E lartë.
Rekomandimi: Drejtoria së Përgjithshme të Doganave të marrin masat e nevojshme për hartimin e procedurave për inicimin, rishikimin dhe aprovimin e ndryshimeve, klasifikimin e tyre sipas rëndësisë, ndarjen e detyrave dhe përgjegjësive për kryerjen e ndryshimeve.

2. Titulli i gjetjes: DPD nuk ka kryer trajnime të punonjësve mbi sigurinë e informacionit.
Situata: Nga auditimi u konstatua se DPD nuk ka analizuar, identifikuar dhe planifikuar nevojat për trajnim të punonjësve për Sigurinë e Informacionit, në përmbushje të nevojave të përgjithshme dhe specifike që ndihmojnë në mbarëvajtjen dhe funksionimin e veprimeve dhe procedurave të këtij institucioni.
Kriteri: Rregulloren Evropiane 910/2014 ñ*Mbi identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara për transaksionet elektronike në tregun e brendshëm*ò dhe VKM nr. 553, datë 15.07.2020 ñ*Për miratimin e listës së infrastrukturës kritike të informacionit dhe listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit*ò, pika 3 dhe 4.
Objektivat e Kontrollit të Teknologjisë së Informacionit ï COBIT, paragrafi DM 7 Edukimi dhe trajnimi i përdoruesve dheligji nr. 10296, datë 08.07.2010 ñ*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*ò.
Ndikimi/Efekti: Risk i mos përmbushjes së veprimtarisë institucionale dhe përgjigjes ndaj emergjencave.
Shkaku: Mungesë trajnimi mbi sigurinë e informacionit.
Rëndësia: E lartë
Rekomandimi:DPD të hartojë plane për zhvillimin e trajnimeve në lidhje me sigurinë e informacionit në përmbushje të nevojave të përgjithshme dhe specifike që ndihmojnë në mbarëvajtjen dhe funksionimin e veprimeve dhe procedurave të këtij institucioni.

3. Titulli i gjetjes: Nga auditimi u konstatua se DPD nuk ka akte rregullatore të miratuara, e përkatësisht:
- Rregullore mbi mbarëvajtjen dhe mënyrën e dokumentimit të masave të sigurisë;
- Rregullore për kategoritë e incidenteve kibernetike si dhe formatin dhe elementët e raportimit;
- Rregullore për administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike;
- Rregullore për menaxhimin e Firewall;
- Rregullore për menaxhimin e log-eve digjitale në administratën publike.

Kriteri: Rregullorja Evropiane 910/2014 ñ*Mbi identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara për transaksionet elektronike në tregun e brendshëm*ò dhe VKM nr. 553, datë 15.07.2020 ñ*Për miratimin e listës së infrastrukturës kritike të informacionit dhe listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit*ò, pika 3 dhe 4.
Objektivat e Kontrollit të Teknologjisë së Informacionit ï COBIT paragrafi MV2 Monitorimi dhe vlerësimi i kontrollit të brendshëm.VKM nr. 553, datë 15.07.2020 ñPër miratimin e listës së infrastrukturave kritike të informacionit dhe të listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionitò.
Ndikimi/efekti: Mungesë e akteve rregullatore.
Shkaku: Mosveprim nga DPD për hartimin e akteve rregullatore.
Rëndësia: E lartë.
Rekomandimi: DPD të marrë masat e nevojshme për hartimin dhe miratimin e:
- Rregullore mbi mbarëvajtjen dhe mënyrën e dokumentimit të masave të sigurisë;
- Rregullore për kategoritë e incidenteve kibernetike si dhe formatin dhe elementët e raportimit;
- Rregullore për administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike;
- Rregullore për menaxhimin e Firewall;
- Rregullore për menaxhimin e log-eve digjitale në administratën publike.

Për sa është konstatuar më lart, mbajnë përgjegjësi:

z. IM me detyrë Drejtori i Burimeve Mbështetëse sipas detyrave funksionale të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Administratës Doganore, nenet 9 dhe 63, miratuar nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë menr. 146, datë 07.05.2018.
z. ED me detyrë Drejtori i Drejtorisë TIK të Doganave, sipas detyrave funksionale të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të AKSHI-t ñMbi Detyrat dhe Funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionitò, neni 22, miratuar nga AKSHI, menr. 1900, datë 16.04.2020.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar nuk është paraqitur observacion mbi Projekt raportin e Auditimit.

2.3. Auditimi i zhvillimit dhe blerjes në teknologjinë e informacionit

a. Identifikimi, hartimi i nevojave dhe kritereve të vendosura për mallra dhe shërbime
b. Procedurat e investimeve në fushën e TIK dhe Marrëveshjet e Nivelit të Shërbimit (ServiceLevelAgreement).
Në zbatim të programit të auditimit, u shqyrtuan ñ*procedurat e investimeve në fushën e TIK dhe Marrëveshjet e Nivelit të Shërbimit (ServiceLevelAgreement*)ò, në DPD në përmbushje të drejtimit të *"Auditimi i zhvillimit dhe blerjes në teknologjinë e informacionit"*, si më poshtë:

Ndër detyrat funksionale të AKSHI-t, Njësia e Teknologjisë të Informacionit e AKSHI-t atashuar për DPD bazuar në bazë të VKM nr. 673, datë 22.11.2017 ñ*Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit*ò, i ndryshuar janë:
- organizon, kryen prokurimet e qendërzuara dhe lidh kontratat për sistemet, pajisjet software dhe hardware, mirëmbajtjen si dhe shërbimet e internetit dhe të intranetit, me vlerë mbi kufirin monetar të prokurimeve me vlera të vogla.
- organizon, kryen prokurime të përqendruara dhe lidh kontratat për pajisjet TIK, përfshirë edhe ato të klasifikuara si ñ*sekret shtetëror*ò.
- promovon përhapjen e internetit dhe aksesin e publikut në shërbimet online.
- administron nga ana teknike sistemin informatik të institucioneve publike si dhe merr pjesë në hartimin e dokumentit të politikës së zhvillimit në fushën e komunikimeve për zhvillimin e Infrastrukturës së TIK-ut.
- si institucion që nxit veprimtarinë e sektorit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, është në ngarkim të zhvillimin të procedurave të prokurimit në Institucionet Publike.

I. Mbi auditimin e Sistemit LIMS -*LaboratoryInformationManagementSystem (Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Laboratorik*).

Midis Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe kontraktorit ñJSò ShPK, është lidhur kontrata nr. 20069, datë 06.09.2017, me objekt ñ*Blerje, instalim dhe vënie në funksion të Software të LIMS*ò, me vlerë 3,270,000 lekë me TVSh. Afati i ekzekutimit të kësaj kontratë është 90 ditë nga dita e nënshkrimit dhe do të përmbushet me furnizimin e ñ*Software të LIMS*ò të kërkuar nga Autoriteti Kontraktues ñJSò, sipasaneks kontratës si dhe grafikut të lëvrimit të paraqitur nga kjo shoqëri.
Në kontratë mirëmbajtja është specifikuar vetëm tek formulari i ofertës që do të bëhet për 4 vjet dhe e gjithë vlera bashkë me blerjen është vendosur në total tek çmimi i kontratës për objekt blerje, instalimi dhe vënie në funksion.

Nga auditimi konstatohet se:

a. *Kjo kontratë nuk ka të parashikuar marrëveshje kontraktuale mbi nivelin e shërbimit për sistemin LIMS si dhe nuk është parashikuar dhe hartuar një marrëveshje e nivelit të shërbimit, ku të përcaktohen parametrat dhe niveli i ofrimit të shërbimit si p.sh. orët/nivelet e suportit/përgjegjësitë/kufizimet, etj.*

Sa më lart konstatohet, është në kundërshtim me:
-VKM nr. 710,datë 21.08.2013 ñ*Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit"* i ndryshuar, pika 2 dhe 2a që parashikon: ñ*çdo institucion, i cili ka ose do të zhvillojë një sistem në fushën e teknologjisë së informacionit, që ofron shërbime për qytetarët, për biznesin dhe për ndërveprim e shkëmbim informacioni për administratën publike nëpërmjet sistemeve elektronike, duhet të parashikojë dhe të hartojë marrëveshje kontraktuale mbi nivelin e shërbimit. Kjo marrëveshje, nënshkruhet ndërmjet institucionit publik dhe ofruesit të shërbimit të TIK-ut dhe hartohet sipas udhëzimeve të nxjerra nga ministri për çështjet e teknologjisë së informacionit. Institucionet të cilat janë duke zhvilluar sisteme të reja në fushën e teknologjisë së informacionit, duhet të parashikojnë këtë marrëveshje, për mirëmbajtjen e këtyre sistemeve. Kohëzgjatja e kësaj marrëveshjeje duhet të jetë jo më e shkurtër se 4 (katër) vjet.*ò
- Udhëzimin i Ministrisë së Inovacionit nr. 1159, datë 17.03.2014 ñ*Për hartimin e marrëveshjes së nivelit të shërbimit*ò, pika 1, ku është përcaktuar se: ñ*Çdo institucion, i cili ka ose do të zhvillojë një sistem në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), që ofron shërbime për qytetarët, biznesin dhe për ndërveprim e shkëmbim informacioni për administratën publike nëpërmjet sistemeve elektronike, duhet të parashikojë dhe të hartojë marrëveshje të nivelit të shërbimit (MNSH). Në këtë marrëveshje përcaktohen parametrat dhe niveli i ofrimit të shërbimeve, përfshirë, minimalisht, këto elemente:*
a) orët gjatë të cilave shërbimet janë funksionale;
b) disponueshmërinë e shërbimeve e kohën mesatare ndërmjet ndërprerjeve të shërbimeve;
c) kohën mesatare të rikuperimit;
ç) nivelet e suportit, përgjegjësitë dhe kufizimet."
Si dhe, pika 6, ku parashikon që ñ*Institucionet, gjatë hartimit të MNSH-së, duhet të marrin në konsideratë elementet e paraqitura në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi dhe për çdo procedurë prokurimi për investimet për sisteme ose për shërbime të TIK-ut, duhet të kenë parasysh që marrëveshjen t'ia bashkëlidhin si aneks kontratës administrative, të lidhur ndërmjet palëve*ò.

b. *Konstatohet se, sistemi LIMS nuk ka kaluar në administrim dhe inventar të AKSHI-t dhe marrëveshja e shërbimit me OE nuk ka reflektuar ndryshimet përkatëse për kalimin e shërbimit tek AKSHI.*
Për sa më lart konstatohet është në kundërshtim me VKM nr. 673, datë 22.11.2017 ñ*Për riorganizimin e agjencisë kombëtare të shoqërisë së informacionit*ò, i ndryshuar, neni 18 citon: ñ*Institucionet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave duhet të dorëzojnë pranë AKSHI-t 1 (një) kopje të dokumentacionit të plotë të çdo sistemi dhe infrastrukture TIK ekzistuese dhe kodin e burimit. Sistemet dhe infrastruktura TIK ekzistuese kalojnë nën administrimin dhe inventarin e AKSHI-t, së bashku me të drejtat dhe detyrimet juridiko-civile përkatëse brenda datës 30 shtator 2018*ò dhe neni 19 citon: ñ*Për sistemet dhe infrastrukturat TIK të cilat kalojnë në administrim dhe inventar të AKSHI-t dhe që zhvillohen ose mirëmbahen nëpërmjet marrëveshjeve ose kontratave të nënshkruara nga institucionet me palë të treta, të reflektohen ndryshimet përkatëse në këto akte.*ò

1.Titulli i gjetjes: Kontrata nr. 20069, datë 06.09.2017, me objekt ñ*Blerje, instalim dhe vënie në funksion të Software të LIMS*ò, nuk ka të parashikuar marrëveshje kontraktuale mbi nivelin e shërbimit për sistemin LIMS si dhe nuk është parashikuar dhe hartuar një marrëveshje e nivelit të shërbimit.

Situata:

A. Midis Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe kontraktorit ñJSò sh.p.k, është lidhur kontrata nr. 20069, datë 06.09.2017, me objekt ñ*Blerje, instalim dhe vënie në funksion të Software të LIMS*ò, me vlerë 3.270.000 lekë me TVSH. Afati i ekzekutimit të kësaj kontratë është 90 ditë nga dita e nënshkrimit dhe do të përmbushet me furnizimin e ñ*Software të LIMS*ò të kërkuar nga Autoriteti Kontraktues, konform aneks kontratës si dhe grafikut të lëvrimit të paraqitur nga kjo shoqëri.

Në kontratë mirëmbajtja është specifikuar vetëm tek formulari i ofertës që do të bëhet për 4 vjet dhe e gjithë vlera bashkë me blerjen është vendosur në total tek çmimi i kontratës për objekt blerje, instalimi dhe vënie në funksion.

Kjo kontratë nuk ka të parashikuar marrëveshje kontraktuale mbi nivelin e shërbimit për sistemin LIMS si dhe nuk është parashikuar dhe hartuar një marrëveshje e nivelit të shërbimit, ku të përcaktohen parametrat dhe niveli i ofrimit të shërbimit si p.sh. orët/nivelet e suportit/përgjegjësitë/kufizimet, etj.

Sa më lart konstatohet, është në kundërshtim me, VKM nr. 710, datë 21.08.2013 ñ*Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit"* i ndryshuar, pika 2, 2a dhe Udhëzimin e Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike nr. 1159, datë 17.03.2014 ñ*Për hartimin e marrëveshjes së nivelit të shërbimit*ò, pika 1 si dhe pika 6.

B.Gjithashtu *konstatohet se, sistemi LIMS nuk ka kaluar në administrim dhe inventar të AKSHI-t dhe marrëveshja e shërbimit me OE nuk ka reflektuar ndryshimet përkatëse për kalimin e shërbimit tek AKSHI*kjo në kundërshtim me VKM nr. 673, datë 22.11.2017 ñ*Për riorganizimin e agjencisë kombëtare të shoqërisë së informacionit*ò, i ndryshuar, neni 18 dhe neni 19.

Kriteri:VKM nr. 710, datë 21.08.2013 ñ*Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit"* i ndryshuar, pika 2, 2a dhe Udhëzimin e Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike nr. 1159, datë 17.03.2014 ñ*Për hartimin e marrëveshjes së nivelit të shërbimit*ò, pika 1 si dhe pika 6.

Ndikimi/Efekti:mos përcaktimin e saktë të detyrave dhe përgjegjësvepër ofrimin e shërbimit tëmirëmbajtjes.

Shkaku: Sistemi LIMS nuk ka kaluar në administrim dhe inventar të AKSHI-t dhe marrëveshja e shërbimit me OE nuk ka reflektuar ndryshimet përkatëse për kalimin e shërbimit tek AKSHI

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Nga DPD në bashkëpunim me AKSHI-n të merren masat e nevojshme për të kaluar në administrim dhe inventar të AKSHI-t sistemin, ñ*LIMS*ò, së bashku me të drejtat dhe detyrimet juridiko-civilepërkatëse duke përcaktuar përgjegjësisë dhe detyrimet për shërbimin e mirëmbajtjes të këtij sistemi dhe infrastrukturës TIK.

II. Mbi auditimin e kontratës "*Dixhitalizimi i Sistemit Doganor*".

Midis Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit dhe BO ñSò shpk dhe ñHò sh.p.k, është lidhur kontrata nr. 4700, datë 24.09.2020, me objekt ñ*Dixhitalizimi i shërbimeve doganore*ò për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, me vlerë 100.295.999 lekë me TVSH,

përkatësisht 62.495.999 lekë për implementimin dhe 37.800.000 lekë mirëmbajtje (*ose 60% e vlerës së implementimit*) .
Zbatimi i kontratës (neni 3) do të fillojë me nënshkrimin dhe do të vazhdojë për 6 muaj implementim (*mbaron mars 2021*)dhe 4 vjet mirëmbajtje (*48 muaj*), (*Fillon mbas implementimit*).

a. Nga auditimii zbatimit të kontratës së mësipërme rezulton se sipas kushteve të veçanta të kontratësneni 1, janë përcaktuar si:
-***Autoriteti Kontraktor*** *është AKSHI.*
- ***Kontraktuesi*** *është Bashkimi i operatorëve "H" sh.p.k& "S".*
- ***Përfituesi i shërbimit*** *është DPD.*

Sipas kushteve të përgjithshme të kontratës baza ligjore për hartimin e kësaj kontrate është ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 ñ*Për prokurimin publik*ò, Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, Kreu II, pika 5/j e VKM nr. 673, datë 22.11.2017 ñ*Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit*ò.

Kjo kontratë është firmosur nga AKSHI në cilësinë e Autoritetit Kontraktor <u>në një kohë kur AKSHI organizon, kryen prokurimet e përqendruara për pajisjet TIK, për institucionet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave dhe nuk lidh kontrata</u>.
Sa më lart nënshkrimi i kontratës është në kundërshtim me VKM nr. 673, datë 22.11.2017 ñ*Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit*ò, Kreu II, pika 5, germa j) *Organizon, kryen prokurimet e përqendruara për pajisjet TIK, përfshirë edhe ato të klasifikuara si "sekret shtetëror", për institucionet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave.*
Me VKM nr. 872, datë 24.12.2019 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 673, datë 22.11.2017, të KM, "*Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit*", të ndryshuar, Në Kreun II, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:..ii. <u>Në shkronjën ñjò, fjalët ñ*lidh kontrata*ò, hiqenò.</u>

<u>*Nga auditimi i kontratës së mësipërme rezulton se:*</u>
b. Nuk ka të parashikuar marrëveshje kontraktuale mbi nivelin e shërbimit për sistemin ñ*Dixhitalizimi i shërbimeve doganore*ò në vlerën 37,800,000 si dhe <u>nuk është parashikuar dhe hartuar një marrëveshje e nivelit të shërbimit</u>, ku të përcaktohen parametrat dhe niveli i ofrimit të shërbimit si p.sh. orët/nivelet e suportit/përgjegjësitë/kufizimet, etj.

Sa më lart konstatohet, është në kundërshtim me, VKM nr. 710,datë 21.08.2013 ñ*Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit"* i ndryshuar, pika 2 dhe 2a që parashikon: ñ*çdo institucion, i cili ka ose do të zhvillojë një sistem në fushën e teknologjisë së informacionit, që ofron shërbime për qytetarët, për biznesin dhe për ndërveprim e shkëmbim informacioni për administratën publike nëpërmjet sistemeve elektronike, duhet të parashikojë dhe të hartojë marrëveshje kontraktuale mbi nivelin e shërbimit. Kjo marrëveshje, nënshkruhet ndërmjet institucionit publik dhe ofruesit të shërbimit të TIK-ut dhe hartohet sipas udhëzimeve të nxjerra nga ministri për çështjet e teknologjisë së informacionit. Institucionet të cilat janë duke zhvilluar sisteme të reja në fushën e teknologjisë së informacionit, duhet të parashikojnë këtë marrëveshje, për mirëmbajtjen e këtyre sistemeve. Kohëzgjatja e kësaj marrëveshjeje duhet të jetë jo më e shkurtër se 4 (katër) vjet.*ò
Gjithashtu sa konstatohet është në kundërshtim me Udhëzimine Ministrisë së Inovacionit nr. 1159, datë 17.03.2014 ñ*Për hartimin e marrëveshjes së nivelit të shërbimit*ò, Pika 1, ku

parashikon: ñ*Çdo institucion, i cili ka ose do të zhvillojë një sistem në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), që ofron shërbime për qytetarët, biznesin dhe për ndërveprim e shkëmbim informacioni për administratën publike nëpërmjet sistemeve elektronike, duhet të parashikojë dhe të hartojë marrëveshje të nivelit të shërbimit (MNSH). Në këtë marrëveshje përcaktohen parametrat dhe niveli i ofrimit të shërbimeve, përfshirë, minimalisht, këto elemente:*
a) orët gjatë të cilave shërbimet janë funksionale;
b) disponueshmërinë e shërbimeve e kohën mesatare ndërmjet ndërprerjeve të shërbimeve;
c) kohën mesatare të rikuperimit;
ç) nivelet e suportit, përgjegjësitë dhe kufizimet."
Si dhe, pika 6, ku parashikon që ñ*Institucionet, gjatë hartimit të MNSH-së, duhet të marrin në konsideratë elementet e paraqitura në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi dhe për çdo procedurë prokurimi për investimet për sisteme ose për shërbime të TIK-ut, duhet të kenë parasysh që marrëveshjen t'ia bashkëlidhin si aneks kontratës administrative, të lidhur ndërmjet palëve*ò.

c. Nga auditimi konstatohet se sistemi, ñ*Dixhitalizimi i Sistemit Doganor*ò deri 31.12.2020 nuk ka kaluar në administrim dhe inventar të AKSHI-t pasi nuk ka mbaruar implementimi, gjithashtu si e kemi cituar edhe më lart nuk ka një marrëveshje e shërbimit me kontraktorin dhe nuk ka një marrëveshje ku të jenë reflektuar ndryshimet përkatëse për kalimin e shërbimit tek AKSHI.

Për sa më lart është në kundërshtim me VKM nr. 673, datë 22.11.2017 ñPër riorganizimin e Agjencisë kombëtare të shoqërisë së informacionitò, i ndryshuar, neni 18, i cili citon: ñ*Institucionet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave duhet të dorëzojnë pranë AKSHI-t 1 (një) kopje të dokumentacionit të plotë të çdo sistemi dhe infrastrukture TIK ekzistuese dhe kodin e burimit. Sistemet dhe infrastruktura TIK ekzistuese kalojnë nën administrimin dhe inventarin e AKSHI-t, së bashku me të drejtat dhe detyrimet juridiko-civile përkatëse brenda datës 30 shtator 2018*ò dhe neni 19 citon: ñ*Për sistemet dhe infrastrukturat TIK të cilat kalojnë në administrim dhe inventar të AKSHI-t dhe që zhvillohen ose mirëmbahen nëpërmjet marrëveshjeve ose kontratave të nënshkruara nga institucionet me palë të treta, të reflektohen ndryshimet përkatëse në këto akte.*ò

2.Titulli i gjetjes: Kontrata nr. 4700, datë 24.09.2020, me objekt ñ*Dixhitalizimi i shërbimeve doganore*ò është lidhur nga AKSHI në cilësinë e autoritetit kontraktor, me përfitues shërbimi DPD, në një kohë kur AKSHI organizon, kryen prokurimet e përqendruara për pajisjet TIK, por nuk lidh kontrata si dhe nuk është parashikuar dhe hartuar një marrëveshje e nivelit të shërbimit, ku të përcaktohen parametrat dhe niveli i ofrimit të shërbimit.
Situata:
A. Midis AKSHI-t në cilësinë e Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit BO ñSò SHPK dhe ñHò SHPK, është lidhur kontrata nr. 4700, datë 24.09.2020, me objekt ñ*Dixhitalizimi i shërbimeve doganore*ò me përfitues shërbimi Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, me vlerë 100.295.999 lekë me TVSh, përkatësisht 62.495.999 lekë për implementimin dhe 37.800.000 lekë mirëmbajtje. Sipas kushteve të veçanta të kontratës neni 1, janë përcaktuar si:

-***Autoriteti Kontraktor*** *është Agjencia Kombëtare e Shoqërisë të Informacionit.*
- ***Kontraktuesi*** *është BO "H" SHPK & "S" SHPK.*
- ***Përfituesi i shërbimit*** *është DPD.*

Sipas kushteve të përgjithshme të kontratës baza ligjore e cituar për hartimin e kësaj kontrate është ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 ñ*Për prokurimin publik*ò, Kodi Civil i Republikës së

Shqipërisë, Kreu II, pika 5/j dhe VKM nr. 673, datë 22.11.2017 ñ*Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit*ò.
Kjo kontratë është firmosur nga AKSHI në cilësinë e Autoritetit Kontraktor në një kohë kur AKSHI organizon, kryen prokurimet e përqendruara për pajisjet TIK, për institucionet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave dhe nuk lidh kontrata.
Sa më lart nënshkrimi i kontratës është në kundërshtim me VKM nr. 673, datë 22.11.2017 ñ*Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit*ò, Kreu II, pika 5, germa j, i ndryshuar me VKM nr. 872, datë 24.12.2019 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 673, datë 22.11.2017, të KM, "*Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit*", të ndryshuar, ku në Kreun II, janë bërë ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:..ii. Në shkronjën ñjò, fjalët ñ*lidh kontrata*ò, hiqenò.
B. Nga auditimi i kontratës së mësipërme rezulton se nuk ka të parashikuar marrëveshje kontraktuale mbi nivelin e shërbimit për sistemin ñ*Dixhitalizimi i shërbimeve doganore*ò në vlerën 37,800,000 si dhe nuk është parashikuar dhe hartuar një marrëveshje e nivelit të shërbimit, ku të përcaktohen parametrat dhe niveli i ofrimit të shërbimit si p.sh. orët/nivelet e suportit/përgjegjësitë/kufizimet, etj.
Kjo në kundërshtim me, VKM nr. 710, datë 21.08.2013 ñ*Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit"* i ndryshuar, pika 2, 2a, dhe Udhëzimin e Ministri të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike (MIAP) nr. 1159, datë 17.03.2014 ñ*Për hartimin e marrëveshjes së nivelit të shërbimit*ò, pika 1 dhe pika 6.
C. Konstatohet se sistemi, ñ*Dixhitalizimi i Sistemit Doganor*ò deri 31.12.2020 nuk ka kaluar në administrim dhe inventar të AKSHI-t pasi nuk ka mbaruar implementimi, gjithashtu nuk ka një marrëveshje shërbimi me kontraktorin dhe nuk ka një marrëveshje ku të jenë reflektuar ndryshimet përkatëse për kalimin e shërbimit tek AKSHI, në kundërshtim me VKM nr. 673, datë 22.11.2017 ñ*Për riorganizimin e agjencisë kombëtare të shoqërisë së informacionit"*, i ndryshuar, neni 18 dhe neni 19.
Kriteri: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 ñ*Për prokurimin publik*ò, Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, Kreu II, pika 5/j.
VKM nr. 673, datë 22.11.2017 ñ*Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit*ò, Kreu II, pika 5.
VKM nr. 710, datë 21.08.2013 ñ*Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit"* i ndryshuar, pika 2, 2a, dhe Udhëzimin e Ministri të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike (MIAP) nr. 1159, datë 17.03.2014 ñ*Për hartimin e marrëveshjes së nivelit të shërbimit*ò, pika 1 dhe pika 6.
Ndikimi/Efekti: Duke mos u parashikuar marrëveshje kontraktuale mbi nivelin e shërbimit për sistemin si dhe duke mos u hartuar një marrëveshje e nivelit të shërbimit, ka sjellë mos përcaktimin e saktë të parametrave për nivelin e ofrimit të shërbimit.
Shkaku: Sistemi ñ*Dixhitalizimi i Sistemit Doganor*ò nuk ka kaluar në administrim dhe inventar të AKSHI-t dhe marrëveshja e shërbimit me kontraktorinnuk ka reflektuar ndryshimet përkatëse për kalimin e shërbimit tek AKSHI
Rëndësia: E lartë
Rekomandime:
DPD në bashkëpunim me AKSHI-n të marrë masat e nevojshme përhartimin e një marrëveshje të nivelit të shërbimit, për sistemin ñ*Dixhitalizimi i shërbimeve doganore*ò ku të përcaktohen parametrat dhe niveli i ofrimit të shërbimit.
- DPD në bashkëpunim me AKSHI-n të marrë masat e nevojshme për të kaluar në administrim dhe inventar të AKSHI-t pas implementimit sistemin, ñ*Dixhitalizimi i Sistemit Doganor*ò, së bashku me të drejtat dhe detyrimet juridiko-civile përkatëse duke përcaktuar

përgjegjësisë dhe detyrimet për shërbimin e mirëmbajtjes të këtij sistemi dhe infrastrukturës TIK.

III. Rrjetet/Sistemet dhe mirëmbajtja në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.
Në inventarin e Aktive Afatgjata Materiale të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, janë rrjetet dhe sistemet,në vlerën **264,765,083 lekë:**

Tabela e Aktive Afatgjata Materiale për rrjete-sisteme

Në lekë

Nr.	Llogaria	Emërtimi	Vlera Bruto datë 31.12.2019	Shtesa viti 2020	Pakësime viti 2020	Vlera Bruto datë 31.12.2020
1	2135001	Sistemi AsycudaWorld IT	102,309,224	0	0	102,309,224
2	2135005	Moduli i Akcizës IT	32,566,784	0	0	32,566,784
3	2135009	Moduli Protip për Tranzitin Kosovë - Al	15,284,240	0	0	15,284,240
4	2135003	Rrjeti Informatik DPD, IT	13,151,125	0	0	13,151,125
5	2135004	Program për Peshoret Elektronike IT	280,000	0	0	280,000
6	2135010	Mirëmbajte Pasje Laboratori - TVSh	806,190	0	0	806,190
7	2135006	Suport për Firewall - për IT	8,474,355	0	0	8,474,355
8	2135007	Asistence Teknike për Adm. Doganore IT	569,600	0	0	569,600
9	2135008	Oracle për IT+LicensaSoftware	53,057,389	0	0	53,057,389
10	2135012	Dixhitalizimi i Shërbimeve Doganore	0	30,000,000	0	30,000,000
11	2135011	Sistemi monitorimit me kamera - 2020	89,938,188	8,266,176	89,938,188	8,266,176
		SHUMA	**316,437,095**	**38,266,176**	**89,938,188**	**264,765,083**

Tabela: Drejtoria e financës.

Nga auditimi konstatohet:
Në inventarin e Aktive Afatgjata Materiale të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, janë rrjetet dhe sistemet, llogaria 213 ñ*Rrjetet dhe sistemet*ò në vlerën 264,765,083 lekë ku vlera bruto e sistemit ñASYCUDAò deri më 31.12.2020 në total është 102,309,224 lekë, kur në fakt duhej të ishte 150,160,248 lekë. (*Përfshirë tre zërat: Sistemi AsycudaWorld IT,në vlerën 102,309,224 lekë, Moduli i Akcizës IT,në vlerën 32,566,784 lekë, Moduli Prototip për Tranzitin Kosovë –Al, në vlerën 15,284,240 lekë, të cilat janë në përbërje të një sistemi*). Pra nuk duhet të jenë të veçuara si zë më vete në inventar, pasi janë pjesë e Sistemit Asycuda Word IT.

Gjithashtu, ñ*Mirëmbajte Pasje Laboratori – TVSh*ò në vlerën 806,190 lekë, ñ*Suport për Firewallpër IT*ò në vlerën 8,474,355 lekë, ñ*Asistence Teknike për Administratën. Doganore IT*ò në vlerën 569,600 lekë, nuk janë Aktive Afatgjata Materiale, por shpenzime operative dhe nuk mund të jenë në inventarin e Aktive Afatgjata Materiale në DPD.
Për sa më lart është në kundërshtim me VKM nr. 673, datë 22.11.2017 ñ*Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, i ndryshuar me vendim nr. 36, datë 24.1.2018, me vendim nr. 448, datë 26.7.2018, me vendim nr.872, datë 24.12.2019*ò, dispozita kalimtare, pika 18 citohet:*"Sistemet dhe infrastruktura TIK ekzistuese kalojnë nën administrimin dhe inventarin e AKSHI-t, së bashku me të drejtat dhe detyrimet juridiko-civile përkatëse brenda datës 30 shtator 2018*ò.

3. Titulli i gjetjes: Inventari i Aktive Afatgjata Materiale të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, llogaria 213 ñ*Rrjetet dhe sistemet*ò paraqitet në vlerën 264,765,083 lekë të cilat në analizë nuk pasqyrojnë vlerën e saktë të këtyre aktiveve.

Situata:

- Në inventarin e AAM të DPD, janë pasqyruar ñ*Rrjetet dhe sistemet*ò, në vlerën 264,765,083 lekë, ku vlera bruto e sistemit ñASYCUDAò deri 31.12.2020 në total është 102,309,224 lekë kur në fakt duhej të ishte 150,160,248 lekë. (*Përfshirë tre zërat: Sistemi AsycudaWorld IT, në vlerën 102,309,224 lekë, Moduli i Akcizës IT, në vlerën 32,566,784 lekë, Moduli Prototip për Tranzitin Kosovë –Al, në vlerën 15,284,240 lekë, të cilat janë në përbërje të një sistemi*). Pra nuk duhet të janë të veçuara si zë më vete në inventar, pasi janë pjesë e Sistemit Asycuda Word IT.

Gjithashtu, ñ*Mirëmbajte Pasje Laboratori – TVSh*ò në vlerën 806,190 lekë, ñ*Suport për Firewall për IT*ò në vlerën 8,474,355 lekë, ñ*Asistence Teknike për Administratën. Doganore IT*ò në vlerën 569,600 lekë, nuk janë AAM por shpenzime operative dhe nuk mund të jenë në inventarin e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara në DPD.

Këto aktive nuk kanë kaluar nën administrimin dhe inventarin e AKSHI-t së bashku me të drejtat dhe detyrimet juridiko-civile përkatëse.

Mos paraqitja në vlerën e saktë e inventarit të aktiveve të llogarisë 213 ñ*rrjetet dhe sistemet*ò si dhe mos kalimi i këtyre aktive nën administrimin dhe inventarin e AKSHI-t së bashku me të drejtat dhe detyrimet juridiko-civile përkatëse ka sjellë mos përcaktimin e përgjegjësisë dhe detyrimet për shërbimin e mirëmbajtjes së këtyre sistemeve dhe infrastrukturës TIK .

Për sa më lart është në kundërshtim me VKM nr. 673, datë 22.11.2017 *"Për riorganizimin e agjencisë kombëtare të shoqërisë së informacionit",* dispozita kalimtare, pika 18.

Kriteri:VKM nr. 673, datë 22.11.2017 *"Për riorganizimin e agjencisë kombëtare të shoqërisë së informacionit",* dispozita kalimtare, pika 18.

Ndikimi/Efekti: Mos paraqitja në vlerën e saktë e inventarit të aktiveve të llogarisë 213 ñ*rrjetet dhe sistemet*ò si dhe mos kalimi i këtyre aktive nën administrimin dhe inventarin e AKSHI-t së bashku me të drejtat dhe detyrimet juridiko-civile përkatëse ka sjellë mos përcaktimin e përgjegjësisë dhe detyrimet për shërbimin e mirëmbajtjes së këtyre sistemeve dhe infrastrukturës TIK .

Shkaku: Aktivet Afatgjata Materiale, llogarisë 213 ñ*rrjetet dhe sistemet*ò nuk janë paraqitur në analizë në vlerën e saktëdhe nuk kanë kaluar në administrimin dhe inventarin e AKSHI-t së bashku me të drejtat dhe detyrimet juridiko-civile përkatëse.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime:DPD të marrë masat e nevojshme për paraqitjen në vlerën e saktë të inventarit të aktiveve të llogarisë 213 ñ*Rrjetet dhe sistemet*ò si dhe kalimi i këtyre aktive nën administrimin dhe inventarin e AKSHI-t së bashku me të drejtat dhe detyrimet juridiko-civile përkatëse duke përcaktuar përgjegjësisë dhe detyrimet për shërbimin e mirëmbajtjes së këtyre sistemeve dhe infrastrukturës TIK .

Nga auditimi u konstatua se:

- *Nuk ka të parashikuar marrëveshje kontraktuale mbi nivelin e shërbimit për sistemin LIMS;*
- *Nuk është parashikuar dhe hartuar një marrëveshje e nivelit të shërbimi për sistemin LIMS, ku të përcaktohen parametrat dhe niveli i ofrimit të shërbimit;*
- *Sistemi LIMS nuk ka kaluar në administrim dhe inventar të AKSHI-t;*
- *Dixhitalizimi i Sistemit Doganor nuk ka kaluar në administrim dhe inventar të AKSHI-t;*
- *Moduli i Akcizës IT, Moduli Protip për Tranzitin Kosovë –Al, të cilat janë në përbërje të një sistemi, nuk duhet të janë të veçuara si zë më vete në inventar, pasi janë pjesë e Sistemit Asycuda Word IT;*

- *Rrjetet/sistemet nuk duhet të jenë në inventarin e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara në DPD por tek AKSHI.*

Nga auditimi rezulton se të drejtat dhe detyrimet e ndërsjellat midis DPD dhe AKSHI-t, nuk janë të rregulluara dhe përcaktuara me një marrëveshje të nënshkruar nga palët, me qëllim përcaktimin e llojit dhe nivelit të shërbimeve që i ofrohen nga AKSHI Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, sipas VKM nr. 673, datë 22.11.2017 ñ*Për riorganizimin e agjencisë kombëtare të shoqërisë së informacionit*ò,pika .
Nga Drejtoria e TIK e Doganave e AKSHI-t atashuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave u paraqit Draft Marrëveshja operacionale Bashkëpunimi ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit **e pa firmosur**. Në këtë draft marrëveshje përcaktohen detyrat e AKSHI-t, objekti i marrëveshjes baza ligjore, të drejtat dhe detyrimet e AKSHI-t, ku janë përcaktuar detyrat funksionale të AKSHI-t referuar Rregullores së AKSHI-t nr. 1900, datë 16.04.2020.
Mungesa e një marrëveshjeje ndërmjet dy institucioneve, përbën risk për mbarëvajtjen, monitorimin dhe dokumentimin e shërbimeve të Drejtorisë TIK në DPD.

4. Titulli i gjetjes: Në zbatim të VKM nr. 673, datë 22.11.2017 ñ*Për riorganizimin e agjencisë kombëtare të shoqërisë së informacionit*ò, lloji dhe niveli i shërbimeve TIK që i ofrohen nga AKSHI Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave kryhen në mungesë të një marrëveshje midis palëve.
Situata:
- Nga auditimi rezulton se të drejtat dhe detyrimet e ndërsjellat midis DPD dhe AKSHI-t, nuk janë të rregulluara dhe përcaktuara me një marrëveshje të nënshkruar nga palët, me qëllim përcaktimin e llojit dhe nivelit të shërbimeve që i ofrohen nga AKSHI Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave sipas VKM nr. 673, datë 22.11.2017 ñ*Për riorganizimin e agjencisë kombëtare të shoqërisë së informacionit*ò, pika 5/gj, 6/dh.
Nga Drejtoria e TIK e Doganave e AKSHI-t atashuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave është hartuar një ñ*Draft Marrëveshja Operacionale Bashkëpunimi ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit*ñ e pa firmosur. Në këtë draft marrëveshje përcaktohen, objekti i marrëveshjes baza ligjore, të drejtat detyrimet dhe detyrat funksionale të AKSHI-t referuar Rregullores së AKSHI-t nr. 1900, datë 16.04.2020.
Mungesa e një marrëveshjeje ndërmjet dy institucioneve, përbën risk për mbarëvajtjen, monitorimin dhe dokumentimin e shërbimeve të Drejtorisë TIK në DPD.
Kriteri: VKM nr. 673, datë 22.11.2017 ñ*Për riorganizimin e agjencisë kombëtare të shoqërisë së informacionit"* Rregullores së Brendshme të AKSHI-t nr. 1900, datë 16.04.2020 ñ*Mbi detyrat dhe funksionimi i Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit*ò dhe Praktikat e institucioneve të tjera, sistemet e të cilave administrohen nga AKSHI.
Ndikimi/efekti: Mungesa e një marrëveshjeje ndërmjet dy institucioneve, përbën risk për mbarëvajtjen, monitorimin dhe dokumentimin e shërbimeve të Drejtorisë TIK në DPD.
Shkaku: Të drejtat dhe detyrimet e ndërsjellat midis DPD dhe AKSHI-t, nuk janë të rregulluara dhe përcaktuara me një marrëveshje të nënshkruar nga palët, sipas VKM nr. 673, datë 22.11.2017 ñ*Për riorganizimin e agjencisë kombëtare të shoqërisë së informacionit*ò.
Rëndësia: E lartë
Rekomandimi: DPD të marrin masat e nevojshme për hartimin dhe miratimin e një marrëveshjeje dypalëshe me qëllim përcaktimin e të drejtave dhe detyrimet e ndërsjellat midis DPD dhe AKSHI-t, llojin dhe nivelin e shërbimeve që i ofrohen nga AKSHI Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Për sa është konstatuar më lart, mbajnë përgjegjësi:
z. IM me detyrë Drejtori i Burimeve Mbështetëse sipas detyrave funksionale të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Administratës Doganore, nenet 9 dhe 63, miratuar nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë menr. 146, datë 07.05.2018.
z. ED me detyrë Drejtori i Drejtorisë TIK të Doganavesipas detyrave funksionale të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme ñMbi Detyrat dhe Funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionitò, neni 22, miratuar nga AKSHI menr. 1900, datë 16.04.2020.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar nuk është paraqitur observacion mbi Projekt raportin e Auditimit.

2.4. Auditimi i sigurisë së informacionit.

Në zbatim të pikës 4 të programit të auditimit ñ*Auditimi i Sigurisë së Informacionit*ò, kemi shqyrtuar:

1. Aktet ligjore/nënligjore/rregullative mbi sigurinë;
2. Planet e sigurisë dhe vazhdimësisë;
3. Analizimin e gjurmës audituese të dokumentuar në letër si dhe elektronike (AuditLogs);
4. Marrëveshje, kontrata mbi sigurinë;
5. Politikat e vazhdimësisë së shërbimit;
6. Listën e përdoruesve të sistemit;
7. Procedurat e miratuara për BCC, DRC, Backup;
8. Risqet e identifikuara, monitoruara, adresuara; etj.

Objektivi. Identifikimi i elementëve të sigurisë, për të dhënat që kërkojnë monitorim të vazhdueshëm, mbrojtjen e tyre, sigurimi i ofrimit të shërbimit pa ndërprerje si dhe administrimi i përdoruesve mbi këto të dhëna.

a. Siguria e të dhënave dhe vazhdimësia në ofrimin e shërbimit

AsycudaWorld. Bazuar në standardet ndërkombëtare, siguria e informacionit garantohet duke siguruar gatishmërinë, konfidencialitetin dhe integritetin e të dhënave.
Menaxhimi i log-eve ndihmon institucionin publik pasi nëpërmjet kësaj gjurme sigurohet informacioni mbi sigurinë që të ruhet me detaje dhe për një kohë të mjaftueshme. Analizat e log-eve mundësojnë identifikimin e incidenteve, aktiviteteve mashtruese, thyerjen e politikave, problemet operacionale pak pasi ato ndodhin. Ato gjithashtu ndihmojnë në hetimin e ngjarjeve të ndryshme, auditimin dhe ndihmojnë institucionin në problemet e brendshme

Në sistemin Asycuda të dhënat e të cilit ndodhen në një bazë të dhënash shtetërore, ruhet gjurma e auditit (Audit log), për veprimet që punonjësit kryejnë në sistem. Akses për të parë këto log-e kanë vetëm specialistët IT që merren me mirëmbajtjen e sistemin Asycuda si dhe specialistët e UNCTAD që është prodhuesi i software-it.

Baza e të dhënave të sistemit Asycuda aksesohet nga specialistët e Sektorit të Serverave dhe Zhvillimit, strukturë kjo e AKSHI-t, si dhe ekspertët e UNCTAD.

Përdoruesi në nivel SQL ORACLE është useri SYSTEM, që ka të drejta DBA (Database Administrator), i cili përdoret nga të gjithë specialistët e Sektorit të Serverave e Zhvillimit dhe ekspertët e UNCTAD.
Veprimet që bëhen me këtë përdorues janë:
ALTER - (për të administruar SESSIONS dhe CRUSORS në bazën e të dhënave);
SELECT - (për përzgjedhjen e të dhënave nga një tabelë);
DELETE - (për fshirjen e një rreshti nga një tabelë me qëllim zgjidhjen e problematikës në tabelat që nuk kanë të dhëna, siç mund të jetë rasti i tabelave LOCK, veprim i sugjeruar nga ekspertët e UNCTAD).
UPDATE - (përditësimin e një të dhëne me qëllim zgjidhjen e një problematike, veprim i sugjeruar nga ekspertët e UNCTAD);
INSERT - (për shtimin e një rreshti në një tabelë, si në rastin e një kodi tarifor pasi nuk mund të kryhet nga ndërfaqja e sistemit ASYCUDA, veprim i sugjeruar nga ekspertët e UNCTAD);
Të dhënat e Audit Log për vitin 2019 janë fshirë Log me argumentin se madhësia e kësaj tabele bllokoi punën me sistemin AsycudaWorldpër disa orë dhe kjo ishte e vetmja zgjidhje. Për vitin 2020 këto të dhëna gjendeshin në tabelë, por auditimi mbi këto rekorde ishte i pamundur pasi kërkimet, bllokonin sistemin Asycuda në të cilin punojnë më shumë se 2000 përdorues;

1. Titulli i Gjetjes: Parregullsi dhe mangësi në Administrimin e gjurmës elektronike të auditimit.
Situata: Nga auditimi mbi procedurat e ndjekura për monitorimin dhe analizimin e gjurmës elektronike të auditimit, rezultoi se:
- DPD nuk disponon asnjë politikë, procedurë apo procese të standardizuara për kontrollin dhe administrimin e gjurmës elektronike të auditimit, të quajtur ndryshe Audit Log.
- DPD nuk ka përcaktuar burimet njerëzore, përgjegjësitë dhe personat përgjegjës për monitorimin dhe analizimin e gjurmës së auditimit.
- Me gjithë rëndësinë që ka sistemi Asycuda, DPD nuk ka zhvilluar një infrastrukturë të përdoret për gjenerimin, transmetimin, analizimin e log-eve.
- Ndërhyrjet që kryejnë specialistët e AKSHI-t bazuar në sugjerimet e UNCTAD, nuk rezultojnë të jenë dokumentuar e miratuar nga DPD në rastet kur ndërhyrjet kryhen mbi të dhënat e sistemit, duke vepruar kështu në mënyrë të paautorizuar. Struktura e AKSHI-t nuk ka në detyrat e saj menaxhimin e log-ut.
- DPD nuk ka implementuar një infrastrukturë për analizimin, arkivimin dhe ruajtjen e të dhënave të gjurmës elektronike, në kundërshtim me 5.2.1 ñ*Infrastruktura e Menaxhimit Të Log-eve*ò të rregullores për menaxhimin e log-eve digjitale në administratën publike miratuar me Urdhrin nr.109, datë 10.06.2016 nga ALCIRT ï Agjencia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike.
Kriteri: Rregullore për *"Menaxhimin e Log-eve dixhitalenë administratën publike"* miratuar nga AKCESK me urdhrin nr. 109, datë 10.06.2016.
Ndikimi/Efekti: Risk në sigurinë e të dhënave me pasojë humbjen, tjetërsimin e tyre.
Shkaku: Mungesa e strukturave për të dhënat në DPD, mungesa e pajisjeve fizike për të ruajtur log-et në vend tjetër, mos zbatim i rregullores miratuar nga AKCESK.
Rëndësia: E Lartë
Rekomandim: DPD të marrë masa për sigurinë dhe mbrojtjene të dhënave duke filluar së pari me hartimin e një procedure apo rregullore për menaxhimin e gjurmës elektronike të auditimit. Në këtë dokument duhet të specifikohet qartë vendi ku ruhen gjurmët, për cilat veprime të përdoruesit ruhen këto gjurmë, koha, struktura përgjegjëse për monitorimin dhe analizimin e tyre, detyrat dhe përgjegjësitë, e çdo element që i shërben sigurisë së të dhënave

dhe parandalimit në tjetërsimin e tyre.

2. Titulli i Gjetjes: Fshirja e Audit Log.
Situata: Nga auditimi mbi të dhënat e gjurmës elektronike të auditimit, rezultoi se për vitin 2019 këto gjurmë janë fshirë me argumentin se madhësia e kësaj tabele bllokoi punën me sistemin AsycudaWorldpër disa orë. Për këtë ndërhyrje, nuk rezulton të jetë dokumentuar asnjë shpjegim dhe asnjë miratim nga niveli drejtues i DPD. Vendimi dhe ekzekutimi është marrë nga struktura e AKSHI-t pranë DPD, në kundërshtim me pikën 5.2.2 ñ*Detyrat e Stafit Përgjegjës për Menaxhimin e Log-eve*ò, të rregullores për menaxhimin e log-eve digjitale në administratën publike miratuar me Urdhrin nr.109, datë 10.06.2016 nga ALCIRT ï Agjencia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike, sepse struktura e AKSHI-t nuk janë stafi përgjegjës për menaxhimin e log-eve.
Drejtoria TIK e AKSHI-t nuk ka ngritur mekanizma kontrolli me qëllim parandalimin e çështjeve që lidhen me funksionalitete të sistemit, çfarë do të thotë se e njëjta situatë rrezikon të përsëritet në të ardhmen.
Kriteri: Rregullore për *"Menaxhimin e Log-eve dixhitale në administratën publike"* miratuar nga AKCESK me urdhrin nr. 109, datë 10.06.2016, pikat 5.2.2 ñ*Detyrat e Stafit Përgjegjës për Menaxhimin e Log-eve*ò.
Ndikimi/Efekti: Pamundësia e identifikimit të ndërhyrjevenë të dhënat e DPD.
Shkaku: Mungesa e strukturave për të dhënat në DPD, mungesa e pajisjeve fizike për të ruajtur log-et në vend tjetër, mos zbatim i rregullores miratuar nga AKCESK, mungesa e kontrolleve parandaluese.
Rëndësia: E Lartë
Rekomandim: DPD të marrë masa të menjëhershme për ndërtimin e mekanizmavetë kontrollit për mbrojtjen dhe sigurimin e të dhënave shtetërore, gjeneruar prej saj nëpërmjet sistemit Asycuda, me qëllim parandalimin e situatave të ngjashme si fshirja e të dhënave mbi gjurmën elektronike të auditimit në të ardhmen.

Për veprimet që janë në kundërshtim me rregulloren për "*Menaxhimin e Log-eve dixhitale në administratën publike*" dhe tejkalim te kompetencave që i atribuon VKM nr.673, grupi i audimit ngarkon me përgjegjësi z. ED me detyrë Drejtor i Drejtorisë TIK, për periudhën objekt auditimi se ka vepruar duke urdhëruar fshirjen e gjurmës elektronike të auditimit, pa autorizimin e nivelit drejtues të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave si institucion përgjegjës për të dhënat e këtij sistemi.

Siguria e të dhënave në sistemin LIMS. Gjurma e auditimit si një nga elementët kryesorë për sigurinë dhe gjurmimin e parregullsive të shkaktuara në sistemin LIMS, nuk ruhet elektronikisht megjithëse është kërkuar në specifikimet teknike në disa pika.

3. Titulli i Gjetjes: Mungesa e kontrolleve mbi log-et për sistemin LIMS.
Situata: Nga auditimi mbi sistemin dhe të dhënat e aplikacionit të laboratorit ï LIMS, sipas kontratës nr. 20069, datë 06.09.2017, rezulton se mungon gjurma elektronike e auditimit (AuditLogs), megjithëse është kërkuar në specifikimet teknike bashkëngjitur kontratës në disa pika, e përkatësisht:
Pika 4 AuditTrail:

- ii. Auditim i logimeve, aksesimeve, ndryshimeve dhe hapjes së çfarëdo aspekti të sistemit;
- iii. Auditim i të gjitha njoftimeve të dërguara nga sistemi (email sms);
- iv. Auditim i login-eve të dështuara;
- v. Të gjitha auditimet duhet të jenë të raportueshme;

Pika 11.8 Administrimi dhe monitorimi i dokumenteve kriteri nr. 26 ñSistemi duhet të menaxhojë gjurmët (auditimet e sistemit informatik)ò;
Pika 11.9 Menaxhimi i regjistrimeve dhe procedurave administrative kriteri nr.14 ñSistemi nuk duhet të lejojë fshirje të gjurmëve nga skedarët e log-eve (audittrails or logs)ò dhe kriteri nr.23 ñSistemi duhet të ketë aftësi të regjistrojë ñaudittrailò për të gjitha aktivitetet që ndodhin në regjistrimeò.
Kriteri: Rregullore për *"Menaxhimin e Log-eve dixhitale në administratën publike"* miratuar nga AKCESK me Urdhrin nr. 109, datë 10.06.2016.
Ndikimi/Efekti: Nuk është e mundur të kontrollohet dhe të gjurmohet ndërhyrja e pa autorizuar.
Shkaku: Mos përmbushja e specifikimeve teknike nga kontraktori.
Rëndësia: E lartë
Rekomandim: DPD të marrë masat e nevojshme, për të siguruar përmbushjen e detyrime mbi specifikimet teknike për sistemin LIMS në lidhje me gjenerimin, administrimin, monitorimin dhe raportimin e gjurmës elektronike të auditimit quajtur ñ*Audit Log*ò.

Vazhdimësia në ofrimin e shërbimit

Back up i bazës së të dhënave bëhet në mënyrë periodike automatike si dhe në kohë reale (real-time), në serverat:
Serveri Standby 1 - ku procesi i back-up bëhet në kohë reale dhe transferimi përfshirë enkriptimin e të dhënave bëhet në nivel rrjeti të brendshëm.
Serveri Standby 2 - ku procesi i back-up bëhet me një kohë vonesë prej 4 orësh nga koha aktuale duke dhënë mundësi rikuperimi gabimesh njerëzore apo sistemi deri në 4 orë përpara gabimit.
Serveri Cold Back Up - ku procesi back-up bëhet në mënyre periodike të automatizuar çdo javë (njëherë në javë) ku ky server shërben dhe si server statistikash apo raportesh duke shmangur trafikun në serverin qendror.
Në raste të dështimit të serverit qendror, bëhet ngritja manuale e serverit **standby 1**, ku përmban të gjithë bazën e të dhënave në kohë reale. Në rast të një dështimi të sistemit qendror bëhet ngritja manuale e **serverit standby 2**, i cili përmban të dhëna deri në 4 orë përpara gabimit.
Në rastin më të keq, ku për shkak të një fatkeqësie dështojnë 3 serverat e bazës së të dhënave, mundësia është që të dhënat nga serveri **Cold Back up** të rikthehen pa përfshirë javën e fundit.
Back- up i programeve bëhet kur ka ndryshime në njësitë apo modulet e programit. Informacioni është i transmetuar vetëm në serverat e brendshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave ku enkriptimi dhe siguria janë në nivel rrjeti.

*Nga auditimi u konstatua se*DPD, si institucion që kadisa sisteme informacioni që ruajnë, përpunojnë dhe gjenerojnë të dhëna me rëndësi, për realizimin e mbikëqyrjes dhe tregtisë ndërkombëtare, nuk disponon një infrastrukturë BCC (BusinessContinuity Center), në kundërshtim me VKM nr. 710, datë 21.08.2013 ñ*Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit*ò, i ndryshuar, pika ....

Nuk është bërë i mundur evidentimi i sistemeve kritike për ofrimin e shërbimit 24 orë në 7 ditë të javës.

Nuk ka një procedure për backup/restore e cila duhet të bëhet të paktën 1 herë në muaj, me qëllim ruajtjen e informacionit dhe zvogëlimin e riskut të humbjes së të dhënave në sistemet që disponon.

Nga auditimi u konstatua se DPD **nuk disponon** një plan vazhdimësie dhe plan rikuperimi për garantimin e vazhdimësisë së ofrimit të shërbimit në kundërshtim me pikën 1, VKM nr. 710, datë 21.08.2013 ñ*Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit*ò, i ndryshuar, pika ... duke lënë pa vlerësuar impaktin në element shumë të rëndësishëm si:

- Identifikimi dhe prioritarizimi i aplikacioneve, i të dhënave dhe operacioneve kritike;
- Identifikimi i burimeve që mbështesin operacionet kritike;
- Identifikimi i personave relevantë duke përfshirë dhe nivelin e lartë drejtues në proces;
- Identifikimi i risqeve, dhe vlerësimi mbi ndikimin e biznesit, kontrollet parandaluese në drejtim të mjedisit dhe të sistemeve që gjenerojnë të dhëna, dokumentimi, testimi i planit të vazhdueshmërisë si dhe trajnimi i punonjësve mbi të cilët mbështetet implementimi i planit të vazhdimësisë;

4. Titulli i gjetjes: DPDnuk disponon një infrastrukturë BCC, si dhe nuk disponon një plan vazhdimësie dhe plan rikuperimi për garantimin e vazhdimësisë së ofrimit të shërbimit.
Situata: Nga auditimi u konstatua se DPD, si institucion që posedon disa sisteme informacioni që ruajnë, përpunojnë dhe gjenerojnë të dhëna me rëndësi për realizimin e mbikëqyrjes dhe tregtisë ndërkombëtare, nuk disponon një infrastrukturë BCC (BusinessContinuity Center), në kundërshtim me VKM nr.710, datë 21.08.2013 ñ*Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit*ò, i ndryshuar, pika 1.
DPD nuk ka një plan vazhdimësie dhe plan rikuperimi për garantimin e vazhdimësisë së ofrimit të shërbimit.
Kriteri: VKM nr. 710, datë 21.08.2013 ñ*Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit*ò, i ndryshuar., i ndryshuar.
Ndikimi/efekti: Risk në humbjen e të dhënave në rast fatkeqësie natyrore.
Shkaku: Nuk janë marrë masat e nevojshme.
Rëndësia: E lartë.
Rekomandimi:DPD në bashkëpunim me AKSHI-n nisur edhe nga rëndësia që ka ofrimi i shërbimit pas një fatkeqësie natyrore, të hartojnë planin e vazhdimësisë dhe planin e rikuperimit si dhe të ndërmarrin hapat e nevojshëm për sigurimin e pajisjeve të nevojshme në ndërtimin e *BusinessContinuity* si dhe të përcaktojnë burimet njerëzore përgjegjëse nga të dy institucionet.

Rrjeti Intranet në DPD është implementuar në Topologjinë Star në Layer 2 të modelit OSI. Të gjitha degët doganore janë konfiguruar si entitete të ndara nga njëra tjetra dhe lidhen me qendrën (HQ) nga e cila ofrohen shërbimet e nevojshme për çdo degë. Qendra ka një firewall qendror të brendshëm Checkpoint i konfiguruar në Cluster,i cili komunikon me firewallet e instaluar në degë duke siguruar një komunikim të sigurtë, gjithashtu shërben edhe si router.

*Nga auditimi mbi pajisjet rezulton se*Firewalli i internetit është Checkpoint i ndërtuar në një server që nuk është Cluster, vlerësohet nga grupi me rëndësi për arsye se në këtë pajisje janë konfiguruar lidhjet me institucionet bankare dhe me palë të treta apo me shtetet fqinje. Gjithashtu, nëpërmjet tij administrohen dhe VPN client për subjektet e akcizës agjencitë doganore apo institucione të tjera për aksesimin e sistemit.
Firewalli i internetit ka rëndësi të veçantë pasi mosfunksionimi i tij shkakton bllokim të punës në të gjitha degët doganore për shkak se pagesat që bëjnë subjektet apo individët nuk mund të procesohen nëpërmjet institucioneve bankare në drejtim të DPD.
Nëse do të ishin në Cluster dhe njëri shfaq probleme atëherë shërbimi kalon tek Firewalli Backup pa shkaktuar ndërprerje të shërbimit.

5. Titulli i Gjetjes: Nuk kaFirewall backup për rrjetin e internetit në DPD.
Situata: Nga auditimi mbi pajisjet TIK rezulton se Firewall-i i internetit është Checkpoint i ndërtuar në një server që nuk është Cluster, kjo mungesë backup në pajisje vlerësohet me rëndësi nga auditimi për arsye se në të janë konfiguruar lidhjet me institucionet Bankare, me palët e treta dhe me shtetet fqinjë. Gjithashtu, nëpërmjet tij administrohen dhe VPN client për subjektet e akcizës, agjencitë doganore apo institucione të tjera për aksesimin e sistemit.
Kriteri: Vazhdimësia në ofrimin e shërbimit nga DPD.
Ndikimi/Efekti: Bllokim të punës në të gjitha degët doganore, me bankat e nivelit të dytë për pagesat e klientëve, me agjentët doganorë.
Shkaku: Mos zbatim i praktikave me të mira të sigurisë dhe vazhdimësisë së ofrimit të shërbimit pa ndërprerje.
Rëndësia: E Lartë
Rekomandim: DPD të kërkojë nga AKSHI, prokurimin e pajisjes backup për linjën e internetit, me rëndësi për institucionin pasi në të janë konfiguruar lidhjet e jashtme me sistemin doganor, me qëllim parandalimin e ndërprerjes së punës në rast të një defekti në pajisjen aktuale.

b. Të drejtat e përdoruesve dhe menaxhimi i tyre

Përdoruesit e Sistemit Asycuda. Në sistemin me rëndësi kritike të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave janë afërsisht 2000 përdorues aktiv. Në këtë numër përdoruesish bëjnë pjesë punonjës të DPD, subjektet private që funksionojnë si agjentë doganor dhe subjektet që tregtojnë produkte të Akcizës.

Përdoruesit e Sistemit LIMS. Administrimi i përdoruesve (krijimi, modifikimi dhe mbyllje) në sistemin LIMS realizohet nga sektori HelpDesk, detyrë kjo e caktuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr.02/1, datë 07.05.2018, protokolluar me nr. 644/1, datë 07.05.2018. Ndërsa, nuk rezulton të ketë përshkrim pune për të njëjtin sektor në lidhje me sistemin LIMS në *"Rregulloren e Brendshme mbi Organizimin dhe Funksionimin e Drejtorisë së përgjithshme të Doganave"* miratuar me Urdhrin nr. 146, datë 07.05.2018 protokolluar me nr. 7786/1, datë 07.05.2018 edhe pse urdhri dhe rregullorja janë protokolluar në të njëjtën datë.
Grupi i auditimitkonstatoi se DPD për periudhën nën auditim nuk disponon një akt rregullativpër administrimin e përdoruesve në të cilin të përcaktohen procedurat që do të ndiqen për administrimin e përdoruesve.
Nuk dokumentohet në asnjë formë krijimi, ndryshimi, mbyllja dhe fshirja e përdoruesve, por i gjithë procesi administrohet nëpërmjet komunikimit sipas rastit me email. Nuk autorizohet në asnjë formë shkresore apo elektronike krijimi, ndryshimi, mbyllja apo fshirja e përdoruesve në këtë system.

Të dhënat që ruhen në krijimin e përdoruesit janë:
Emri -në të cilin shënohet emri ipërdoruesit;
Mbiemri - në të cilin shënohet emri ipërdoruesit;
Email - adresa e email-it;
Telefon ï numri ikontaktit;
Roli ï Roli përcaktohet nëpërmjet listës së krijuar më parë;
Përdoruesi - emri i përdoruesit me te cilin do te aksesohet sistemi;
Fjalëkalimi ï shkruan fjalëkalimin e ri;
Statusi ï active/jo active;

Nga verifikimi në nivel administrativ që grupi i auditimit kreu në sistem lidhur me krijimin, ndryshimin dhe mbylljen e përdoruesit, rezultoi se:

1. Nuk ka datë krijimi, datë ndryshimi dhe datë mbyllje të përdoruesit;
2. Në zgjedhjen e rolit të përdoruesit listohen dy mundësi D (doganier) dhe View (Monitorim Drejtoria e Përgjithshme), por në disa përdorues rezulton se roli ipërcaktuar nuk gjendet në listë si p.sh: DL (Drejtor Laboratori), PI (Përpunuese Informacioni), PSMA (Përgjegjëse e Sektorit të Metodikave të Administrimit);
3. Administratori mund të fshijë përdoruesin apo të ndryshojë të dhënattë cilat duhet të ishin të pandryshueshme si emri ipërdoruesit dhe fjalëkalimi.
4. Nuk është ndjekur injëjti standard në krijimin e përdoruesit në rolin doganier:
   - Në një rast është krijuar sipas modelit shkronja e parë e emrit.mbiemrit;
   - Në disa raste janë krijuar sipas modelit emër.mbiemër;
   - Në disa raste sipas modelit emër_mbiemër
   - Në një rast nukpërputhet emri i punonjësit me emërtimin e përdoruesit;

Kriteret e ndërtuara në sistemin LIMS për fjalëkalimin e përdoruesit fundor dhe administrimit janë të njëjta, me kriteret si më poshtë:

1. Nuk duhet të përmbajë hapësira boshe;
2. Jo më i shkurtër se 6 karaktere;
3. Jo 6 fjalëkalimet e fundit;

Nga auditimi rezulton se kriteret e ndërtuara për fjalëkalimet e përdoruesve fundor dhe ata administrues të sistemit nuk plotësojnë kërkesat e sigurisë përcaktuar në pikën 4 përkatësisht a) ñFjalëkalimet e përdoruesit fundorò dhe b) ñFjalëkalimet e sistemeve qendrore dhe administrimitò në *"Rregulloren për Administrimin e Fjalëkalimeve në Rrjetet dhe Sistemet Kompjuterike",* miratuar me Urdhrin nr. 86, datë 23.08.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK).

Të gjitha parregullsitë më sipër tregojnë mangësitë mbi administrimin e përdoruesve për krijimin, ndryshimin dhe mbylljen e përdoruesve në sistemin Asycuda dhe LIMS, janë në kundërshtim me pikën 4.3 të Rregullores së Brendshme si dhe rregulloren për ñAdministrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterikeò, miratuar nga CESK me urdhrin nr. 86, datë 23.08.2019.

6. Titulli i Gjetjes: Mangësi mbi menaxhimin e përdoruesve të sistemit AsycudaWorld dhe LIMS.

Situata: A. Grupi i auditimit për periudhën nën auditim në lidhje me menaxhimin e përdoruesve AsycudaWorld, konstatoi se:

- Nuk janë dokumentuar në asnjë formë politikat e implementuara për fjalëkalimet e sistemeve qendrore, administrimitdhe përdoruesit fundor, me qëllim informimin mbi kriteret e aplikuara në Asycuda si sistemi më i rëndësishëm dhe kritik i DPD, si dhe të aplikohen detyrimet që nevojiten në fjalëkalimin e tyre , bazuar në pikën 4 ñKërkesat e Sigurisëò pika a. dhe b. të rregullores për ñAdministrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterikeò miratuar nga CESK me Urdhrin nr. 86, datë 23.08.2019.
- Mbajnë statusin ñaktivò përdorues të cilët nuk kanë asnjë marrëdhënie aktive me DPD.
- Në të dhënat mbi përdoruesit rezulton se në disa raste është mbyllur përdoruesi ekzistues dhe krijuar përdorues i ri për të njëjtin punonjës.
- Rezulton më shumë se një përdorues për të njëjtin person;

- DPD nuk ka dokumentuar në asnjë formë përdoruesit e bazës së të dhënave dhe të drejtat që ata kanë;
- Disa përdorues Brokers rezultojnë me të drejta si ñAdministratorò;
- Për disa përdorues nuk ka datë krijimi;
- Të dhënat e kontaktit në pjesën më të madhe janë plotësuar me ñ1ò e në disa raste nuk janë plotësuar fare, në vend të të dhënave të vlefshme;
- Janë funksionale disa role me të drejta administrative si: a, aa, admin, Administrator, çfarë tregon se mungon unifikimi i rolit në aplikacion.
- Adresa e përdoruesit është një e dhënë tekst e pa bazuar në ndonjë standard, herë është plotësuar qyteti dhe herë roli që ka përdoruesi, në disa raste adresa është një numër prsh ñ100ò;
- Emri i plotë në disa raste është plotësuar me numër;
- Nuk është respektuar i njëjti standard në krijimin e ñusernameò ku pjesa më e madhe është krijuar me emërmbiemër, por në disa raste ky model nuk është ndjekur.
- Përcaktimi i fushës ñJOBò është në disa forma për të njëjtin informacion p.sh në disa raste përdoruesve ju është caktuar fusha ñTradeò e në disa raste ñTraderò, çfarë tregon se mungon standardi dhe në përcaktimin e roleve të njëjta në përdoruesit që krijohen dhe kjo e dhënë nuk rezulton të jetë një listë e miratuar por caktohet nga specialisti që regjistron për herë të parë përdoruesin.

B. Nga verifikimi në nivel administrativ që grupi i auditimit kreu në sistem lidhur me krijimin, ndryshimin dhe mbylljen e përdoruesve në sistemin LIMS, rezultoi se:

- Å Nuk ka datë krijimi, datë ndryshimi dhe datë mbyllje të përdoruesit;
- Å Në zgjedhjen e rolit të përdoruesit listohen dy mundësi D (doganier) dhe View (Monitorim Drejtoria e Përgjithshme), por në disa përdorues rezulton se roli I përcaktuar nuk gjendet në listë si p.sh: DL (Drejtor Laboratori), PI (Përpunuese Informacioni), PSMA (Përgjegjëse e Sektorit të Metodikave të Administrimit);
- Å Administratori mund të fshijë përdoruesin apo të ndryshojë dhënat e pandryshueshme si emri i përdoruesit dhe fjalëkalimi.
- Å Nuk është ndjekur i njëjti standard në krijimin e përdoruesit në rolin doganier:
- Å Në një rast është krijuar sipas modelit shkronja e parë e emrit.mbiemër;
- Å Në disa raste janë krijuar sipas modelit emërmbiemër;
- Å Në disa raste sipas modelit emër_mbiemër
- Å Në një rast nuk përputhet emri i punonjësit me emërtimin e përdoruesit;

Kriteret e ndërtuara nësistemin LIMS për fjalëkalimin e përdoruesit fundor dhe administrimit janë të njëjta: kur nuk duhet të përmbajë hapësira boshe; jo më i shkurtër se 6 karaktere; jo 6 fjalëkalimet e fundit;

Kriteri: Ligji nr. 2/2017, datë 26.01.2017 *"Për Sigurinë Kibernetike", R*regullore e ALCIRT për ñAdministrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterikeò ,pika 4.3 e rregullores së brendshme ku citohet se ñ*Krijimi, mirëmbajtja dhe menaxhimi i përdoruesve në Asycuda është detyrë funksionale e Sektorit të Zgjidhjeve dhe Suportit (HelpDesk)"*

Ndikimi/Efekti: : Risk për kompromettimin e të dhënave dhe humbjes së gjurmës audituese

Shkaku: Mos hartimi dhe miratimi i akteve rregullative.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse dhe niveli drejtues i DPD të marrin masa për hartimin dhe miratimin e rregullores, për përdoruesit e sistemit Asycuda dhe LIMS ku të identifikohen qartë:

- rregullat e monitorimit,
- politikat e implementuara për fjalëkalimet e administrimitdhe përdoruesit fundor
- të dhënat e detyrueshme që nevojiten të plotësohen për çdo përdorues
- të dhënat e pandryshueshme për secilin prej tyre,

- ndalimin e krijimit të më shumë se një përdoruesi për punonjës
- ndalimin e krijimit të një përdoruesi të ri për punonjësin ekzistues, etj.

Rekomandim: Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse të unifikojë të dhënat për përdoruesit e sistemit Asycuda dhe LIMS të njëjtës kategori, të plotësojë të dhënat që mungojnë për çdo përdorues, të ndërtojë kontrolle për mbylljen e përdoruesve në kohën e duhur, të mbyllë përdoruesit të cilët kanë përfunduar objektin e krijimit, me qëllim ruajtjen e sistemit nga ndërhyrjet e paautorizuara.

Rekomandim: Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse të ndërtojë mekanizma kontrolli për dokumentimin dhe miratimin fizik të ndryshimeve të lejuara për përdoruesit, për të cilat nuk gjenerohet një gjurmë elektronike auditimi.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr.570/2, datë 19.07.2021 ñMbi Projekt raportin e Auditimitò nga znj. B.I, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 673, datë 22.11.2017 ñPër Riorganizimin e Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së lnformacionitò, i ndryshuar, pika 2, e tij sanksionon sa më poshtë : ñAKSHI financohet nga buxheti i shtetit dhe të ardhura të tjera të ligjshme, përfaqëson pronarin shtet dhe administron çdo sistem dhe infrastrukturë hardware dhe software në fushën TIK, për institucionet dhe organet e administratës buxhetore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministraveò, për sa kërkohet, nuk është përgjegjësi e Sektorit Zgjidhje Suport (Helpdesk).

Qëndrimi i Grupit të auditimit:Për sa më sipër grupi i auditimit sqaron se konstatimi qëndron, dhe me qëllim përmirësimin e situatës rekomandimi së*pari i drejtohet nivelit drejtues të DPD dhe AKSHIT*, për ndërtimin e politikave të cilat duhet të jenë pjesë e marrëveshjes institucionale ndërmjet DPD dhe AKSHI-t. Për këtë arsye grupi mban të njëjtin qëndrim.

Pretendimi i subjektit: Rastet e konstatuara, audites të KLSH, të cilët nuk kanë dërguar email pranë këtij Sektori për përfundimin e periudhës së auditimit. Nësegjenden raste të tilla, përcaktohet emri, kalohet në investigim të detajuar, për të evidentuar arsyen përse ka ndodhur rasti. Përcaktimi i rasteve, pa përcaktim të arsyes përse ka ndodhur, nuk mund të jetë shkas për përgjithësim se mundësia që të jenë aktiv në sistem dhe punonjës që kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës me DPD është shumë e lartë.

Të gjitha emërimet, largimet apo ndryshimet e pozicioneve të punës paraqiten pranë këtij sektori me email apo shkresërisht dhe pozicionohet në emërimet e ardhura nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, menjëherë ky sektor vepron në sistem referuar datës së emërimit apo të largimit të punonjësit në momentin kur shkresa vjen pranë këtij sektori.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:Për sa më sipër grupi i auditimit sqaron se, data e përfundimit të aksesit në sistem dhe emrat e punonjësve janë të përcaktuar në dokumentacion zyrtar ku ju bazoheni për hapjen e llogarive të përdoruesit. Praktika për njoftimin e përfundimit të aksesit nuk gjendet e dokumentuar e si rrjedhojë nuk është detyrim i përdoruesit të njoftojë mbylljen e llogarive. Kjo do të thotë se, nuk qëndron argumenti juaj, por qëndron risku potencial për ndërhyrje të paautorizuar, për të cilën grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim.

Pretendimi i subjektit:Në rastet kur është mbyllur përdoruesi ekzistues dhe krijuar përdorues i ri për të njëjtin punonjës apo ka më shumë se një përdorues për të njëjtin person këto raste janë aplikuar për user-a të cilët kanë shfaqur probleme teknike, nuk kanë funksionuar, gjë e cila është sugjeruar me email nga Strukturat e administrimit të databazës në konsultim me UNCTAD.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:Për sa më sipër grupi i auditimit sqaron se, argumenti juaj nuk qëndron nga ana teknike që do të thotë se nuk është e mundur që përdoruesi të ketë probleme teknike të cilat e pengojnë të kryeje detyrat në sistem. Për më tepër nuk keni paraqitur dokumentacion shoqërues se probleme te tilla teknike i keni adresuar tek zhvilluesit e sistemit për zgjidhje. Për këtë arsye grupi mban të njëjtin qëndrim.

Pretendimi i subjektit:Në lidhje me konstatimin se DPD nuk ka dokumentuar në asnjë formë përdoruesit e bazës së të dhënave dhe të drejtat që atë kanë subjekti sqaron se në vijim të Urdhritnr.146, datë 07.05.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, janë njoftuar Degët Doganore me shkresën nr. 8160 datë 01.04.2019 pranë Sektorit Zgjidhje Suport (Helpdesk) për të përcaktuar të drejtat e user-ave bazohet në: a) Shkresa nr. prot 9146 datë 10.04.2019, Lënda: Proceset e punës për Degët Doganore (bashkëlidhur gjeni dokumentin) b)Urdhër nr.2 datë 13.02.2020 "Për miratimin e të drejtave në Sistemin AW të përdoruesve në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave sipas pozicioneve të punës" bashkëlidhur gjeni dokumentin)

Qëndrimi i Grupit të auditimit:Për sa më sipër grupi i auditimit sqaron se, ky konstatim i referohet përdoruesve të bazës së të dhënave shtetërore në të cilën aktualisht punojnë specialistët e AKSHI-t. Identifikimi dhe monitorimi i tyre jo vetëm që duhet të ishte i përcaktuar në marrëveshje, por duhet të monitorohet vazhdimisht nga DPD për çdoherë që ka nevojë për të kryer përmirësime në këtë të drejtë kaq sensitive mbi të dhënat e DPD. Për këtë arsye grupi mban të njëjtin qëndrim.

Pretendimi i subjektit:Në lidhje me konstatimin se disa përdorues Brokers rezultojnë me të drejta si "Administrator" subjekti sqaron se:Referuar Urdhër 146 datë07.05.2018 ñMbi miratimi e Rregullores së brendshme të Administratës Doganoreò, neni 63, pika 4.3 "Detyrat funksionale të Sektorit Zgjidhje Suport (Helpdesk) - Krijon, mirëmban dhe menaxhon përdorues për sistemin AsycudaWorld mbi bazën e një urdhëri të aprovuar nga titullarët".
Këto përdorues nuk krijohen nga Sektori Zgjidhje Suport (Helpdesk) por, nga struktura të tjera të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të përcaktuara nga përshkrimet e vendit të punës.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:Për sa më sipër grupi i auditimit sqaron se, parregullsitë në lidhje me përdoruesit i drejtohen nivelit drejtues në DPD i cili duhet të marrë masate nevojshme për delegimin e përgjegjësive brenda strukturave monitoruesepërdoruesve të jashtëm dhe të brendshëm të DPD. Për këtë arsye grupi mban të njëjtin qëndrim.

Pretendimi i subjektit:Në lidhje me konstatimin se për disa përdorues nuk ka datë krijimi subjekti sqaron se: sistemi AsycudaWorld lë gjurmë për çdo krijim dhe modifikim të user-ave, në gjurmë përcaktohet data, ora dhe personi që e ka bërë ndryshimin mbi user-in. User-at që nuk kanë datë krijimi janë user-at e importuar në momentin e migrimit të sistemit nga Asycuda++ në AsycudaWorld (nga sistemi i vjetër në sistemin e ri), dhe si datë shfaqet data e importimit të të dhënave.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:Për sa më sipër grupi i auditimit sqaron se:Disa përdorues nuk kanë datë krijimi, ndërsa për të tjerë është plotësuar kjo e dhënë, që do të thotë se është mundësia të plotësohet nëpërmjet sistemit, por nuk është bërë. Nuk mjafton fakti që sistemi AsycudaWorld lë gjurmë për çdo krijim dhe modifikim të user-ave lë gjurmë, sepse këto gjurmë jo vetëm që nuk monitorohen por janë fshirë për periudha të caktuara.Për këtë arsye grupi mban të njëjtin qëndrim.

Pretendimi i subjektit:Në lidhje me konstatimin se të dhënat e kontaktit në pjesën më të madhe janë plotësuar me "1" e në disa raste nuk janë plotësuar fare, subjekti sqaron se në shkresën e emërimit ardhur nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore që paraqitet pranë Sektorit Zgjidhje Suport (Helpdesk), nuk ka të plotësuar të dhënat personale të punonjësit që po emërohet, shkresa të cilën punonjësi po hedh në sistem disponon të dhëna vetëm të pozicionit

dhe datës të emërimit. Fusha kërkon minimalisht një variabël për të plotësuar, prandaj zgjidhet një karakter rastësor.
Qëndrimi i Grupit të auditimit:Për sa më sipër grupi i auditimit sqaron se, fakti që ju ekeni mundësinë nëpërmjet sistemit të regjistroni dhe të dhëna të kontaktit është pozitive dhe duhet shfrytëzuar nga ana juaj. Pra do të ishte e drejtë të modifikoni shkresën e burimeve njerëzore në vend të plotësimit variabël të kësaj fushe. Për këtë arsye grupi mban të njëjtin qëndrim.
Pretendimi i subjektit: Në lidhje me konstatimin se janë funksionale disa role me të drejta administrative si: a. aa, admin, Administrator, çfarë tregon se mungon roli në aplikacion, subjekti sqaron se referuar Urdhër 146 datë 7.05.2018 òMbi miratimi e rregullores së brendshme të administratës doganoreò, neni 63, pika 4.3 "Detyrat funksionale të Sektorit Zgjidhje Suport (Helpdesk) - Krijon, mirëmban dhe menaxhon përdorues për sistemin AsycudaWorld mbi bazën e një urdhri të aprovuar nga titullarët". Useri ñadminò etj i cili nuk është krijuar dhe nuk përdoret nga Helpdesk, nëse shihen detajet e këtij useri evidentohen gjurmët e krijimit, user-i është i krijuar nga zhvilluesi i sistemit. Sektori Zgjidhje Suport (Helpdesk) nuk ka të drejtë të krijojë role.
Qëndrimi i Grupit të auditimit:Për sa më sipër grupi i auditimit sqaron se, problematika qëndron, por nuk i adresohet sektorit tëHelpDeskut ky rekomandim.
Pretendimi i subjektit: Në lidhje me konstatimin se adresa e përdoruesit është një e dhënë text e pa bazuar në ndonjë standard, herë është plotësuar qyteti dhe herë roli që ka përdoruesi, në disa raste adresa është një numër prsh ñ100ò, subjekti sqaron se, user-i që krijohet nga Sektori Zgjidhje Suport (helpdesk) në AW ka format emër.mbiemër, ku vendosen të dhëna në fushat përkatëse: -përcaktohet numri i shkresës me të cilën po veprohet, kodi i Degës Doganore -përcaktohet pozicioni i punës (në përputhje me shkresën përkatëse) -përcaktohen të drejtat sipas pozicionit të punës, në përputhje me të drejtat e usera-ve -vendoset passwordi (jo default), -bëhet njoftimi i kredencialeve në email zyrtar xxxx.xxxx@dogana.gov.al
psh: Kodi '100' përdoret për ñDrejtorinë e Përgjithshme të Doganaveò, kodi '321 ' përdoret për Degën Doganore Tiranë..., etj
Qëndrimi i Grupit të auditimit: Për sa më sipër grupi i auditimit sqaron se, nuk është ndjekur e njëjta formë plotësimi, siç mund ta vini re nga raportet e të dhënave për përdoruesit që do të merrni për çdo çështje që ka ngritur grupi i auditimit. Gjithashtu sqarojmë se, ju duhet të jeni më të interesuar se kushdo për standardizimin e të dhënave të përdoruesit dhe jo të kundërshtoni çdo konstatim që ka për qëllim përmirësimin dhe standardizimin e të dhënave të përdoruesit. Për këtë arsye grupi mban të njëjtin qëndrim.
Pretendimi i subjektit:Në lidhje me konstatimin se emri i plotë në disa raste është plotësuar me numër subjekti sqaron se pozicioni i punonjësve të monitorimit të cilët në bazë të procesit të punës nuk duhet që ti shfaqet emri në deklaratë doganore që po përpunohet në këtë sektor, është vendosur standard krijimi i user-ave me emrin monitorim001 (numri rendor rritet progresivisht), nëse një punonjës është emëruar në Sektorin e Monitorimit, mbyllet useri me emrin e tij dhe krijohet një user monitorimi123 (numër rendor pasardhës i atij të fundit)
Qëndrimi i Grupit të auditimit:Për sa më sipër grupi i auditimit sqaron se, konstatimi i referohet faktit qëemri i plotë në disa raste është plotësuar me numër, siç mund ta vini re nga raportet e të dhënave për përdoruesit që do të merrni për çdo çështje që ka ngritur grupi i auditimit. Për këtë arsye grupi mban të njëjtin qëndrim.
Pretendimi i subjektit:Në lidhje me konstatimin se nuk është respektuar i njëjti standard në krijimin e "username" ku pjesa më e madhe është krijuar me emër.mbiemër, por në disa raste ky model nuk është ndjekur, subjekti sqaron se në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave kemi: - User-a në DPD, - User-a në Degë Doganore, -User-a që kanë aktivitet të miratuar nga DPD (Agjent doganorë, deklarues të drejtpërdrejtë, Subjekt Akcize), -User-a për Institucionet të aprovuara me akt-marrëveshje. Referuar Urdhër nr.146 datë 7.05.2018 Mbi miratimin e Rregullores së brendshme të Administratës Doganore, Neni 63, pika 4.3 "Detyrat funksionale

të Sektorit Zgjidhje Suport (Helpdesk) - Krijon, mirëmban dhe menaxhon përdorues për sistemin AsycudaWorld mbi bazën e një urdhëri të aprovuar nga titullarët". Duhen evidentuar rastet konkrete për të përcaktuar saktë çfarë ka ndodhur në procesin e krijimit të userit, kush punonjës e ka krijuar dhe në cilën drejtori/sektor ndodhet. Sektori Zgjidhje Suport krijon user-a vetëm në formatin emër.mbiemër.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Për sa më sipër grupi i auditimit sqaron se, rasteve që grupi i referohet janë:*emër..mbiemër, emër:mbiemër, emër,mbiemër, emër*,etj. Të gjithë përdoruesit të cilët janë sipas modelit të përmendur më sipër, nuk janë në përputhje me modelin emër.mbiemër në të cilin jeni bazuar referuar urdhrit nr.146,datë07.05.2018 ñMbi miratimin e Rregullores së brendshme të Administratës Doganoreò, neni 63, pika 4.3 "Detyrat funksionale të Sektorit Zgjidhje Suport (Helpdesk) - Krijon, mirëmban dhe menaxhon përdorues për sistemin AsycudaWorld mbi bazën e një urdhri të aprovuar nga titullarët".

Me analizimin e të dhënave të përdoruesve vetë ju mund të konstatoni më shumë se 1 rast për çdo model që ju ka vënë në dispozicion grupi i auditimit. Për këtë arsye grupi mban të njëjtin qëndrim.

Pretendimi i subjektit:Në lidhje me konstatimin se përcaktimi i fushës ñJOBò është në disa forma për të njëtin informacion prsh në disa raste përdoruesve ju është caktuar fusha "Trade" e në disa raste "Trader", subjekti sqaron se ñAKSHI financohet nga buxheti i shtetit dhe të ardhura të tjera të ligjshme, përfaqëson pronarin shtet dhe administron çdo sistem dhe infrastrukturë hardware dhe software në fushën TIK, për institucionet dhe organet e administratës buxhetore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, Rolet në sistemin AsycudaWorld nuk krijohen nga ADSH, nuk është detyrë funksionale e Sektorit Zgjidhje Suport (Helpdesk), Drejtoria Teknike e Akcizës krijon, menaxhon usera-t e Operatorëve Ekonomik te Akcizës.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Për sa më sipër grupi i auditimit sqaron se, konstatimi qëndron porju observoni përgjegjësinë apo të drejtën për të rregulluar situatën. Grupi i auditimit do të kërkojë vendosjen e standardeve në plotësimin e të dhënave të përdoruesit nga niveli drejtues i DPD si dhe AKSHI-t. Për këtë arsye grupi mban të njëjtin qëndrim.

Pretendimi i subjektit:Në lidhje me konstatimin se DPD për periudhën nën auditim nuk disponon një akt rregullativ për administrimin e përdoruesve në të cilin të përcaktohen procedurat që do të ndiqen për administrimin e përdoruesve; nuk dokumentohet në asnjë formë krijimi, ndryshimi, mbyllja dhe fshirja a e përdoruesve, pori gjithë procesi administrohet nëpërmjet komunikimit sipas rastit me email; nuk autorizohet në asnjë, formë shkresore apo elektronike krijimi, ndryshimi, mbyllja apo fshirja e përdoruesve në këtë sistem, sqaron se referuar Urdhër 146 datë 7.05.2018 Mbi miratimin e Rregullores së brendshme të Administratës Doganore, Neni 63, pika 4.3 "Detyrat funksionale të Sektorit Zgjidhje Suport (Helpdesk) - Krijon, mirëmban dhe menaxhon përdorues për sistemin AsycudaWorld mbi bazën e një urdhri të aprovuar nga titullarët".

Me shkresën e emërimit miratuar nga titullari i Institucionit, referuar pozicionit të punës të përcaktuar nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, përgjegjësi i turnit i degës doganore të cilës është doganieri dërgon email për punonjësin i cili do të ketë të drejtë të marrjes së mostrës.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:Për sa më sipër grupi i auditimit sqaron se administrimi i përdoruesve të sistemit LIMS. (krijimi,modifikimi dhe mbyllje) realizohet nga sektori HelpDesk, detyrë kjo e caktuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr.02/1, datë 07.05.2018, protokolluar me nr. 64411, datë 07.05.2018. Pra krahas Rregullores sëBrendshme është detyrë e juaja të zbatoni dhe urdhrat e titullarëve. Nëse jeni apo jo në dijeni të këtij urdhri ky është problem i menaxhimit financiar për të cilin duhet të mbajnë përgjegjësi drejtuesit e DPD qëçdo urdhër i komunikohet stafit përgjegjës që ka detyrë ta zbatojë atë. Për këtë arsye grupi mban të njëjtin qëndrim.

Pretendimi i subjektit:Në lidhje me konstatimin se në sistemin LIMS, nuk ka datë krijimi, datë ndryshimi dhe datë mbyllje të përdoruesit, subjekti sqaron se ñAKSHI financohet nga buxheti i shtetit dhe të ardhura të tjera të ligjshme, përfaqëson pronarin shtet dhe administron çdo sistem dhe infrastrukturë hardware dhe software në fushën TIK, për institucionet dhe organet e administratës buxhetore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministraveò. Çdo përdorues ka datën e krijimit dhe mbylljes dhe mund të shikohen në DataBase, për sa kërkohet, nuk është përgjegjësi e Sektorit Zgjidhje Suport (Helpdesk).

Qëndrimi i Grupit të auditimit: Për sa më sipër grupi i auditimit sqaron se, situata në sistem paraqitet pa të dhëna për datë krijimi, datë ndryshimi dhe datë mbyllje të përdoruesit, ndërsa përgjegjësia i takon zhvilluesit të programit si dhe DPD të ndjekë zbatimin nëçdo pikë të specifikimeve teknike për sistemin LIMS si detyrim kontraktor i OE.Për këtë arsye grupi mban të njëjtin qëndrim.

Pretendimi i subjektit:Në lidhje me konstatimin e parregullsisë së roleve në sistemin LIMS subjekti sqaron se ñAKSHI financohet nga buxheti i shtetit dhe të ardhura të tjera të ligjshme, përfaqëson pronarin shtet dhe administron çdo sistem dhe infrastrukturë hardware dhe software në fushën TIK, për institucionet dhe organet e administratës buxhetore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministraveò. Rolet e përcaktuar janë në bazë të funksioneve të punës që kryejnë struktura të përcaktuara. Ky software është në funksion të punës dhe procedurave që kryen Drejtoria e Laboratorit Doganor. Për sa kërkohet, nuk është përgjegjësi e Sektorit Zgjidhje Suport (Helpdesk).

Pretendimi i subjektit:Në lidhje me konstatimin se administratori mund të fshijë përdoruesin apo të ndryshojë të dhënat të cilat duhet të ishin të pandryshueshme si emri i përdoruesit dhe fjalëkalimi në sistemin LIMS, subjekti sqaron se, "AKSHI financohet nga buxheti i shtetit dhe të ardhura të tjera të ligjshme, përfaqëson pronarin shtet dhe administron çdo sistem dhe infrastrukturë hardware dhe software në fushën TIK, për institucionet dhe organet e administratës buxhetore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministraveò për sa kërkohet, nuk është përgjegjësi e Sektorit Zgjidhje Suport (Helpdesk).

Pretendimi i subjektit:Në lidhje me konstatimin se mungon standardi për emrin e përdoruesit si dhe për kriteret e fjalëkalimit subjekti sqaron se ñAKSHI financohet nga buxheti i shtetit dhe të ardhura të tjera të ligjshme, përfaqëson pronarin shtet dhe administron çdo sistem dhe infrastrukturë hardware dhe software në fushën TIK, për institucionet dhe organet e administratës buxhetore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave. Standardi që është përdorur është shkronja e parë e emrit _mbiemri për arsyen që të bëhej dallimi nga përdorues të sistemitAsycudaWorld (emër.mbiemër). Përjashtim bëjnë disa usera, përdorues lab i cili përdoret nga punonjësit e Laboratorit. Role të caktuara i caktohen vetëm një punonjësi (psh. PSMA), në momentin që ky rol i jepet një punonjësi tjetër, çô fuqizohet nga punonjësi i parë dhe ky user bëhet joaktiv, në këtë moment bëhet e mundur krijimi i një useri të ri me të njëjtin rol (psh.PSMA). Referuar parregullsive të paraqitura nga ana juaj në dokumentin e mësipërm ju bëjmë me dije se: Sektori Zgjidhje Suport (Helpdesk) është strukture e Drejtorisë së Burimeve Mbështetëse pranë Departamentit Administrativ në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, mbështetur në Urdhër nr.146 datë 7.05.2018 Mbi miratimin e Rregullores së brendshme të Administratës Doganore, Neni 63, pika 4.3 "Detyrat funksionale të Sektorit Zgjidhje Suport (Helpdesk) Krijon, mirëmban dhe menaxhon përdorues për sistemin AsycudaWorld mbi bazën e një urdhri të aprovuar nga titullarët". User-at nga Sektori Zgjidhje Suport (Helpdesk), krijohen duke ju referuar shkresës së ardhur nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe proceseve të punës që duhet të ketë çdo pozicion pune në sistemin AW, të miratuar me shkresën nr. 9146 datë 10.04.2019 Lënda: Proceset e punës për Degët Doganore dhe urdhër nr.2 datë 13.02.2020 "Për miratimin e të drejtave në Sistemin AW të përdoruesve në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave sipas pozicioneve të punës". -Në vijim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 673, datë 22.11.2017 "Për

Riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit", i ndryshuar, pika 2, e tij sanksionon sa më poshtë "AKSHI financohet nga buxheti i shtetit dhe të ardhura të tjera të ligjshme, përfaqëson pronarin shtet dhe administron çdo sistem dhe infrastrukturë hardware dhe software në fushën TIK, për institucionet dhe organet e administratës buxhetore nën përgjegjësinë e Këshillit to Ministrave, ..."
Bashkëlidhur gjeni, -shkresa nr. prot 9146 datë 10.04.2019 Lënda: Proceset e punës për Degët Doganore; -urdhër nr.2 datë 13.02.2020 "Për miratimin e të drejtave në Sistemin AW të përdoruesve në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave sipas pozicioneve të punës".
Qëndrimi i Grupit të auditimit: Për sa më sipër në të tre rastet që subjekti pretendon më sipër, grupi i auditimit sqaron se përgjegjësia për këtë konstatim duhet përcaktuar nga drejtuesit e DPD me akte të brendshme rregullative dhe nuk ju referohet ju si sektor apo si përgjegjës sektori. Grupi mban të njëjtin qëndrim dhe do të rekomandojë rregullimin e situatës.

Për sa është konstatuar më lart, mbajnë përgjegjësi:
z. IM me detyrë Drejtori i Burimeve Mbështetëse sipas detyrave funksionale të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Administratës Doganore, nenet 9 dhe 63, miratuar nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë menr. 146, datë 07.05.2018;
z. ED me detyrë Drejtori i Drejtorisë TIK të Doganavesipas detyrave funksionale të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme ñMbi Detyrat dhe Funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionitò, neni 22, miratuar nga AKSHI menr. 1900, datë 16.04.2020 si dhe drejtuesit e DPD dhe AKSHI-t për mungesën e standardevenë plotësim dhe akteve rregullativepëradministrimtëpërdoruesve të sistemeve tëauduituar në DPD.

2.5. Auditimi i sistemeve.
a. Verifikim i kontrolleve të aplikacioneve për të dhënat Input/Output

Objektivi. Vlerësimi i kontrolleve të aplikacioneve për të dhënat Input/Output ka si qëllim të verifikojë kontrollet e implementuara në aplikacionet që disponon dhe operon Drejtoria e Përgjithshme Doganore si dhe hyrjen me saktësi të të dhënave dhe raportimin e tyre në funksion të arritjes së objektivave.

Në zbatim të pikës 5 në programin e auditimit për ñ*Auditimi i Sistemeve*ò, me drejtim ñ*Auditimi mbi kontrollet e aplikacioneve dhe të dhënat Input / Output*ò, kemi shqyrtuar:
- Aktet ligjore/nënligjore/rregullative që përcaktojnë regjistrimin dhe ruajtjen e të dhënave përfshirë dhe Standardet e sigurisë miratuar nga CESK;
- Manualet e përdorimit të sistemeve;
- Ndjekjen e realizimit të proceseve të punës;
- Analizimin e gjurmës audituese të dokumentuar në letër si dhe elektronike (logs);
- Pyetësorë e Intervista me punonjës; etj;

I. AsycudaWorld - Sistemi i Integruar i Menaxhimit të të Dhënave Doganore

ASYCUDA World (AW) është Sistemi i Integruar i Menaxhimit të të Dhënave Doganore, i zhvilluar nga UNCTAD, i cili funksionon në Administratën Doganore të Shqipërisë prej disa vitesh. Ky sistem është regjistruar si bazë të dhënash shtetërore, dokumentuar me shkresën nr.1346/1, datë 17.08.2015 nga AKSHI, por që prej vitit 2015, nuk është miratuar asnjë akt ligjor apo vendim i KM që miraton këtë bazë të dhënash si shtetërore në përputhje me ligjin

nr.10325, datë 23.09.2010, për ñBazat e të dhënave shtetëroreò, neni 4, pika 1 ku citohet se ñ*Baza e të dhënave shtetërore krijohet me ligj ose me vendim të Këshillit të Ministrave*ò.
Gjithashtu, nuk rezulton të jetë miratuar ndonjë akt rregullativ i brendshëm i DPD, me qëllim organizimin dhe funksionimin e brendshëm të bazës së të dhënave, në përputhje me kërkesat eligjitnr.10325, datë 23.09.2010, për ñBazat e të dhënave shtetëroreò, neni 5, ku citohet se ñ*Rregulloret për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të bazës së të dhënave shtetërore përcaktohen nga institucioni administrues dhe miratohen nga titullari i tij, në përputhje me standardet, rregullat dhe procedurat e përcaktuara sipas nenit 10 të këtij ligji*ò.

Input. Me anë të shkresës nr.1346/1, datë 17.08.2015, është specifikuar se cilat janë të dhënat parësore në këtë sistem, të cilat rezultojnë grupuar në 3 grupe:

1. Të dhënat e domosdoshme për hartimin e deklaratës doganore DAV (Dokumenti i Vetëm Administrativ) si:
- Kodet e Nomeklaturës;
- Llojet e taksave;
- Vlera e mallit;
- Info për mjetet;
2. Në varësi të procedurës përkatëse doganore të llojit ï IM/EX, DSHA;
- Dokumenti Shoqërues Administrativ / Deklarata për detyrimet e AKC, T1(dekl. Tranziti);
- TIR;
- Manifest;
- Carnet ï Tir;
- Dokumente Shtesë (shoqërues);
- Fatura / Certifikata / Vërtetime;
3. Informacioni i marrë në sistemin AsycudaWorld nga bankat e nivelit të dytë, për pagesat on-line.

Çdo e dhënë që përpunohet në sistemin ASYCUDA WORLD ruhet në serverin qendror tëbazave të të dhënave. Kjo bazë të dhënash është ndërtuar në ORACLE 11g. BACK-UP kryhet në serverat fizike emërtuar: stand-by1, stand-by2 dhe statistics.
*Stand-by1***.** Është serveri backup i databazës qendrore e cila replikon në kohë reale me serverin qendror prime-db. Ky server përdoret nga administrata doganore për qëllime statistikore me akses të kufizuar vetëm në sektorët që kanë të nevojshëm raporte të cilat gjenerohen në kohë reale. Sektorët që aktualisht kanë akses në ketë server janë: Sektori i Monitorimit, Informacionit dhe të tjera me kërkesë nga drejtoria përkatëse. Replikimi bëhet nga elementi RMAN pjesë e oracledatabase.
*Stand-by2***.** Është serveri backup i databazës qendrore e cila replikon me një kohë vonesë prej 4 orësh me serverin qendror prime-db. Ky server nuk është i aksesueshëm nga administrata doganore për arsye se krijimi i tij është bërë nga nevoja e një serveri back-up për ruajtjen e informacionit nga rreziqet e gabimeve njerëzore të cilët kanë akses në bazën e të dhënave apo dhe rreziqeve të natyrave të tjera.
Statistics. Është serveri Cold Backup i databazës qendrore e cila bëhet në mënyrë automatike çdo të dielë. Backup i cili përmban të gjithë informacionin e databazës qendrore, deri në datën e fundit të transferuar (të dielën). Ky server përdoret nga administrata doganore për qëllime raportimi të detajuar. Në ketë server për secilin BACK-UP të transferuar, performohet procedura UPDATE_STATISTICS, procedurë e cila zgjat 6-12 orë dhe bën të mundur bashkimin dhe përditësimin e disa të dhënave të kërkuara nga administrata doganore. Kjo procedurë bëhet mbas transferimit të plotë të këtij BACKUP. Ky server ka akses të kufizuar dhe përdoret nga DPD dhe Degët Doganore sipas kërkesës.

Fig. 1



Burimi: Drejtoria e IT së AKSHIT për DPD

Nga auditimi rezulton se, nuk janë dokumentuar të dhënat dytësore që i nevojiten kësaj baze të dhënash për të mirë funksionuar si dhe të dhënat apo sistemet me të cilat ndërveprohet sipas përcaktimeve në ligjin nr.10325, datë 23.9.2010, për ñ*Bazat e të dhënave shtetërore*ò, neni 7 dhe neni 8 ku respektivisht citohet se:

- Neni 7: ñ*Baza e të dhënave shtetërore përmban të dhënat parësore dhe të dhënat dytësore.*
a) Të dhënat parësore të një baze të dhënash shtetërore janë informacione specifike, të mbledhura nga institucioni administrues, në përputhje me aktin e krijimit.
*b) Të dhënat dytësore janë të dhënat që merren nga një bazë tjetër të dhënash, ku ato janë parësore*ò;
- Neni 8*: "1. Ndërveprimi ndërmjet bazave të të dhënave shtetërore bëhet vetëm me të dhënat parësore. 2. Ndalohet ndërveprimi i bazave të të dhënave shtetërore me të dhënat dytësore";*

1. Titulli i Gjetjes: Mungesa e akteve rregullative për organizimin, funksionimin e brendshëm dhe mirë administrimin e bazës së të dhënave shtetërore.
Situata: Nga auditimi mbi aktet rregullative për dokumentimin dhe mirë administrimin e bazës së të dhënave doganore, rezulton se:
- DPD nuk disponon asnjë akt rregullativ të brendshëm me qëllim organizimin dhe funksionimin e brendshëm të bazës së të dhënave, në përputhje me ligjin nr.10325, datë 23.9.2010, për ñ*Bazat e të dhënave shtetërore*ò, neni 5.
- Nuk janë dokumentuar në asnjë formë të dhënat dytësore të cilat ruhen në këtë bazë të dhënash për të mirë funksionuar si dhe të dhënat apo sistemet me të cilat ndërveprohet sipas përcaktimeve në nenet 7 dhe 8 të ligjit nr.10325, datë 23.9.2010, për ñ*Bazat e të dhënave shtetërore*ò.

Kriteri: Ligji nr.10325, datë 23.9.2010, për ñBazat e të dhënave shtetëroreò, neni 5, neni 7, neni 8.
Ndikim/Efekti: Mungesë informacioni mbi mënyrën se qarkullojnë të dhënat dhe ndërveprimin e tyre me palë të treta, mungesë organizimi dhe funksionimi për përdoruesit e të dhënave parësore apo dytësore.
Shkaku: Mungesa e strukturës së brendshme për administrimin dhe mbrojtjen e të dhënave e sistemeve të informacionit, mos zbatim i ligjit nr.10325, datë 23.9.2010, për ñ*Bazat e të dhënave shtetërore*ò.

Rëndësia: E lartë
Rekomandimi: DPD si institucion përgjegjës dhe administrues i të dhënave shtetërore që gjenerohen nëpërmjet sistemit Asycuda, të dokumentojnë me një akt rregullativ të brendshëm organizimin dhe funksionimin e të dhënave shtetërore me rëndësi kritike. Gjithashtu, të evidentohen dhe dokumentohen pa përjashtim të dhënat parësore dhe dytësore me të cilat janë ndërtuar ndërveprime për ofrimin e shërbimit ndaj shtetasve.

2. Titulli i Gjetjes: Të dhënat administrohen nga specialistët e AKSHIT, në mungesë të plotë dokumentacioni dhe në kundërshtim me aktet ligjore.
Situata: Nga auditimi mbi administrimin e të dhënave shtetërore të DPD rezulton se **t**ë dhënat gjeneruar prej sistemit Asycuda nuk administrohen nga DPD, megjithëse janë detyrim i institucionit që i gjeneron ato, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr.10325, ñ*Për bazat e të dhënave shtetërore"*, neni 5, dhe VKM nr.673, datë 21.11.2017 ñ*Për riorganizimin e agjencisë kombëtare të shoqërisë së informacionit*ò pika 5/y.
Aktualisht detyrat e administrimit të të dhënave janë deleguar në mungesë të plotë dokumentacioni (verbalisht) tek specialistët e AKSHIT, për arsye se vetë DPD nuk ka asnjë pozicion dhe punonjës në strukturën e saj, për ruajtjen dhe administrimin e të dhënave.
Kriteri:
Ligji nr.10325, ñ*Për bazat e të dhënave shtetërore"*, neni 5: ñ*Rregulloret për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të bazës së të dhënave shtetërore përcaktohen nga institucioni administrues dhe miratohen nga titullari i tij, në përputhje me standardet, rregullat dhe procedurat e përcaktuara sipas nenit 10 të këtij ligji*ò
VKM nr.673,pika 5/y ñ*Regjistrat e të dhënave të këtyre institucioneve që përbëhen nga bazat e të dhënave mbeten nën administrim të institucioneve respektive*ò**.**
Ndikim/Efekti: Risk shumë i lartë i gabimeve njerëzore apo të qëllimshme me pasojë ndërprerjen e punës, cenimin e të dhënave si dhe pamundësi të identifikimit të përgjegjësit, për ndërhyrje të paautorizuar.
Shkaku: Mungesa e strukturës së brendshme për administrimin dhe mbrojtjen e të dhënave e sistemeve të informacionit, mos zbatim i ligjit nr.10325, datë 23.9.2010, për ñ*Bazat e të dhënave shtetërore*ò,
Rëndësia: E lartë
Rekomandimi: DPD si institucion përgjegjës dhe administrues i të dhënave shtetërore që gjenerohen nëpërmjet sistemit Asycuda, të marrë masa për përmbushjen e këtij detyrimi me strukturë të posaçme për administrimin dhe mbrojtjen e të dhënave, si shërbime të cilat nuk ofrohen nga AKSHI.

Për veprimet apo mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi drejtuesit e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave ndër vite, veprime të cilat janë në kundërshtim me:
- Ligjin nr.10325, ñ*Për bazat e të dhënave shtetërore"*, neni 5: ñ*Rregulloret për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të bazës së të dhënave shtetërore përcaktohen nga institucioni administrues dhe miratohen nga titullari i tij, në përputhje me standardet, rregullat dhe procedurat e përcaktuara sipas nenit 10 të këtij ligji*ò ;
- VKM nr.673,pika 5/y ñ.... *Regjistrat e të dhënave të këtyre institucioneve që përbëhen nga bazat e të dhënave mbeten nën administrim të institucioneve respektive*ò;

Deklaratat doganore që regjistrohen nga agjentët doganore marrin statusin ñRò, ndërsa pranimi i tyre ndryshon dhe statusin e deklaratës në ñPò nga punonjësi përgjegjës në pikën doganore. Pranimi i deklaratave mund të konsiderohet si autorizimi i këtij regjistrimi të kryer nga agjenti / agjencia doganore.

Hyrja e të dhënave në sistem ndodh nga disa kategori përdoruesish: Punonjësit, Biznesi dhe Agjentët Doganorë.
Në kategorinë ñPunonjësò bëjnë pjesë të gjithë punonjësit e Doganës Shqiptare;
Në kategorinë ñBiznesò bëjnë pjesë të gjithë importuesit dhe eksportuesit e mallrave të akcizës;
Në kategorinë ñAgjentët Doganorëò janë të gjithë agjentët e licencuar për kryerjen e veprimeve doganore.

Kategorisë Biznes i përkasin afërsisht 770 përdorues, të cilët importojnë, përpunojnë mallra të akcizës dhe kryejnë dy veprime në sistemin doganor Asycuda:
- Dokument Shoqërues Administrativ - Dokumenti Shoqërues Administrativ (DSHA) plotësohet në sistem nga vetë subjekti në rastet kur produkti shitet ose lëviz nga një magazinë në një tjetër.
- Ngarkimet e mallit - Ngarkimet e mallit regjistrohen si hyrje në magazinën e vetë subjektit.

Afatet dhe mënyra e plotësimit për këto të dhëna janë përcaktuar në urdhrin nr.2, datë 07.04.2015 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Nga verifikimi në pikat doganore Berat, Shëngjin, Shkodër, rezultoi se adresën e email-it të krijuar për dërgimin e kërkesave, për anulimin e DSHA e për pasojë dhe ndërprerjen e lëvizjes për mallrat e akcizës që kryejnë operatorët e akcizës, nuk e disponon askush, çfarë tregon se komunikimi i subjektit me degët doganore, për anulimin e DSHA nuk kryhet sipas përcaktimeve të Udhëzimit Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave nr.2, datë 07.04.2015 dhe nr. 8627 prot, datë 07.04.2015.
Mallrat (e importuar dhe të prodhuar brenda vendit) të cilët janë objekt akcize, nevojiten të ngarkohen nga subjekti nëpërmjet vetë deklarimit në sistemin Asycuda brenda 24 orësh. Kjo sasi malli që subjekti duhet të ngarkojë në sistem duhet të jetë e njëjtë me sasinë e mallit që përmban deklarata doganore për mallrat e importuar.

Nga auditimi rezulton se, ngarkimi i mallit është një e dhënë që nuk modifikohet, dhe me mundësi të lartë të gabimit në regjistrimin e saj. Ngarkimi i mallit rezulton një herë i regjistruar në sistem nëpërmjet deklaratës doganore nga ku mund të lexohet automatikisht pa qenë i nevojshëm vetë deklarimi i kontrolluar në hyrje.
- Gjendja e magazinës në sistemin e raportimit (Oracle) nuk është e njëjtë me gjendjen e magazinës në sistemin Asycuda për të njëjtin subjekt.
- Ngarkimet e mallit që regjistron subjekti në pika të ndryshme doganore nuk i shfaqen zyrës doganore mbikëqyrëse ku subjekti ushtron veprimtarinë.

Sipas udhëzimit, DSHA mund të anulohet për 30 minuta si në rastet kur subjekti ka regjistruar të dhëna të gabuara si psh, nuk ka zgjedhur kodin e saktë të produktit, ka hedhur gabim sasinëetj, por në asnjë rast nuk janë implementuar kontrolle të cilat mos të lejojnë veprimin të regjistrohet me një kod i cili nuk ka gjendje, apo me një sasi më shumë se sa gjendja faktike e produktit.

- Nga auditimi rezulton se ky veprim nuk e kthen magazinën e subjektit në gjendjen që ishte përpara regjistrimit të këtij veprimi, por e bën hyrje në magazinën e tij pa e shkarkuar atë sasi. Kjo sasi duhet të shkarkohej nga magazinae subjektit dërgues në momentin që subjekti pritës e ka pranuar dërgesën dhe jo që në regjistrimin e veprimit, pasi ky veprim krijon konfuzion dhe pamundësi për të patur të dhëna reale për gjendjen e subjekteve të akcizës.

Procedurat që ndiqen nga punonjësit në rastet e konstatimit të parregullsive në modulin DEMP (Dokumenti Elektronik të Magazinimit të Përkohshëm), gjenden në manualin e këtij moduli i cili udhëzon se ndryshimet mund të kryhen në dritaret ñpesha në hyrjeò/pakot në hyrjeò ku vendoset pesha/nr. i pakove faktike të konstatuara nga kontrolli. Këto ndryshime duhet të kryhen nga përgjegjësi i zyrës operacionale si në rastin me një pritës ashtu dhe në rastin me shumë pritës.

DPD nuk disponon manuale për modulet *Akciza* dhe *Borxhi*, por rezultojnë se janë manualet e përdoruesit, në modulet Tranzit, Import, Eksport, Magazinat e përkohshme, etj. Gjithashtu manual të administrimit të këtij sistemi nuk rezulton të ketë, edhe pse konsiderohet një sistem i konsoliduar i vënë në funksion prej disa vitesh.

3. Titulli i Gjetjes: Mangësi dhe parregullsi në module të ndryshme të sistemit AsycudaWorld.
Situata: Nga auditimi mbi përdorimin e moduleve të ndryshme të sistemit AsycudaWorld, u konstatuan problematika të ndryshme si:

- DPD nuk disponon manual të administrimit të sistemit AsycudaWorld si dhe për modulet *Akciza* dhe *Borxhi*.
- Pikat doganore rakordojnë me 1 javë vonesë, vetëm prej kushteve teknike dhe fizike që disponojnë, çfarë krijon pamundësi të kontrolleve dhe verifikimeve në kohë reale tek subjektet sa herë që kërkohet nga vetë ata apo nga hallkat monitoruese të DPD.
- Nuk e disponon askush adresën e email-it të krijuar për subjektet që kërkojnë anulimin e DSHA e për pasojë dhe ndërprerjen e lëvizjes për mallrat e akcizës, çfarë tregon se komunikimi i subjektit me degët doganore, për anulimin e DSHA nuk kryhet sipas përcaktimeve të Udhëzimit Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave nr.2, datë 07.04.2015, dhe nr. 8627 prot, datë 07.04.2015.
- Ngarkimi i mallit nga subjektet e akcizës është një e dhënë që nuk mund të modifikohet nga ndërfaqja pasi është regjistruar në sistem pa marrë parasysh gabimin njerëzor në këtë rast edhe pse ngarkimi i mallit rezulton një herë i regjistruar në sistem nëpërmjet deklaratës doganore nga ku mund të lexohet automatikisht pa qenë i nevojshëm vetë deklarimi i subjektit.
- Gjendja e magazinës në sistemin e raportimit (Oracle) nuk është e njëjtë me gjendjen e magazinës në sistemin Asycuda për të njëjtin subjekt.
- Ngarkimet e mallit që regjistron subjekti në pika të ndryshme doganore nuk i shfaqen zyrës doganore mbikëqyrëse ku subjekti ushtron veprimtarinë.
- Anulimi i DSHA për subjektet e akcizës nuk e kthen sasinë e produktit në magazinën e subjektit në gjendjen që ishte përpara regjistrimit të veprimit, por e bën hyrje pa e shkarkuar atë sasi. Kjo sasi duhet të shkarkohet nga magazina e subjektit dërgues në momentin që subjekti pritës e ka pranuar dërgesën dhe jo që në regjistrimin e veprimit, pasi ky veprim krijon konfuzion dhe pamundësi për të patur të dhëna reale për gjendjen e subjekteve të akcizës.
- Në modulin e dokumentit elektronik të magazinimit të përkohshëm (DEMP) rezulton se, nuk mund të ndryshohen të dhënat kur konstatohet diferencë në peshë dhe në sasi (nr. I paketimit) edhe kur këto veprime kryhen përpara mbërritjes në destinacion. Gjithashtu peshat nën 1 gram (prsh 0.8) nuk mund të mbyllen në DEMP.

Kriteri: Udhëzimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave nr.2, datë 07.04.2015 dhe nr.8627 prot, datë 07.04.2015,Manualet e administrimit dhe përdorimit të sistemit AsycudaWorld, Manuali i DEMP.
Ndikim/Efekti: Mungesa e dokumentacionit udhëzuesështëmundësi për gabim dhe mos rakordim të gjendjes reale të produkteve.

Shkaku: Mangësi të sistemit dhe të zbatimit të udhëzimeve të hartuara nga DPD.
Rëndësia: E lartë
Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse të marrë masa për testimin e situatave të konstatuara nga auditimi renditur më sipër, raportimin e tyre tek Specialistët e TIK dhe ekspertët e UNCTAD për ato raste që mund të rregullohen gjatë fazës të Upgrade, dhe evidentimin e dobësive të cilat kërkojnë më shumë kohë për zgjidhje.

II. Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Laboratorik LIMS - LaboratoryInformationManagementSystem.

Sistemi informatik është implementuar në vitin 2018 dhe mirëmbahet nga kompania zhvilluese me të cilën nuk disponojnë një kontratë mirëmbajtje 4 vjeçare. Për arsye sigurie në degë doganore janë 1 apo 2 kompjuter specifike që kanë akses në këtë sistem, pasi logimi është nëpërmjet VPN dhe vetëm në ip/port specifike të lejuara nga Sistemet e AKSHI-t.
Hapat që ndjek analizimi i mostrës janë dokumentuar në mënyrë skematike si më poshtë:

Fig 2. Workflow i sistemit LIMS



Burimi: Konceptuar dhe përpunuar nga grupi i auditimit

Skema tregon se:
1. Punonjësi i doganës merr mostrën për analizimin e saj në laboratorin LIMS, bazuar në klasifikimin që ka produkti si dhe në rastet kur produkti është vlerësuar me risk për analizim;
2. Rekordi krijohet në sistemin LIMS, nga punonjësi i degës doganore që me marrjen e mostrës;
3. Brenda 5 ditëve, punonjësi përgatit dokumentacionin shoqërues dhe mostrën për dorëzim, dokumentacion i cili është i njëjtë me atë që ka depozituar në sistemin LIMS kur ka krijuar rekordin në hapin 2;
4. Pas protokollimit të dorëzimit të mostrës, fillon puna për analizimin dhe nxjerrjen e rezultatit; Nëse dokumentacioni nuk është i njëjtë me atë që është hedhur në sistem kthehet mostra së bashku me dokumentacionin.
5. Punonjësit e LIMS, bashkëlidhin në sistem në rekordin e krijuar rezultatin e analizave;

Sistemi është parametrizuar në mënyrë të tillë që punonjësit e laboratorit të mos shohin të dhëna për subjektin që po i analizohet mostra, ndërsa punonjësit doganorë nuk shohin se kush punonjës laboratori e kryen analizën. Vetë punonjësit shprehen se ky parametrizim është ndërtuar i tillë për të ruajtur konfidencialitetin si dhe për të shmangur favorizime që mund të lindin për shkak të detyrës.

Input. Të dhëna hyrëse në këtë sistem janë:

- Data dhe koha e marrjes së mostrës;
- Arsyeja;
- Numri dhe madhësia e mostrës finale;
- Lloji i ngarkesës/partisë së mallit (me shumicë/e paketuar);
- Numri dhe lloji i paketave të ngarkesës/partisë së mallit;
- Sasia e ngarkesës/partisë së mallit;
- Procedura e përdorur për marrjen e mostrës;
- Pajisjet marrëse ndihmëse;
- Kushtet e ambientit në momentin e marrjes së mostrës;
- Kushtet e magazinimit/ruajtjes dhe transportit;
- Masat paraprake për sigurinë;
- Vulat, shenjat/shënimet dhe numrat e tyre;
- Detajet e deklaruesit (Emri, adresa numri i regjistrimit); etj;

Rezultati i analizave i bashkëlidhet rekordit në këtë sistem në trajtën e një certifikate, i cili është dokumenti që tregon nëse është e nevojshme përllogaritja e vlerësimit doganor për këtë produkt.
Me gjithë krijimin e kushteve të sigurta të përdoruesve që operojnë në këtë sistem, nga auditimi konstatohet se nuk janë ndërtuar mekanizma ndërveprimi ndërmjet sistemit periferik LIMS dhe sistemit qendror Asycuda në të cilin punonjësit e doganës janë të pajisur me çelësa të nënshkrimit elektronik dhe rekordi do të ishte lehtësisht i identifikueshëm.
Certifikata e analizimit të mostrës lëshuar nga Laboratori Doganor, pasi është marrë në rrugë shkresore nga çdo degë doganore, i dërgohet po nga dega agjencisë që ka praktikën doganore dhe subjektit. Ky komunikim vazhdon të jetë shkresor për arsye të mungesës së ndërveprimit me sistemin Asycuda edhe pse kjo ka qenë një kërkesë në specifikimet teknike të cilat duhet të ishin përmbushur nga kontraktori.

Krijimi i përdoruesve në këtë sistem kryhet nga sektori HelpDesk, e po nga ky sektor kryhet dhe monitorimi dhe vazhdimësia e kontratës me kontraktorin, ndërkohë që me hyrjen në fuqi të VKM 673,datë 21.11.2017 ñ*Për riorganizimin e agjencisë kombëtare të shoqërisë së informacionit*ò kushtet teknike për të mbajtur funksional këtë sistem duhet të suportohen nga struktura e zhvillimit nga AKSHI pranë DPD.

Në këtë sistem nuk kryhen autorizime të veprimeve, pasi në çdo rast apo kërkesë për analiza laboratorike, mostra shoqërohet me dokumentacioni fizik, i cili protokollohet paraprakisht në DPD.

Për sistemin LIMS janë dokumentuar dy manuale. Nga auditimi rezulton se DPD nuk disponon manual administrimi të këtij sistemi, por vetëm Manual përdorimi të programit LIMS dhe Manuali i përdorimit për punonjësit Doganier.

Konfigurimet të sistemit mund të bëhen në lidhje me:

- Formatin e datës;
- Gjuhën ï dy janë opsionet e gjuhës Shqip dhe Anglisht;
- Jetëgjatësinë e passwordit ï e cila caktohet me numër ditësh;

- Identifikimin sipas standardit ñ*Twofactorauthentication*ò;

Nga testimet e ndryshme të sistemit rezultoi se konfigurimet për gjuhën dhe për identifikimin me ñ*Twofactorauthentication*ò janë parametrizime të cilat nuk janë funksionale por të kërkuara në specifikimet teknike të hartuara, për këtë sistem. Nga testimet e kryera jo vetëm që këto funksionalitete nuk janë aktive, por testimi i kriterit ñTwofactorauthenticationò, bllokoi sistemin për disa orë. Këto kërkesa duhet të ishin funksionale pasi janë pjesë e kërkesave të specifikimeve teknike.

4. Titulli i Gjetjes: Mungesë ndërveprimi me sistemin AsycudaWorld
Situata:
A. Nga auditimi mbi veprimtarinë e ofruar nga sistemi LIMS rezulton se,nuk komunikon, menaxhon apo ndërvepron ndonjë palë e tretë. Ndërveprimi mungon dhe me sistemet e brendshme të DPD dhe konkretisht me atë më kryesorin AsycudaWorld kërkuar dhe në specifikimet teknike, mbështetur dhe në faktin se ky sistem suporton nënshkrimin Dixhital.
B. Nga auditimi mbi sistemin LIMS, rezulton se:

- Monitorimi dhe vazhdimësia e kontratës me kontraktuesin kryhet nga sektori HelpDesk, ndërkohë që me hyrjen në fuqi të VKM nr.673, datë 21.11.2017 ñ*Për riorganizimin e agjencisë kombëtare të shoqërisë së informacionit*ò, kushtet teknike për të mbajtur funksional këtë sistem duhet të suportohen nga struktura e zhvillimit TIK atashuar nga AKSHI;
- DPD nuk disponon manual administrimi të këtij sistemi;
- Konfigurimet për gjuhën dhe identifikimin me ñ*Twofactorauthentication*ò janë parametrizime të cilat nuk janë funksionale, kërkuar përkatësisht në pikat 11.1 dhe 11.6 të specifikimeve teknike.
- Në këtë sistem gjurma elektronike e auditimit (audittrails ose logs) mungon, çfarë është në kundërshtim me ñRregulloren për Menaxhimin e log-eve digjitale në administratën publikeò, miratuar me urdhrin nr. 109 datë 10.06. 2016 të Drejtorit të Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT) si dhe me specifikimet teknike kërkuar më shumë se një herë e më konkretisht në pikat: 4 ñAuditTrailò, 11.8 ñAdministrimi dhe monitorimi i dokumenteveò, 11.9 ñMenaxhimi i regjistrimeve dhe procedurave administrativeò.
- Nuk janë zhvilluar raporte komplekse të cilat do të mund ti shërbenin auditimit të brendshëm dhe të jashtëm mbi monitorimin e aktivitetit dhe veprimtarisë së kësaj drejtorie dhe këtij sistemi, kërkuar në pikën 11.11 ò Raporte të avancuara dhe analizë informacioniò ku një nga kërkesat është Monitorim dhe Raportim i aktivitetit në sistem (audittrails).

Kriteri: Urdhri nr. 109, datë 10.06. 2016 iDrejtorit të Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT), VKM nr.673 datë 21.11.2017 ñ*Për riorganizimin e agjencisë kombëtare të shoqërisë së informacionit*ò, dhe pikat 11.1, 11.11, 11.6 11.8, 11.9 të specifikimeve teknike, specifikimet teknike pjesë e DST të procedurës së prokurimit për sistemin LIMS, pika 11 ñKërkesat funksionaleò.
Ndikim/Efekti: Me vënien në punë të këtij sistemi nuk janë shkurtuar komunikimet me dokumentacion fizik ndërmjet pikës doganore - Laboratorit - Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.
Në këtë sistem të ndërtuar për analizimin e mostrave të produkteve të importit, mungojnë parametrizime të cilat janë kërkuar në specifikimet teknike, duke lënë mangësi të cilat nëse nuk do ti kërkohen kontraktorit, DPD do të shpenzojë të tjera fonde në të ardhmen.
Shkaku:kontraktori ne zbatimin e kontratës nuk ka zbatuar specifikimet teknike
Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: DPD të kërkojë tek kontraktorit përmbushjen e funksionaliteteve që nuk janë aktualisht funksionale, mbi:
- Import/exportin e të dhënave;
- Integrimin me sistemin AsycudaWorld me qëllim sigurimin e efektivitetit të përdorimit të sistemit LIMS pas përfundimit të kontratës së mirëmbajtjes;
- Manualin e Administrimit;
- Gjurmën elektronike të auditimit (audittrails ose logs);
- Raporte komplekse të cilat do të mund ti shërbenin auditimit të brendshëm dhe të jashtëm mbi monitorimin e aktivitetit dhe veprimtarisë së kësaj drejtorie;
- Konfigurimet për gjuhën dhe identifikimin me ñ*Twofactorauthentication*ò të cilat nuk janë funksionale;

III. Sistemi SEED - System Exchange Electronic Data

Sistemi SEED është një projekt i mbështetur dhe financuar nga Bashkimi Europian, implementuar në Shqipëri në vitin 2010, dhe qendra e tij është Bosnje-Hercegovina. Ky sistem përdoret në degët doganore kufitare me Malin e Zi, Maqedoninë dhe Kosovën.
Përdoruesit e këtij sistemi janë punonjësit doganierë të pikave kufitare. DPD nuk ka investuarasnjë vlerë monetare për implementimin, ashtu edhe për mirëmbajtjen, pasi ky projekt është financuar nga BE.
Krijimi i përdoruesve në këtë sistem menaxhohet nga një punonjëse në Sektorin e Shkëmbimit të Informacionit, ndërsa mirëmbajtja ofrohet nga operatorët që e kanë krijuar nën mbikëqyrjen e të njëjtës punonjëse.

Bazuar në *"Rregulloren e brendshme mbi detyrat dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit",* miratuar me shkresën nr. 1900 prot., datë 16.04.2020 janë përcaktuar detyrat funksionale të Sektorit të Drejtorisë TIK atashuar në DPD, të cilat janë:
- Zhvillimi i skripteve/procedurave për nevoja të shkëmbimit të të dhënave;
- Zhvillimi i vazhdueshëm i procedurave për krijimin e të dhënave të ndryshme nga sistemi AsycudaWorld në sistemin SEED;
- Pjesëmarrje aktive në projekte të ndryshme të shkëmbimit të të dhënave mes ADSH dhe Administratave të tjera doganore;
- Menaxhimi i aksesit të përdoruesve të sistemit SEED;
- Merr pjesë në projekte të ndryshme të shkëmbimit të të dhënave mes ADSH dhe Administratave Doganore të vendeve të tjera; etj.

IV. Intraneti - data connection

DPD ka të implementuar Intranet për gjithë degët doganore të cilat identifikohen të ndara nga njëra tjetra, ndërsa ofrimin e shërbimeve e sigurojnë nëpërmjet komunikimit me sistemin e qendërzuar.
Rrjeti i intranet i degëve doganore përbëhet nga dy linja data:
1. Linja data primare, ku ofrues shërbimi është kompania ñVò sha;
2. Linja data backup, ku ofrues shërbimi është kompania ñAò sha;

Nga 35 pika doganore, dy prej tyre Vermosh dhe Goricë,nuk disponojnë linjë primare. Ndërsa, linjë backup nuk disponojnë pikat: Morinë, Qafë Botë, Tre urat dhe Tiranë.

Monitorimi i statusit të linjave Up / Down realizohet nëpërmjet programit IPSWITCH WhatsupGold. Ky program është pa pagesë dhe kod te hapur (opensource), por i vjetër dhe jo lehtësisht i parametrizueshëm sipas kërkesave që vijnë nga sektorët e suportit dhe monitorimit.

Fig.3 Workflow mbi monitorimin e linjave data



Burimi: Sektori i suportit dhe Mbështetjes nga AKSHI-t në DPD

Input. Të dhëna hyrëse në këtë sistem, për secilën pikë doganore janë linjat parësore, dytësore vetëm në ato raste që disponohet, statusi që ato kanë online apo offline si dhe bandwith-i që konsumojnë secila prej tyre, gjithashtu dhe koha e ndërprerjes.
Output. Raportet që mund të gjenerohen prej këtij sistemi janë disa lloje, por konfigurime për gjenerimin e tyre nga ana e IT janë kryer vetëm në ato raste që nevojitet monitorimi i kapacitetit, konektivitetit të linjës, ndërprerjes si dhe koha e përsëritjes për çdo ndërprerje.
Autorizimi. Ky sistem nuk ka veprime të regjistruara manualisht, sepse leximi i linjës nëse është aktive apo jo, bëhet në mënyrë automatike, pra jo vetëm që nuk ka opsionin e autorizimit, por nuk është as domosdoshmëri autorizimi i veprimeve.
Përdoruesit. Përdorues të këtij sistemi janë punonjësit në sektorin Helpdesk dhe Monitorimit të DPD, si dhe sektori i AKSHI-t. Krijimi i përdoruesve në sistem është i kufizuar vetëm në nivel administratori (Admin) dhe lexuesi (Guest).
Workflow Intranet. Problemet me linjat raportohen në sektorin e suportit dhe mbështetjes nga AKSHI në DPD, nga:

- Sektori Helpdesk i DPD;
- Sektori i monitorimit të DPD;
- Me telefon direkt nga degët doganore nëpërmjet specialistëve IT të AKSHI pranë degës doganore ose nga punonjësit e degëve doganore.

Helpdesk në momentin që nga programi i monitorimit shikon se njëra nga linjat me një degë doganore ka ndërprerje, bën verifikimin e statusit të energjisë elektrike për të shmangur problemin lokal dhe më pas raporton problemin pranë AKSHI-t tek sektori i suportit dhe mbështetjes.
Specialistët e Sektorit të suportit dhe Mbështetjes e ndjekin problemin dhe e raportojnë tek ofruesi i shërbimit.

5. Titulli i Gjetjes: Monitorimi i linjave data
Situata: Nga auditimi mbi monitorimin e Intranetit, rezultoi se:
- Rruga që ndiqet për monitorimin e linjave data, nuk kryhet sipas hapave të përcaktuar në Rregulloren e Brendshme pika 4.3 ñDetyrat funksionale të Sektorit të Zgjidhjeve dhe Suportit (HelpDesk)ò.
- Nëpërmjet kësaj zgjidhje nuk monitorohet konsumimi i bandwith-it të linjës deri në nivel përdoruesi, duke mos i dhënë mundësinë Sektorit të TIK dhe vetë administratës doganore të kryejnë planifikimet e duhura për sasinë reale që çdo pike doganore i nevojitet.

Kriteri: Rregullorjae Brendshme e Doganave, pika 4.3 ñDetyrat funksionale të Sektorit të Zgjidhjeve dhe Suportit (HelpDesk)ò
Ndikim/Efekti:
Shkaku: Nuk janë zbatuar rregullat e komunikimit dhe monitorimit sipas hapave të përcaktuar në rregulloren e brendshme të DPD.
Rëndësia: E mesme
Rekomandimi: Drejtoria TIK e AKSHI-t pranë DPD të konsiderojnë dhe implementojnë zgjidhje të tjera ñopensourceò për monitorimin e linjave data për pikat doganore me qëllim monitorim më të detajuar mbi konsumin e bandwithit, çfarë do të ndihmonte DPD në një planifikim më të mirë dhe të afërt me atë kapacitet që nevojitet.

Për sa është konstatuar më lart, mbajnë përgjegjësi:
z. IM me detyrë Drejtori i Burimeve Mbështetëse sipas detyrave funksionale të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Administratës Doganore, nenet 9 dhe 63, miratuar nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë menr. 146, datë 07.05.2018.
z. ED me detyrë Drejtori i Drejtorisë TIK të Doganave sipas detyrave funksionale të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme ñMbi Detyrat dhe Funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionitò, neni 22, miratuar nga AKSHI menr. 1900, datë 16.04.2020.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar nuk është paraqitur observacion mbi Projekt raportin e Auditimit.

2.6. Verifikimi me zgjedhje i degëve doganore.

Në përmbushje të objektivave të përcaktuara në Programin e Auditimit nr. 570/1, datë 08.06.2021, grupi i auditimit kreu verifikime të çështjeve të ndryshme për teknologjinë e informacionit tek përdoruesit fundor në pikat doganore Berat, Shëngjin, Shkodër.

Me qëllim mbledhjen e një informacioni të dokumentuar u hartuan pyetësorët drejtuar përdoruesve fundor. Rezultati i pyetësorëve të hartuar nga grupi i auditimit, iû drejtua punonjësve përdorues që përdorin sistemet informatike në përmbushje të detyrave funksionale.
Nga përmbledhja e përgjigjeve rezultoi se për pyetjen ñmbi problematikat më të shpeshta që hasin gjatë punës së tyre me sistemet informatikeò, 80% e përgjigjeve janë se është shkëputja

e serverit të sistemit ASYCUDA si dhe shkëputja e internetit, saqë ky veprim konsiderohet i zakonshëm.

Nisur nga plotësimi i pyetësorëve si dhe komunikimi me agjentët doganorë në pikat doganore ku grupi i auditimit realizoi verifikimet në terren u konstatua se: vetë punonjësit e degës doganore e realizojnë ristartimin e serverit në shumicën e rasteve kur ka shkëputje të sistemit me rekomandimin e specialistëve të TIK.

Pyetjes mbi problematikatë hasura që përdoruesit e sistemit konstatojnë, 100% e tyre i janë përgjigjur se raportimin e bëjnë kryesisht nëpërmjet postës elektronike dhe duke kontaktuar me HelpDesk-un e Drejtorisë së Përgjithshme.

Grupi i auditimit konstaton se për komunikimin e problematikave në qendër përdoret telefon dhe e-mail, zgjidhja ndiqet rast pas rasti, nuk monitorohet apo dokumentohet koha dhe natyra e problematikës së konstatuar apo punonjësit që janë angazhuar për zgjidhjen e saj.
Vetë punonjësit shprehen se rakordimet ndërmjet sistemit të raportimit dhe Asycuda nuk është e mundur të kryhen në kohë reale.

Nga verifikimi në pikat doganore Berat, Shëngjin, Shkodër, rezultoi se adresën e e-mailit të krijuar sipas vendimit, nuk e disponon askush, çfarë tregon se komunikimi i subjektit me degët doganore, për anulimin e DSHA nuk kryhet sipas përcaktimeve të Udhëzimit Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave nr.2, datë 07.04.2015, dhe nr. 8627 prot, datë 07.04.2015,në të cilën operatorët e akcizës duhet të njoftonin anulimin e DSHA dhe ndërprerjen e lëvizjes për mallrat e akcizës.

Nga verifikimi në terren në Degën Doganore Shëngjin, u konstatua se nga 12 kamera në total, funksionale ishin vetëm 6 prej tyre. Kamera e lëvizshme (360°) ishte e djegur dhe e pariparuar, pra jashtë funksionit. Nga verifikimi që realizoi grupi i auditimit në sistemin SMK në këtë pikë doganore rezultoi qe vetëm një kamerë ishte funksionale siç duket dhe në fig. e mëposhtme.

Fig. 4 Foto nga vendosjes sëpajisjeve në pikat doganore






Burimi: Dega doganore Shëngjin

Nga verifikimi në këto pikat doganore Berat dhe Shëngjin grupi i auditimit konstatoi se: Ambientet e mbajtjes se serverave të Degës Doganore Berat, nuk plotësojnë kushtet teknike të përcaktuara në Rregulloren e miratuar nga AKSHI, ñPër ndërtimin e dhomës së serverëveò (versioni 1.0, datë 02.12.2008). Dhoma e serverave si vendi fizik ku ruhen dhe qëndrojnë kryesisht serverat dhe pajisje të tjera ndihmëse që nevojiten për shërbimet e komunikimit dhe ruajtjes së të dhënave është pika kryesore e sistemeve të teknologjisë së informacionit të një institucioni.
Ndërsa në Doganën e Shëngjinit, u konstatua se dhoma e serverit përdoret gjithashtu edhe për magazinim mallrash, të cilat nuk kanë lidhje me objektin e kësaj dhome.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga auditimi: Plani i veprimit dhe implementimit Strategjik Institucional nuk është realizuar sipas plan veprimeve përkatëse, prioriteteve, periudhave të implementimit nga personat përgjegjës me indikatorëve matës.
- Për objektivin ñ*Zhvillimi, implementimi dhe rishikimi i rregullt i strategjisë afatgjatë të TI-së që mbështet prioritetet e biznesit*ò ku në plan veprimin parashikohet hartimi i një strategjie afatgjatë në përputhje me nevojat e anëtarësimit në EU MASP dhe programin e punës së EU UCC, konstatohet se nuk është hartuar një strategji IT afatgjatë në përputhje me nevojat e anëtarësimit në EU MASP dhe programin e punës së EU UCC, megjithëse parashikohej të mbaronte në dhjetor të vitit 2019.
- Për objektivin ñ*Përmirësimi i TI-së në të gjitha strukturat e ndryshme hierarkike*ò ku në plan veprimin parashikohet të përcaktohen qartë rolet dhe përgjegjësitë ndërmjet AKSH-it dhe Administratës Doganore, konstatohet se nuk ka një marrëveshje të përbashkët ose rregullore ku të përcaktohen rolet dhe përgjegjësitë ndërmjet AKSH-it dhe DPD megjithëse parashikohej të mbaronte në dhjetor të vitit 2018.
- Për objektivin ñ*Implementimi i NCTS, (Sistemin e Transitin Elektronik të Përbashkët) ITMS (Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Tarifave) dhe sistemeve të tjera të IT-së së BE-së*ò ku në plan veprimin parashikohet hartimi i planeve të implementimit, përfitimi i burimeve dhe fondeve përkatës.
a. Konstatohet se nuk se nuk janë hartuar planet e implementimit me aktivitetet e parashikuar për Implementimin e NCTS, (*Sistemin e Transitit Elektronik të Përbashkët*), nuk janë identifikuar boshllëqet dhe nevojat e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, duke përfshirë rekomandime për aktivitete të mëtejshme në fushën e transportit të përbashkët/komunitar; hartimi i të gjitha ligjeve, akteve nënligjore ose dispozitave zbatuese; takime ndërgjegjësimi me tregtarët; krijimin e skemës së menaxhimit dhe mirëmbajtjen e sistemit NCTS.
b. Sistemi i ri i kompjuterizuar i tranzitit skemë që duhej të miratohej nga qeveria shqiptare, etj. nga DPD dhe AKSH-i nuk ka përfunduar megjithëse parashikohej të mbaronte në dhjetor të vitit 2020.
c. Gjithashtu konstatohet se nuk janë hartuar planet e implementimit me aktivitetet e parashikuar për Implementimin e ITMS (*Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Tarifave*), ku përmes këtij Projekti, duhet të hartohej legjislacioni, manualet dhe udhëzimet e reja në përputhje me standardet e BE-së për tarifat, trajnimet përkatëse si dhe të sistemeve të tjera të IT-së së BE-së nga DPD dhe AKSH-i megjithëse parashikohej të mbaronte në dhjetor të vitit 2020.
- Për objektivin ñ*Prezantim i një mjedisi të plotë pa letër*ò në plan veprimin parashikohet përmirësimi i sistemit ekzistues ASYCUDA në versionin më të fundit të disponueshëm, zhvillimi i një ndërfaqe ndërmjet sistemit tranzit dhe deklarimit, dhe përcaktohen qartë rolet dhe përgjegjësitë ndërmjet AKSH-it dhe DPD, konstatohet se nuk janë respektuar afatet e mbarimit nga DPD dhe AKSH-i sipas plan veprimit por rezulton se janë në proces realizimi.
Pra konstatohet se Teknologjia e Informacionit zhvillohet pa një Plan Strategjik, nuk janë hartuar planet e implementimit me aktivitetet e parashikuara në strategji bazuar në ñ*Strategjia e Biznesit e Administratës Doganore shqiptare 2018-2021*ò, praktikat më të mira, planin e veprimit dhe implementimit Strategjik Institucional.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 11-26 të RaportitPërfundimtar të Auditimit)

1.1 <u>Rekomandimi:</u>DPD në bashkëpunim me AKSHI-n, të marrë masa për hartimin dhe konkretizimin e Planit të veprimit dhe implementimit Strategjik Institucional për objektivat e

planit strategjik institucional ñ*Strategjia e Biznesit e Administratës Doganore shqiptare 2018-2021*ò, implementimi i NCTS, ITMS dhe sistemeve të tjera të IT-së së BE-së në përputhje me nevojat e anëtarësimit në BE, EU MASP dhe programin e punës së EU UCC.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Objektivat e Strategjisë Ndërsektoriale të AxhendësDixhitale të Shqipërisë për periudhën 2015-2020 miratuar nga KM nuk janë të përfshira në strategjinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Plan veprimi i strategjisë i AKSHI-t ku janë përcaktuar prioritetet strategjike ndërsektoriale të AxhendësDixhitale të Shqipërisë për periudhën 2015-2020 nuk është përfshirë në plan veprimin e strategjisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

a. Konsolidimi i infrastrukturës dixhitale në Administratën Publike për;

- **Rritjen e sigurisë** përmes krijimit të Qendrës së Vazhdueshmërisë së Punës ñ*BusinessContinuity Center dhe Backup*ò për Sistemet Qeveritare dhe ñ*Qendrës së Rikuperimit nga Fatkeqësia*ò (DisasterRecovery Center ï DRC)ò për Sistemet Qeveritare; Ky aktivitet synon përmirësimin dhe forcimin e kapaciteteve të infrastrukturës aktuale TIK, (*shërbime dhe informacion*).

Objektivi i kësaj strategjie gjithashtu nuk është përfshirë në strategjinë e DPD.

DPD nuk disponon një infrastrukturë për vazhdueshmërinë e punës BCC (*BusinessContinuity Center)* për sigurinë e ruajtjes së të dhënave në rastet e dështimit të qendrës së të dhënave primare.

Nuk ka një plan vazhdimësie (BCP) si dhe plan rimëkëmbje nga katastrofat (DRC) për garantimin e vazhdimësisë së ofrimit të shërbimit. Duke mos caktuar kështu personat përgjegjës për të siguruar vazhdimësinë e ofrimit të shërbimit, si dhe nuk janë identifikuar dhe ndarë sipas rëndësisë të dhënat kritike, sistemet, operacionet dhe burimet.

- **Një objektiv tjetër** (6) është ñ*Për Rrjete e Sisteme informacioni të sigurtë*ò.

Zhvillimi i Qeverisjes Elektronike, Administratës Dixhitale dhe Ekonomisë Dixhitale nuk mund të bëhet pa pasur një garanci efektive mbi sigurinë e rrjeteve të informacionit.

Objektivi i kësaj strategjie gjithashtu nuk është përfshirë në strategjinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

b. Në funksion të strategjisë nga AKSHI është hartuar Plan veprimi i strategjisë AxhendaDixhitale e Shqipërisë 2015-2020 ku si Prioriteti Strategjik 2 është përcaktuar: ñ*Politika për zhvillimin e infrastrukturës TIK dhe komunikimeve elektronike në të gjithë sektorët*ò:

1. Ndërtimi i Qendrës së Vazhdueshmërisë së Punës ñ*BusinessContinuity Center dhe Backup*ò për Sistemet Qeveritare. Me afat implementimi 2015-2017.
2. Ndërtimi i ñ*Qendrës së Rikuperimit nga Fatkeqësia*ò (DisasterRecovery Center ï DRC)ò për Sistemet Qeveritare. Me afat implementimi 2015-2017.

Ky plan veprimi i AKSHI-t ku janë përcaktuar prioritetet strategjike të AxhendësDixhitale të Shqipërisë për periudhën 2015-2020 nuk është përfshirë në plan veprimin e strategjisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Pra konstatohet se Teknologjia e Informacionit zhvillohet pa një Plan Strategjik. Gjithashtu nuk janë përfshirë në strategjinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave objektivat dhe nuk janë hartuar planet e implementimit me aktivitetet e parashikuara në strategji bazuar në ñ*Strategjia Ndërsektoriale e AxhendësDixhitale të Shqipërisë për periudhën 2015-2020.*

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 11-26 të Raportit të Auditimit)

2.1 Rekomandimi:
Nga DPD, AKSHI të merren masat për përfshirjen në strategjinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, të Objektivave e Strategjisë Ndërsektoriale e AxhendësDixhitale të Shqipërisë për periudhën 2015-2020.
- Nga DPD, AKSHI të merren masat për rritjen e sigurisë në infrastrukturën kritike të teknologjisë së informacionit dhe zbatimin e kërkesave të larta teknike për bazat e të dhënave shtetërore etj.
- DPD në bashkëpunim me Drejtorinë e TIK të Doganave, të marrë masa për hartimin dhe konkretizimin e Planit të veprimit dhe implementimit Strategjik Institucional për objektivat e planit të strategjisë ndërsektoriale të AxhendësDixhitale të Shqipërisë për periudhën 2015-2020.
- Të merren masat për rritjen e sigurisë përmes krijimit të Qendrës së Vazhdueshmërisë së Punës ñ*BusinessContinuity Center dhe Backup*ò për Sistemet Qeveritare dhe ñ*Qendrës së Rikuperimit nga Fatkeqësia*ò (DisasterRecovery Center ï DRC)ò për Sistemet Qeveritare:
1. Ndërtimi i Qendrës së Vazhdueshmërisë së Punës "BusinessContinuity Center dhe Backup" për Sistemet Qeveritare.
2. Ndërtimi i "Qendrës së Rikuperimit nga Fatkeqësia" (DisasterRecovery Center – DRC)" për Sistemet Qeveritare.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Objektivat (3) e Strategjisë për Menaxhimin e Financave Publike Shqipëri 2019-2022, ñ*Përmirësim i efikasitetit për mbledhjen e të ardhurave i cili do të sjellë më shumë qëndrueshmëri për financimin e buxhetit në nivelet e qeverisë qendrore dhe vendor*eò nuk janë të përfshira në strategjinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.
Plan veprimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE), Strategjia për Menaxhimin e Financave Publike Shqipëri 2019-2022 ku janë përcaktuar masat për realizimin e objektivave specifike sipas komponentëve dhe treguesit e performancës ku institucioni udhëheqës është DPD nuk është përfshirë në plan veprimin e strategjisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.
- Një nga komponentët e rëndësishëm të objekti specifik (3.3) është Menaxhimi Doganor ku si objektiv ka ñ*Mbrojtja e interesave financiare dhe ekonomike të Shqipërisë; kontributi për sigurinë e shoqërisë; lehtësimi i tregtisë; dhe bashkëpunimi me të gjithë aktorët e nevojshëm në nivel kombëtar ose ndërkombëtar*ò.
Në këtë kontekst rrëndësi merr sidomos përafrimi i kuadrit rregullator të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (DPD) me acquis të BE-së, përmirësimi i ofrimit të shërbimit ndaj klientit me procesin e ri-inxhinierimit si procedurat e thjeshtuara, kontrollet e reja të sigurisë sipas profilit të operatorëve dhe futjes së menaxhimit doganor elektronik për të lehtësuar procesin e përputhshmërisë.
Në këtë fushë në strategji konstatohet se mbeten ende mangësi (sistemi TIK) si:
• *Pak ecuri është bërë në drejtim të përdorimit proaktiv të njoftimeve elektronike për ngarkesat që mund të kenë rrezik të lartë shkeljeje;*
• *Prezantimin e një garancie të vetme për të gjithë llojet e transaksioneve dhe regjimeve që është në varësi të ngritjes së sistemit TI, i cili është vonuar;*
• *Gjithashtu, vonesa ka pasur kontraktimi i ITMS-së nga DPD-ja për t'u pajtuar me BE-ITMS.*

- Sipas Kapitullit 3 ñ*Qeverisja dhe koordinimi*ò kjo strategji angazhon të gjithë sektorin publik dhe përgjegjësia e përgjithshme për një zbatim të suksesshëm të strategjisë është një përgjegjësi që ndahet mes të gjithë këtyre aktorëve në sektorin publik. (DPD).

Reformat e TI-së (3.8) që janë planifikuar brenda Objektivit Specifik përkatës përfshijnë aktivitete të rëndësishme që kanë si qëllim përmirësimin dhe integrimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit (TI-së).
Disa nga komponentët dhe masat brenda strategjisë (reforma e TI-së) janë:
• *Zhvillimi dhe mirëmbajtja e një sistemi gjithëpërfshirës për menaxhimin e riskut (DPD)*
• *Zgjerimi/rritja e përdorimit të SIFQ (Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë) dhe Integrimi i SIMBNJ (Sistemi Informatik i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore) dhe krijimi i interfaces (ndërlidhje) me doganat.*
Objektivat e mësipërm të Strategjisë për Menaxhimin e Financave Publike Shqipëri 2019-2022, nuk janë të përfshira në strategjinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

- Konstatohet se nga DPD dhe AKSH-i nuk janë hartuar planet e implementimit me aktivitetet e parashikuar për Implementimin e ITMS (*Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Tarifave*) ku përmes këtij Projekti, duhet të hartohej legjislacioni, manualet dhe udhëzimet e reja në përputhje me standardet e BE-së për Tarifat si dhe trajnimet përkatëse si dhe sistemeve të tjera të IT-së së BE-së megjithëse parashikohej të mbaronte në dhjetor të vitit 2020.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 11-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1 Rekomandimi:
- Nga DPD, AKSHI të merren masat për përfshirjen në strategjinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Objektivat e Strategjisë për Menaxhimin e Financave Publike Shqipëri 2019-2022
- Nga DPD, AKSHI të merren masat për hartimin e plan veprimit për realizimin e objektivave specifike sipas komponentëve për menaxhimin e doganave dhe masat për përmirësimin e mëtejshëm të sistemeve dhe platformave të TI-së dhe treguesit e performancës:
- *Zhvillimi, zbatimi dhe rishikimi i rregullt i strategjisë afatgjatë të TI që mbështet përparësitë e biznesit.*
- *Përmirësimi i organizimit dhe menaxhimit të TI.*
- *Implementimin e NCTS, ITEMS dhe sistemeve të tjera të TI të BE-së.*

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Dokumenti i politikave për sigurinë kibernetike 2015 ï 2017 nuk është përfshira në Strategjinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave qëllimi i të cilit është të rishikojë dhe të koordinojë detyrimet që lindin nga angazhimet e marra për një hapësirë kibernetike të sigurt me qëllim që të sigurohet përmbushja e përgjegjësive nga të gjithë aktorët në mënyrë të koordinuar.

Gjithashtu nuk është përfshirë në plan veprimin e strategjisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave ku të përcaktohen masat për realizimin e objektivave specifike sipas komponentëve dhe treguesit e performancës.
A. Në dokumentin e politikave janë përcaktuar **objektivat strategjike** që duhet të ndiqen për përmbushjen e vizionit dhe respektimin e parimeve bazë të cilat **nuk janë përfshirë në planveprimin e strategjisë** së Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe AKSHI-t si:
- Plotësimi i kuadrit ligjor në fushën e sigurisë kibernetike.
a- Futja përdorimi sa më i gjerë i certifikatave për faqe interneti dhe web servera për të garantuar identitetin e sigurt të faqeve të institucioneve publike .
b-Detyrimi i kryerjes së auditimit periodik dhe vlerësimit të përshtatshmërisë dhe efektivitetit të sigurisë së sistemeve të informacionit në përputhje me bazën ligjore dhe rregullatorë në

fuqi. Kjo, për të plotësuar legjislacionin aktualisht në fuqi që parashikon auditimin e databazave shtetërore duke lënë jashtë spektrit të veprimit sistemet në tërësi.
- Forcimi i kuadrit institucional.
a- Vlerësimi i krijimit të strukturave të nevojshme respektive pranë institucioneve të tjera të administratës publike, ku Forcimi dhe mbështetja për rritjen e kapaciteteve në fushën e sigurisë kibernetike do jetë një proces i vazhdueshëm në mënyrë që shteti të shërbejë si model në sigurinë kibernetike.
- Rritja e ndërgjegjësimit për sigurinë kibernetike.
- *Shpërndarja dhe publikimi i informacionit mbi rreziqet e hapësirës kibernetike*, nxjerrja e udhëzimeve dhe këshillave për një siguri minimale do jetë një proces i vazhdueshëm nëpërmjet të cilit do synohet të rritet ndërgjegjësimi dhe siguria e përdoruesve të thjeshtë. Përveç publikimit të tyre në faqet zyrtare të internetit të institucioneve të specializuara do bashkëpunohet në mënyrë të ngushtë me median për të siguruar një informim sa më të gjerë dhe të shpejtë të publikut.

B. Në dokumentin e politikave janë përcaktuar objektivat strategjike që duhet të ndiqen për përmbushjen e vizionit dhe respektimin e parimeve bazë të cilat **nuk janë përfshirë në plan veprimin e strategjisë** së Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe AKSHI-t si:
- Identifikimi dhe mbrojtja e Infrastrukturave Kritike të Informacionit në Shqipëri.
a. Krijimi i procedurave dhe proceseve të nevojshme për identifikimin, inventarizimin dhe garantimin e sigurisë të tyre.
b. Përcaktimi i bazës rregullative mbi të cilën operatorët e infrastrukturave kritike do të duhet të raportojnë mbi incidentet e rënda kibernetike.
- Krijimi dhe implementimi i kërkesave minimale të sigurisë kibernetike.
a. Standarde, udhëzime dhe procedura të bazuara në praktikat më të mira ndërkombëtare duhet të përshtaten dhe miratohen për tâu zbatuar në administratën shtetërore.
b. Krijimi dhe miratimi i procedurave të analizës të rrezikut të sigurisë për sistemet e përdorura dhe shërbimet elektronike të ofruara nga institucionet është prioritet. Analiza e rrezikut të jetë një proces i vazhdueshëm dhe të kryhet në mënyrë periodike.
c. Do të ngrihen BCC (*BusinessContinuity Center*) dhe DRC (*DisasterRecovery Center*) për rrjetet/sistemet shtetërore.
d. Të ngrihet një sistem monitorimi, i cili do tâi njoftonte në kohë institucionet për rreziqet kibernetike që u kanosen duke monitoruar 24\7 nyjet më të rëndësishme, trafikun dhe eventet që ndodhin në sistem për të mundësuar edhe nxjerrjen e konkluzioneve nga log-et që ruhen, pa ndërhyrë apo monitoruar përmbajtjen.
- Forcimi i partneritetit me struktura të tjera përgjegjëse të fushës brenda dhe jashtë vendit.
a. Rritja e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet institucioneve shtetërore do të forcohet për të garantuar ndërveprimin dhe koordinimin në forcimin e sigurisë dhe minimizimin e dëmeve nga sulmet kibernetike.
- Rritja e nivelit të njohurive, aftësive dhe kapaciteteve për ekspertizë në fushën e sigurisë kibernetike.
Të realizohen aktivitete me qëllim ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore të nevojshme në fushën e sigurisë kibernetike.
a. Në kuadër të forcimit të institucioneve, të rriten kapacitetet teknike të burimeve njerëzore. Kjo do të bëhet përmes programeve të zgjedhura të trajnimeve të cilat do të synojnë aftësimin e pjesëmarrësve në parandalimin e sulmeve, minimizimin e dëmeve, dhënien e përgjigjes efektive ndaj incidenteve të sigurisë së informacionit.
b. Pjesëmarrja aktive në konferenca ndërkombëtare, takime, seminare dhe ushtrime që kanë të bëjnë me sigurinë kibernetike. Shkëmbimi i informacioneve, analizave, eksperiencave, krijimi i projekteve të përbashkëta, vlerësimi i teknologjive dhe sistemeve të sigurisë shihen

jo vetëm si një mundësi për rritjen e sigurisë kibernetike në institucionet publike, por dhe si një investim për zhvillimin dhe rritjen e kapaciteteve të brezave pasardhës.

Konstatohet se nga DPD nuk janë marrë masat e nevojshme për hartimin dhe konkretizimin e planit të objektivave strategjike sipas komponentëve për dokumentin e politikave për sigurinë kibernetike 2015 ï 2017.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 11-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1 <u>Rekomandimi:</u>
- Nga DPD, AKSHI të merren masat për përfshirjen në strategjinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të objektivave strategjike sipas komponentëve për dokumentin e politikave për sigurinë kibernetike 2015 ï 2017.
- Gjithashtu nga DPD, AKSHI të merren masat për hartimin e plan veprimit për implementimin e objektivave strategjike sipas komponentëve për dokumentin e politikave për sigurinë kibernetike 2015 ï 2017 si:
- Plotësimi i kuadrit ligjor në fushën e sigurisë kibernetike.
- Forcimi i kuadrit institucional.
- Rritja e ndërgjegjësimit për sigurinë kibernetike.
- Identifikimi dhe mbrojtja e Infrastrukturave Kritike të Informacionit në Shqipëri.
- Krijimi dhe implementimi i kërkesave minimale të sigurisë kibernetike.
- Forcimi i partneritetit me struktura të tjera përgjegjëse të fushës brenda dhe jashtë vendit
- Rritja e nivelit të njohurive, aftësive dhe kapaciteteve për ekspertizë në fushën e sigurisë kibernetike.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Operatori i infrastrukturës kritike të informacionit; DPD, AKSHI, nuk kanë marrë masa sigurie për rritjen e sigurisë së informacionit në sistemin kritik ñ*Sistemi i Automatizuar i të Dhënave Doganore*ò, nuk ka përcaktuar, pikën e kontaktit, person përgjegjës AKCESK.
- Në listën e infrastrukturës kritike të informacionit në sektorin qeveritar është përfshirë operatori administrues DPD, AKSHI, me sistemin kritik ñ*Sistemi i Automatizuar i të Dhënave Doganor*eò i cili ***<u>nuk ka përcaktuar, pikën e kontaktit, person përgjegjës</u>*** për infrastrukturat kritike dhe të rëndësishme të informacionit, dhe t'ia komunikojnë Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike.
Sa konstatuar më lart është në kundërshtim me VKM nr. 553, datë 15.07.2020 ñ*Për miratimin e listës së infrastrukturës kritike të informacionit dhe listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit*ò.
- Operatori i infrastrukturës kritike të informacionit; DPD, AKSHI, <u>nuk kanë marrë masa sigurie për rritjen e sigurisë së informacionit</u> në sistemin kritik ñ*Sistemi i Automatizuar i të Dhënave Doganor*eò nuk i kanë zbatuar dhe nuk kanë dokumentuar zbatimin e tyre.
Mos marrja e masave të sigurisë cenon sigurinë e informacionit në sistemet e informacionit dhe disponueshmërinë e besueshmërinë e shërbimeve në sistemin kritik ñ*Sistemi i Automatizuar i të Dhënave Doganor*eò.
.Sa më lart është në kundërshtim me ligjin nr.2, datë 26.01.2017 ñ*Për sigurinë kibernetike*ò Neni 8, ñ<u>Masat e sigurisë</u>ò, VKM nr. 553, datë 15.07.2020 ñ*Për miratimin e listës së infrastrukturës kritike të informacionit dhe listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit*ò, pika 3 dhe 4.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 11-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1 Rekomandimi:
- Nga DPD në bashkëpunim me AKSHI-n të marren masat e nevojshme për përcaktimin e pikës - Nga DPD në bashkëpunim me AKSHI-n të merren masat e nevojshme për përcaktimin e pikës së kontaktit, personin përgjegjës për infrastrukturat kritike dhe të rëndësishme të informacionitñ*Sistemi i Automatizuar i të Dhënave Doganor*eòdhe t'ia komunikojnë Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike.
- Nga operatori i infrastrukturës kritike të informacionit, DPD, AKSHI, të merren marren masa sigurie për rritjen e sigurisë së informacionit në sistemin kritik ñ*Sistemi i Automatizuar i të Dhënave Doganor*eò duke i zbatuar dhe dokumentuar zbatimin e tyre.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se DPD nuk disponon procedura për inicimin, rishikimin dhe aprovimin e ndryshimeve, klasifikimin e tyre sipas rëndësisë, ndarjen e detyrave dhe përgjegjësive për kryerjen e ndryshimeve.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 26-29 të RaportitPërfundimtar të Auditimit)

6.1 Rekomandimi: Drejtoria së Përgjithshme të Doganave të marrin masat e nevojshme për hartimin e procedurave për inicimin, rishikimin dhe aprovimin e ndryshimeve, klasifikimin e tyre sipas rëndësisë, ndarjen e detyrave dhe përgjegjësive për kryerjen e ndryshimeve.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se DPD nuk ka analizuar, identifikuar dhe planifikuar nevojat për trajnim të punonjësve për Sigurinë e Informacionit, në përmbushje të nevojave të përgjithshme dhe specifike që ndihmojnë në mbarëvajtjen dhe funksionimin e veprimeve dhe procedurave të këtij institucioni.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 26-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1 Rekomandimi: DPD të hartojë plane për zhvillimin e trajnimeve në lidhje me sigurinë e informacionit në përmbushje të nevojave të përgjithshme dhe specifike që ndihmojnë në mbarëvajtjen dhe funksionimin e veprimeve dhe procedurave të këtij institucioni.

Mars 2022

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se DPD nuk ka akte rregullatore të miratuara, e përkatësisht:
- Rregullore mbi mbarëvajtjen dhe mënyrën e dokumentimit të masave të sigurisë;
- Rregullore për kategoritë e incidenteve kibernetike si dhe formatin dhe elementët e raportimit;
- Rregullore për administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike;
- Rregullore për menaxhimin e Firewall;

Rregullore për menaxhimin e log-eve digjitale në administratën publike.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 26-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1 Rekomandimi: DPD të marrë masat e nevojshme për hartimin dhe miratimin e:
- Rregullore mbi mbarëvajtjen dhe mënyrën e dokumentimit të masave të sigurisë;
- Rregullore për kategoritë e incidenteve kibernetike si dhe formatin dhe elementët e raportimit;
- Rregullore për administrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterike;
- Rregullore për menaxhimin e Firewall;

- Rregullore për menaxhimin e log-eve digjitale në administratën publike.

Mars 2022

9. Gjetje nga auditimi: Kontrata nr. 20069, datë 06.09.2017, me objekt ñ*Blerje, instalim dhe vënie në funksion të Software të LIMS*ò, nuk ka të parashikuar marrëveshje kontraktuale mbi nivelin e shërbimit për sistemin LIMS si dhe nuk është parashikuar dhe hartuar një marrëveshje e nivelit të shërbimit.
A. Midis Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe kontraktorit ñJSò sh.p.k, është lidhur kontrata nr. 20069, datë 06.09.2017, me objekt ñ*Blerje, instalim dhe vënie në funksion të Software të LIMS*ò, me vlerë 3.270.000 lekë me TVSH. Afati i ekzekutimit të kësaj kontratë është 90 ditë nga dita e nënshkrimit dhe do të përmbushet me furnizimin e ñ*Software të LIMS*ò të kërkuar nga Autoriteti Kontraktues, konform aneks kontratës si dhe grafikut të lëvrimit të paraqitur nga kjo shoqëri.
Në kontratë mirëmbajtja është specifikuar vetëm tek formulari i ofertës që do të bëhet për 4 vjet dhe e gjithë vlera bashkë me blerjen është vendosur në total tek çmimi i kontratës për objekt blerje, instalimi dhe vënie në funksion.
Kjo kontratë nuk ka të parashikuar marrëveshje kontraktuale mbi nivelin e shërbimit për sistemin LIMS si dhe nuk është parashikuar dhe hartuar një marrëveshje e nivelit të shërbimit, ku të përcaktohen parametrat dhe niveli i ofrimit të shërbimit si p.sh. orët/nivelet e suportit/përgjegjësitë/kufizimet, etj.
Sa më lart konstatohet, është në kundërshtim me, VKM nr. 710, datë 21.08.2013 ñ*Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit"* i ndryshuar, pika 2, 2a dhe Udhëzimin e Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike nr. 1159, datë 17.03.2014 ñ*Për hartimin e marrëveshjes së nivelit të shërbimit*ò, pika 1 si dhe pika 6.
B.Gjithashtu *konstatohet se, sistemi LIMS nuk ka kaluar në administrim dhe inventar të AKSHI-t dhe marrëveshja e shërbimit me OE nuk ka reflektuar ndryshimet përkatëse për kalimin e shërbimit tek AKSHI*kjo në kundërshtim me VKM nr. 673, datë 22.11.2017 ñ*Për riorganizimin e agjencisë kombëtare të shoqërisë së informacionit*ò, i ndryshuar, neni 18 dhe neni 19.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 29-38 të RaportitPërfundimtar të Auditimit)

9.1 Rekomandimi:
Nga DPD në bashkëpunim me AKSHI-n të merren masat e nevojshme për të kaluar në administrim dhe inventar të AKSHI-t sistemin, ñ*LIMS*ò, së bashku me të drejtat dhe detyrimet juridiko-civilepërkatëse duke përcaktuar përgjegjësisë dhe detyrimet për shërbimin e mirëmbajtjes të këtij sistemi dhe infrastrukturës TIK.

Në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Kontrata, me objekt ñ*Dixhitalizimi i shërbimeve doganore*ò është lidhur nga AKSHI në cilësinë e autoritetit kontraktor me përfitues shërbimi DPD, në një kohë kur AKSHI organizon, kryen prokurimet e përqendruara për pajisjet TIK, por nuk lidh kontrata si dhe nuk është parashikuar dhe hartuar një marrëveshje e nivelit të shërbimit, ku të përcaktohen parametrat dhe niveli i ofrimit të shërbimit.
A. Midis AKSHI-t në cilësinë e Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit BO ñSò SHPK dhe ñHò SHPK, është lidhur kontrata nr. 4700, datë 24.09.2020, me objekt ñ*Dixhitalizimi i shërbimeve doganore*ò me përfitues shërbimi Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, me vlerë 100.295.999 lekë me TVSh, përkatësisht 62.495.999 lekë për implementimin dhe

37.800.000 lekë mirëmbajtje. Sipas kushteve të veçanta të kontratës neni 1, janë përcaktuar si:

-***Autoriteti Kontraktor*** *është Agjencia Kombëtare e Shoqërisë të Informacionit.*
- ***Kontraktuesi*** *është BO "H" SHPK & "S" SHPK.*
- ***Përfituesi i shërbimit*** *është DPD.*

Sipas kushteve të përgjithshme të kontratës baza ligjore e cituar për hartimin e kësaj kontrate është ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 ñ*Për prokurimin publik*ò, Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, Kreu II, pika 5/j dhe VKM nr. 673, datë 22.11.2017 ñ*Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit*ò.

Kjo kontratë është firmosur nga AKSHI në cilësinë e Autoritetit Kontraktor <u>në një kohë kur AKSHI organizon, kryen prokurimet e përqendruara për pajisjet TIK, për institucionet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave dhe nuk lidh kontrata</u>.

Sa më lart nënshkrimi i kontratës është në kundërshtim me VKM nr. 673, datë 22.11.2017 ñ*Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit*ò, Kreu II, pika 5, germa j, i ndryshuar me VKM nr. 872, datë 24.12.2019 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 673, datë 22.11.2017, të KM, "*Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit*", të ndryshuar, ku në Kreun II, janë bërë ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:..ii. <u>Në shkronjën ñjò, fjalët ñ*lidh kontrata*ò, hiqenò.</u>

B. Nga auditimi i kontratës së mësipërme rezulton se nuk ka të parashikuar marrëveshje kontraktuale mbi nivelin e shërbimit për sistemin ñ*Dixhitalizimi i shërbimeve doganore*ò në vlerën 37,800,000 si dhe nuk është parashikuar dhe hartuar një marrëveshje e nivelit të shërbimit, ku të përcaktohen parametrat dhe niveli i ofrimit të shërbimit si psh. orët/nivelet e suportit/përgjegjësitë/kufizimet, etj.

Kjo në kundërshtim me, VKM nr. 710, datë 21.08.2013 ñ*Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit"* i ndryshuar, pika 2, 2a, dhe Udhëzimin e Ministri të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike (MIAP) nr. 1159, datë 17.03.2014 ñ*Për hartimin e marrëveshjes së nivelit të shërbimit*ò, pika 1 dhe pika 6.

C. Konstatohet se sistemi, ñ*Dixhitalizimi i Sistemit Doganor*ò deri 31.12.2020 nuk ka kaluar në administrim dhe inventar të AKSHI-t pasi nuk ka mbaruar implementimi, gjithashtu nuk ka një marrëveshje shërbimi me kontraktorin dhe nuk ka një marrëveshje ku të jenë reflektuar ndryshimet përkatëse për kalimin e shërbimit tek AKSHI, në kundërshtim me VKM nr. 673, datë 22.11.2017 ñ*Për riorganizimin e agjencisë kombëtare të shoqërisë së informacionit"*, i ndryshuar, neni 18 dhe neni 19.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 29-38 të Raportit të Auditimit)

10.1 <u>Rekomandimi:</u>

DPD në bashkëpunim me AKSHI-n të marrë masat e nevojshme përhartimin e një marrëveshje të nivelit të shërbimit, për sistemin ñ*Dixhitalizimi i shërbimeve doganore*ò ku të përcaktohen parametrat dhe niveli i ofrimit të shërbimit.

- DPD në bashkëpunim me AKSHI-n të marrë masat e nevojshme për të kaluar në administrim dhe inventar të AKSHI-t pas implementimit sistemin, ñ*Dixhitalizimi i Sistemit Doganor*ò, së bashku me të drejtat dhe detyrimet juridiko-civile përkatëse duke përcaktuar përgjegjësisë dhe detyrimet për shërbimin e mirëmbajtjes të këtij sistemi dhe infrastrukturës TIK.

Në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Inventari i Aktive Afatgjata Materiale (AAM) të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, llogaria 213 ñ*Rrjetet dhe sistemet*ò paraqitet në vlerën 264,765,083 lekë të cilat në analizë nuk pasqyrojnë vlerën e saktë të këtyre aktiveve.

- Në inventarin e AAM të DPD, janë pasqyruar ñ*Rrjetet dhe sistemet*ò, në vlerën 264,765,083 lekë, ku vlera bruto e sistemit ñASYCUDAò deri 31.12.2020 në total është 102,309,224 lekë kur në fakt duhej të ishte 150,160,248 lekë. (*Përfshirë tre zërat: Sistemi AsycudaWorld IT, në vlerën 102,309,224 lekë, Moduli i Akcizës IT, në vlerën 32,566,784 lekë, Moduli Protip për Tranzitin Kosovë –Al, në vlerën 15,284,240 lekë, të cilat janë në përbërje të një sistemi*). Pra nuk duhet të janë të veçuara si zë më vete në inventar, pasi janë pjesë e Sistemit Asycuda Word IT.
Gjithashtu, ñ*Mirëmbajte Pasje Laboratori – TVSh*ò në vlerën 806,190 lekë, ñ*Suport për Firewall për IT*ò në vlerën 8,474,355 lekë, ñ*Asistence Teknike për Administratën. Doganore IT*ò në vlerën 569,600 lekë, nuk janë AAM por shpenzime operative dhe nuk mund të jenë në inventarin e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara në DPD.
Këto aktive nuk kanë kaluar nën administrimin dhe inventarin e AKSHI-t së bashku me të drejtat dhe detyrimet juridiko-civile përkatëse.
Mos paraqitja në vlerën e saktë e inventarit të aktiveve të llogarisë 213 ñ*rrjetet dhe sistemet*ò si dhe mos kalimi i këtyre aktive nën administrimin dhe inventarin e AKSHI-t së bashku me të drejtat dhe detyrimet juridiko-civile përkatëse ka sjellë mos përcaktimin e përgjegjësisë dhe detyrimet për shërbimin e mirëmbajtjes së këtyre sistemeve dhe infrastrukturës TIK .
Për sa më lart është në kundërshtim me VKM nr. 673, datë 22.11.2017 *"Për riorganizimin e agjencisë kombëtare të shoqërisë së informacionit",* dispozita kalimtare, pika 18.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 29-38 të Raportit të Auditimit)

11.1 <u>Rekomandimi</u>:DPD të marrë masat e nevojshme për paraqitjen në vlerën e saktë të inventarit të aktiveve të llogarisë 213 ñ*Rrjetet dhe sistemet*ò si dhe kalimi i këtyre aktive nën administrimin dhe inventarin e AKSHI-t së bashku me të drejtat dhe detyrimet juridiko-civile përkatëse duke përcaktuar përgjegjësisë dhe detyrimet për shërbimin e mirëmbajtjes së këtyre sistemeve dhe infrastrukturës TIK .

Në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi:Në zbatim të VKM nr. 673, datë 22.11.2017 ñ*Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit*ò, <u>lloji dhe niveli i shërbimeve TIK që i ofrohen nga AKSHI, Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave kryhen në mungesë të një marrëveshje midis palëve</u>.
- Nga auditimi rezulton se të drejtat dhe detyrimet e ndërsjellat midis DPD dhe AKSHI-t, nuk janë të rregulluara dhe përcaktuara me një marrëveshje të nënshkruar nga palët, me qëllim përcaktimin e llojit dhe nivelit të shërbimeve që i ofrohen nga AKSHI Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave sipas VKM nr. 673, datë 22.11.2017 ñ*Për riorganizimin e agjencisë kombëtare të shoqërisë së informacionit*ò, pika 5/gj, 6/dh.
Nga Drejtoria e TIK e Doganave e AKSHI-t atashuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave është hartuar një ñ*Draft Marrëveshja Operacionale Bashkëpunimi ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit*ñ e pa firmosur. Në këtë draft marrëveshje përcaktohen, objekti i marrëveshjes baza ligjore, të drejtat detyrimet dhe detyrat funksionale të AKSHI-t referuar Rregullores së AKSHI-t nr. 1900, datë 16.04.2020.
Mungesa e një marrëveshjeje ndërmjet dy institucioneve, përbën risk për mbarëvajtjen, monitorimin dhe dokumentimin e shërbimeve të Drejtorisë TIK në DPD.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 29-38 të Raportit Përfundimtartë Auditimit)

11.2 <u>Rekomandimi</u>:DPD të marrin masat e nevojshme për hartimin dhe miratimin e një marrëveshjeje dypalëshe me qëllim përcaktimin e të drejtave dhe detyrimet e ndërsjellat

midis DPD dhe AKSHI-t, llojin dhe nivelin e shërbimeve që i ofrohen nga AKSHI Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Në vijimësi

13.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi procedurat e ndjekura për monitorimin dhe analizimin e gjurmës elektronike të auditimit, rezultoi se:
- DPD nuk disponon asnjë politikë, procedurë apo procese të standardizuara për kontrollin dhe administrimin e gjurmës elektronike të auditimit, të quajtur ndryshe Audit Log.
- DPD nuk ka përcaktuar burimet njerëzore, përgjegjësitë dhe personat përgjegjës për monitorimin dhe analizimin e gjurmës së auditimit.
- Me gjithë rëndësinë që ka sistemi Asycuda, DPD nuk ka zhvilluar një infrastrukturë të përdoret për gjenerimin, transmetimin, analizimin e log-eve.
- Ndërhyrjet që kryejnë specialistët e AKSHI-t bazuar në sugjerimet e UNCTAD, nuk rezultojnë të jenë dokumentuar e miratuar nga DPD në rastet kur ndërhyrjet kryhen mbi të dhënat e sistemit, duke vepruar kështu në mënyrë të paautorizuar. Struktura e AKSHI-t nuk ka në detyrat e saj menaxhimin e log-ut.
- DPD nuk ka implementuar një infrastrukturë për analizimin, arkivimin dhe ruajtjen e të dhënave të gjurmës elektronike, në kundërshtim me 5.2.1 ñ*Infrastruktura e Menaxhimit Të Log-eve*ò të rregullores për menaxhimin e log-eve digjitale në administratën publike miratuar me Urdhrin nr.109, datë 10.06.2016 nga ALCIRT ï Agjencia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 38-51 të RaportitPërfundimtar të Auditimit)

11.3 <u>Rekomandimi</u>:DPD të marrë masa për sigurinë dhe mbrojtjene të dhënave duke filluar së pari me hartimin e një procedure apo rregullore për menaxhimin e gjurmës elektronike të auditimit. Në këtë dokument duhet të specifikohet qartë vendi ku ruhen gjurmët, për cilat veprime të përdoruesit ruhen këto gjurmë, koha, struktura përgjegjëse për monitorimin dhe analizimin e tyre, detyrat dhe përgjegjësitë, e çdo element që i shërben sigurisë së të dhënave dhe parandalimit në tjetërsimin e tyre.

Menjëherë

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi të dhënat e gjurmës elektronike të auditimit, rezultoi se për vitin 2019 këto gjurmë janë fshirë me argumentin se madhësia e kësaj tabele bllokoi punën me sistemin AsycudaWorldpër disa orë. Për këtë ndërhyrje, nuk rezulton të jetë dokumentuar asnjë shpjegim dhe asnjë miratim nga niveli drejtues i DPD. Vendimi dhe ekzekutimi është marrë nga struktura e AKSHI-t pranë DPD, në kundërshtim me pikën 5.2.2 ñ*Detyrat e Stafit Përgjegjës për Menaxhimin e Log-eve*ò, të rregullores për menaxhimin e log-eve digjitale në administratën publike miratuar me Urdhrin nr.109, datë 10.06.2016 nga ALCIRT ï Agjencia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike, sepse struktura e AKSHI-t nuk janë stafi përgjegjës për menaxhimin e log-eve.
Drejtoria TIK e AKSHI-t nuk ka ngritur mekanizma kontrolli me qëllim parandalimin e çështjeve që lidhen me funksionalitete të sistemit, çfarë do të thotë se e njëjta situatë rrezikon të përsëritet në të ardhmen.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 38-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

14.1 <u>Rekomandimi:</u>DPD të marrë masa të menjëhershme për ndërtimin e mekanizmavetë kontrollit për mbrojtjen dhe sigurimin e të dhënave shtetërore, gjeneruar prej saj nëpërmjet sistemit Asycuda, me qëllim parandalimin e situatave të ngjashme si fshirja e të dhënave mbi gjurmën elektronike të auditimit në të ardhmen.

Menjëherë

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi sistemin dhe të dhënat e aplikacionit të laboratorit ï LIMS, sipas kontratës nr. 20069, datë 06.09.2017, rezulton se mungon gjurma elektronike e auditimit (AuditLogs), megjithëse është kërkuar në specifikimet teknike bashkëngjitur kontratës në disa pika, e përkatësisht:
Pika 4 AuditTrail:

- ii. Auditim i logimeve, aksesimeve, ndryshimeve dhe hapjes së çfarëdo aspekti të sistemit;
- iii. Auditim i të gjitha njoftimeve të dërguara nga sistemi (email sms);
- iv. Auditim i login-eve të dështuara;
- v. Të gjitha auditimet duhet të jenë të raportueshme;

Pika 11.8 Administrimi dhe monitorimi i dokumenteve kriteri nr. 26 ñSistemi duhet të menaxhojë gjurmët (auditimet e sistemit informatik)ò;
Pika 11.9 Menaxhimi i regjistrimeve dhe procedurave administrative kriteri nr.14 ñSistemi nuk duhet të lejojë fshirje të gjurmëve nga skedarët e log-eve (audittrails or logs)ò dhe kriteri nr.23 ñSistemi duhet të ketë aftësi të regjistrojë ñauditrailò për të gjitha aktivitetet që ndodhin në regjistrimeò.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 38-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

15.1 <u>Rekomandimi:</u>DPD të marrë masat e nevojshme, për të siguruar përmbushjen e detyrime mbi specifikimet teknike për sistemin LIMS në lidhje me gjenerimin, administrimin, monitorimin dhe raportimin e gjurmës elektronike të auditimit quajtur ñ*Audit Log*ò.

Menjëherë

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se DPD, si institucion që posedon disa sisteme informacioni që ruajnë, përpunojnë dhe gjenerojnë të dhëna me rëndësi për realizimin e mbikëqyrjes dhe tregtisë ndërkombëtare, nuk disponon një infrastrukturë BCC (BusinessContinuity Center), në kundërshtim me VKM nr.710, datë 21.08.2013 ñ*Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit*ò, i ndryshuar.
DPD nuk ka një plan vazhdimësie dhe plan rikuperimi për garantimin e vazhdimësisë së ofrimit të shërbimit.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 38-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

16.1 <u>Rekomandimi:</u>DPD në bashkëpunim me AKSHI-n nisur edhe nga rëndësia që ka ofrimi i shërbimit pas një fatkeqësie natyrore, të hartojnë planin e vazhdimësisë dhe planin e rikuperimit si dhe të ndërmarrin hapat e nevojshëm për sigurimin e pajisjeve të nevojshme në ndërtimin e *BusinessContinuity* si dhe të përcaktojnë burimet njerëzore përgjegjëse nga të dy institucionet.

Menjëherë

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi pajisjet TIK rezulton se Firewall-i i internetit është Checkpoint i ndërtuar në një server që nuk është Cluster, kjo mungesë backup në pajisje vlerësohet me rëndësi nga auditimi për arsye se në të janë konfiguruar lidhjet me institucionet Bankare, me palët e treta dhe me shtetet fqinjë. Gjithashtu, nëpërmjet tij administrohen dhe VPN client për subjektet e akcizës, agjencitë doganore apo institucione të tjera për aksesimin e sistemit.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 38-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

17.1 <u>Rekomandimi:</u>DPD të kërkojë nga AKSHI, prokurimin e pajisjes backup për linjën e internetit, me rëndësi për institucionin pasi në të janë konfiguruar lidhjet e jashtme me sistemin doganor, me qëllim parandalimin e ndërprerjes së punës në rast të një defekti në pajisjen aktuale.

Menjëherë

18. Gjetje nga auditimi:

A. Grupi i auditimit për periudhën nën auditim në lidhje me menaxhimin e përdoruesve AsycudaWorld, konstatoi se:

- Nuk janë dokumentuar në asnjë formë politikat e implementuara për fjalëkalimet e sistemeve qendrore, administrimitdhe përdoruesit fundor, me qëllim informimin mbi kriteret e aplikuara në Asycuda si sistemi më i rëndësishëm dhe kritik i DPD, si dhe të aplikohen detyrimet që nevojiten në fjalëkalimin e tyre , bazuar në pikën 4 ñKërkesat e Sigurisëò pika a. dhe b. të rregullores për ñAdministrimin e fjalëkalimeve në rrjetet dhe sistemet kompjuterikeò miratuar nga CESK me Urdhrin nr. 86, datë 23.08.2019.
- Mbajnë statusin ñaktivò përdorues të cilët nuk kanë asnjë marrëdhënie aktive me DPD.
- Në të dhënat mbi përdoruesit rezulton se në disa raste është mbyllur përdoruesi ekzistues dhe krijuar përdorues i ri për të njëjtin punonjës.
- Rezulton më shumë se një përdorues për të njëjtin person;
- DPD nuk ka dokumentuar në asnjë formë përdoruesit e bazës së të dhënave dhe të drejtat që ata kanë;
- Disa përdorues Brokers rezultojnë me të drejta si ñAdministratorò;
- Për disa përdorues nuk ka datë krijimi;
- Të dhënat e kontaktit në pjesën më të madhe janë plotësuar me ñ1ò e në disa raste nuk janë plotësuar fare, në vend të të dhënave të vlefshme;
- Janë funksionale disa role me të drejta administrative si: a, aa, admin, Administrator, çfarë tregon se mungon unifikimi i rolit në aplikacion.
- Adresa e përdoruesit është një e dhënë tekst e pa bazuar në ndonjë standard, herë është plotësuar qyteti dhe herë roli që ka përdoruesi, në disa raste adresa është një numër prsh ñ100ò;
- Emri i plotë në disa raste është plotësuar me numër;
- Nuk është respektuar i njëjti standard në krijimin e ñusernameò ku pjesa më e madhe është krijuar me emërmbiemër, por në disa raste ky model nuk është ndjekur.
- Përcaktimi i fushës ñJOBò është në disa forma për të njëjtin informacion p.sh në disa raste përdoruesve ju është caktuar fusha ñTradeò e në disa raste ñTraderò, çfarë tregon se mungon standardi dhe në përcaktimin e roleve të njëjta në përdoruesit që krijohen dhe kjo e dhënë nuk rezulton të jetë një listë e miratuar por caktohet nga specialisti që regjistron për herë të parë përdoruesin.

B. Nga verifikimi në nivel administrativ që grupi i auditimit kreu në sistem lidhur me krijimin, ndryshimin dhe mbylljen e përdoruesve në sistemin LIMS, rezultoi se:

- Å Nuk ka datë krijimi, datë ndryshimi dhe datë mbyllje të përdoruesit;
- Å Në zgjedhjen e rolit të përdoruesit listohen dy mundësi D (doganier) dhe View (Monitorim Drejtoria e Përgjithshme), por në disa përdorues rezulton se roli I përcaktuar nuk gjendet në listë si p.sh: DL (Drejtor Laboratori), PI (Përpunuese Informacioni), PSMA (Përgjegjëse e Sektorit të Metodikave të Administrimit);
- Å Administratori mund të fshijë përdoruesin apo të ndryshojë dhënat e pandryshueshme si emri i përdoruesit dhe fjalëkalimi.
- Å Nuk është ndjekur i njëjti standard në krijimin e përdoruesit në rolin doganier:

- Å Në një rast është krijuar sipas modelit shkronja e parë e emrit.mbiemër;
- Å Në disa raste janë krijuar sipas modelit emërmbiemër;
- Å Në disa raste sipas modelit emër_mbiemër
- Å Në një rast nuk përputhet emri i punonjësit me emërtimin e përdoruesit;
- Å Kriteret e ndërtuara nësistemin LIMS për fjalëkalimin e përdoruesit fundor dhe administrimit janë të njëjta: kur nuk duhet të përmbajë hapësira boshe; jo më i shkurtër se 6 karaktere; jo 6 fjalëkalimet e fundit;

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 38-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

18.1 <u>Rekomandimi:</u>Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse të unifikojë të dhënat për përdoruesit e sistemit Asycuda dhe LIMS të njëjtës kategori, të plotësojë të dhënat që mungojnë për çdo përdorues, të ndërtojë kontrolle për mbylljen e përdoruesve në kohën e duhur, të mbyllë përdoruesit të cilët kanë përfunduar objektin e krijimit, me qëllim ruajtjen e sistemit nga ndërhyrjet e paautorizuara.

Menjëherë

18.2 <u>Rekomandimi</u>: Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse të ndërtojë mekanizma kontrolli për dokumentimin dhe miratimin fizik të ndryshimeve të lejuara për përdoruesit, për të cilat nuk gjenerohet një gjurmë elektronike auditimi.

Në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi aktet rregullative për dokumentimin dhe mirë administrimin e bazës së të dhënave doganore, rezulton se:

- DPD nuk disponon asnjë akt rregullativ të brendshëm me qëllim organizimin dhe funksionimin e brendshëm të bazës së të dhënave, në përputhje me ligjin nr.10325, datë 23.9.2010, për ñ*Bazat e të dhënave shtetërore*ò, neni 5.
- Nuk janë dokumentuar në asnjë formë të dhënat dytësore të cilat ruhen në këtë bazë të dhënash për të mirë funksionuar si dhe të dhënat apo sistemet me të cilat ndërveprohet sipas përcaktimeve në nenet 7 dhe 8 të ligjit nr.10325, datë 23.9.2010, për ñ*Bazat e të dhënave shtetërore*ò.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 51-62 të RaportitPërfundimtar të Auditimit)

19.1 <u>Rekomandimi:</u>DPD si institucion përgjegjës dhe administrues i të dhënave shtetërore që gjenerohen nëpërmjet sistemit Asycuda, të dokumentojnë me një akt rregullativ të brendshëm organizimin dhe funksionimin e të dhënave shtetërore me rëndësi kritike. Gjithashtu, të evidentohen dhe dokumentohen pa përjashtim të dhënat parësore dhe dytësore me të cilat janë ndërtuar ndërveprime për ofrimin e shërbimit ndaj shtetasve.

Brenda vitit 2021

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi administrimin e të dhënave shtetërore të DPD rezulton se **t**ë dhënat gjeneruar prej sistemit Asycuda nuk administrohen nga DPD, megjithëse janë detyrim i institucionit që i gjeneron ato, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr.10325, ñ*Për bazat e të dhënave shtetërore"*, neni 5, dhe VKM nr.673, datë 21.11.2017 ñ*Për riorganizimin e agjencisë kombëtare të shoqërisë së informacionit*ò pika 5/y. Aktualisht detyrat e administrimit të të dhënave janë deleguar në mungesë të plotë dokumentacioni (verbalisht) tek specialistët e AKSHIT, për arsye se vetë DPD nuk ka asnjë pozicion dhe punonjës në strukturën e saj, për ruajtjen dhe administrimin e të dhënave.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 51-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

20.1 <u>Rekomandimi:</u>DPD si institucion përgjegjës dhe administrues i të dhënave shtetërore që gjenerohen nëpërmjet sistemit Asycuda, të marrë masa për përmbushjen e këtij detyrimi me strukturë të posaçme për administrimin dhe mbrojtjen e të dhënave, si shërbime të cilat nuk ofrohen nga AKSHI.

Mars 2022

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi përdorimin e moduleve të ndryshme të sistemit AsycudaWorld, u konstatuan problematika të ndryshme si:

- DPD nuk disponon manual të administrimit të sistemit AsycudaWorld si dhe për modulet *Akciza* dhe *Borxhi*.
- Pikat doganore rakordojnë me 1 javë vonesë, vetëm prej kushteve teknike dhe fizike që disponojnë, çfarë krijon pamundësi të kontrolleve dhe verifikimeve në kohë reale tek subjektet sa herë që kërkohet nga vetë ata apo nga hallkat monitoruese të DPD.
- Nuk e disponon askush adresën e email-it të krijuar për subjektet që kërkojnë anulimin e DSHA e për pasojë dhe ndërprerjen e lëvizjes për mallrat e akcizës, çfarë tregon se komunikimi i subjektit me degët doganore, për anulimin e DSHA nuk kryhet sipas përcaktimeve të Udhëzimit Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave nr.2, datë 07.04.2015, dhe nr. 8627 prot, datë 07.04.2015.
- Ngarkimi i mallit nga subjektet e akcizës është një e dhënë që nuk mund të modifikohet nga ndërfaqja pasi është regjistruar në sistem pa marrë parasysh gabimin njerëzor në këtë rast edhe pse ngarkimi i mallit rezulton një herë i regjistruar në sistem nëpërmjet deklaratës doganore nga ku mund të lexohet automatikisht pa qenë i nevojshëm vetë deklarimi i subjektit.
- Gjendja e magazinës në sistemin e raportimit (Oracle) nuk është e njëjtë me gjendjen e magazinës në sistemin Asycuda për të njëjtin subjekt.
- Ngarkimet e mallit që regjistron subjekti në pika të ndryshme doganore nuk i shfaqen zyrës doganore mbikëqyrëse ku subjekti ushtron veprimtarinë.
- Anulimi i DSHA për subjektet e akcizës nuk e kthen sasinë e produktit në magazinën e subjektit në gjendjen që ishte përpara regjistrimit të veprimit, por e bën hyrje pa e shkarkuar atë sasi. Kjo sasi duhet të shkarkohet nga magazina e subjektit dërgues në momentin që subjekti pritës e ka pranuar dërgesën dhe jo që në regjistrimin e veprimit, pasi ky veprim krijon konfuzion dhe pamundësi për të patur të dhëna reale për gjendjen e subjekteve të akcizës.
- Në modulin e dokumentit elektronik të magazinimit të përkohshëm (DEMP) rezulton se, nuk mund të ndryshohen të dhënat kur konstatohet diferencë në peshë dhe në sasi (nr. I paketimit) edhe kur këto veprime kryhen përpara mbërritjes në destinacion. Gjithashtu peshat nën 1 gram (prsh 0.8) nuk mund të mbyllen në DEMP.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 51-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

21.1<u>Rekomandimi</u>: Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse të marrë masa për testimin e situatave të konstatuara nga auditimi renditur më sipër, raportimin e tyre tek Specialistët e TIK dhe ekspertët e UNCTAD për ato raste që mund të rregullohen gjatë fazës të Upgrade, dhe evidentimin e dobësive të cilat kërkojnë më shumë kohë për zgjidhje.

Menjëherë

22. Gjetje nga auditimi:

A. Nga auditimi mbi veprimtarinë e ofruar nga sistemi LIMS rezulton se,nuk komunikon, menaxhon apo ndërvepron ndonjë palë e tretë. Ndërveprimi mungon dhe me sistemet e brendshme të DPD dhe konkretisht me atë më kryesorin AsycudaWorld kërkuar dhe në specifikimet teknike, mbështetur dhe në faktin se ky sistem suporton nënshkrimin Dixhital.

B. Nga auditimi mbi sistemin LIMS, rezulton se:

- Monitorimi dhe vazhdimësia e kontratës me kontraktuesin kryhet nga sektori HelpDesk, ndërkohë që me hyrjen në fuqi të VKM nr.673, datë 21.11.2017 ñ*Për riorganizimin e agjencisë kombëtare të shoqërisë së informacionit*ò, kushtet teknike për të mbajtur funksional këtë sistem duhet të suportohen nga struktura e zhvillimit TIK atashuar nga AKSHI;
- DPD nuk disponon manual administrimi të këtij sistemi;
- Konfigurimet për gjuhën dhe identifikimin me ñ*Twofactorauthentication*ò janë parametrizime të cilat nuk janë funksionale, kërkuar përkatësisht në pikat 11.1 dhe 11.6 të specifikimeve teknike.
- Në këtë sistem gjurma elektronike e auditimit (audittrails ose logs) mungon, çfarë është në kundërshtim me ñRregulloren për Menaxhimin e log-eve digjitale në administratën publikeò, miratuar me urdhrin nr. 109 datë 10.06. 2016 të Drejtorit të Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT) si dhe me specifikimet teknike kërkuar më shumë se një herë e më konkretisht në pikat: 4 ñAuditTrailò, 11.8 ñAdministrimi dhe monitorimi i dokumenteveò, 11.9 ñMenaxhimi i regjistrimeve dhe procedurave administrativeò.
- Nuk janë zhvilluar raporte komplekse të cilat do të mund ti shërbenin auditimit të brendshëm dhe të jashtëm mbi monitorimin e aktivitetit dhe veprimtarisë së kësaj drejtorie dhe këtij sistemi, kërkuar në pikën 11.11 ò Raporte të avancuara dhe analizë informacioniò ku një nga kërkesat është Monitorim dhe Raportim i aktivitetit në sistem (audittrails).

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 51-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

22.1 <u>Rekomandimi:</u>DPD të kërkojë tek kontraktorit përmbushjen e funksionaliteteve që nuk janë aktualisht funksionale, mbi:
- Import/exportin e të dhënave;
- Integrimin me sistemin AsycudaWorld me qëllim sigurimin e efektivitetit të përdorimit të sistemit LIMS pas përfundimit të kontratës së mirëmbajtjes;
- Manualin e Administrimit;
- Gjurmën elektronike të auditimit (audittrails ose logs);
- Raporte komplekse të cilat do të mund ti shërbenin auditimit të brendshëm dhe të jashtëm mbi monitorimin e aktivitetit dhe veprimtarisë së kësaj drejtorie;
- Konfigurimet për gjuhën dhe identifikimin me ñ*Twofactorauthentication*ò të cilat nuk janë funksionale;

Menjëherë

23. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi monitorimin e Intranetit, rezultoi se:
- Rruga që ndiqet për monitorimin e linjave data, nuk kryhet sipas hapave të përcaktuar në Rregulloren e Brendshme pika 4.3 ñDetyrat funksionale të Sektorit të Zgjidhjeve dhe Suportit (HelpDesk)ò.
- Nëpërmjet kësaj zgjidhje nuk monitorohet konsumimi i bandwith-it të linjës deri në nivel përdoruesi, duke mos i dhënë mundësinë Sektorit të TIK dhe vetë administratës doganore të kryejnë planifikimet e duhura për sasinë reale që çdo pike doganore i nevojitet.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 51-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

23.1 <u>Rekomandimi:</u>Drejtoria TIK e AKSHI-t pranë DPD të konsiderojnë dhe implementojnë zgjidhje të tjera ñopensourceò për monitorimin e linjave data për pikat doganore me qëllim monitorim më të detajuar mbi konsumin e bandwithit, çfarë do të ndihmonte DPD në një planifikim më të mirë dhe të afërt me atë kapacitet që nevojitet. Gjithashtu, Sektori i Zgjidhjeve dhe Suportit (HelpDesk) me qëllim eliminimin e hapave të panevojshëm që mund

të shkaktojnë humbje në kohë, gjatë monitorimit të linjave data të përcjellë tek ISP dhe eprori problemet e konstatuara.

Brenda 2022

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi

Raporti i Përfundimtar i Auditimit, do të përcillet krahas subjektit të audituar Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit - AKSHI.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

V. ANEKSE – Lista e Shkurtimeve

Nr	Shkurtimi	Emërtimi i Plotë
	KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
	DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
	AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
	ALCIRT	Agjencia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike
	MNSH	Marrëveshje të Nivelit të Shërbimit
	TI (IT)	Teknologjia e Informacionit
	MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
	TI (IT)	Teknologjia e Informacionit
	TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
	VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
	DEMP	DokumentiElektronik iMagazinimit të Përkohshëm
	DSHA	Dokumenti Shoqërues Administrativ
	KM	Këshilli i Ministrave
	ITMS	Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Tarifave
	NCTS	Sistemin e Transitin Elektronik të Përbashkët
	BCC	BusinessContinuity Center
	BE	Bashkimi Evropian
	EU	European Union
	SIMBNJ	Sistemi Informatik i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore
	SIFQ	Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë
	COBIT	Objektivat e Kontrollit për Informacionin dhe Teknologjinë përkatëse
	ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
	LIMS	Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Laboratorik
	SEED	System Exchange Electronic Data
	TARIC	The IntegratedTariffof the European Union
	NJTIK	Njësitë e Teknologjisë së Informacionit e të Komunikimit